

**PESHA E KAPITALIT SOCIAL NE PERFORMANCËN
QEVERISËSE. ZBËRTHIMI I BESUESHMËRISË DHE
BESIMIT INSTITUCIONAL NË KONTEKSTIN E
SHOQËRISË SHQIPTARE.**

Anisa Proda

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Politike, me profil Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Ph.D Fatos Tarifa

Numri i fjalëve: 65,126

Tiranë, Maj 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj nën përgjegjësinë time se ky punim është shkruar prej meje, sipas udhëzimeve të Universitetit European të Tiranës, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

©2016 Të gjitha të drejtat i rezervohen autores

ABSTRAKT

Kapitali social është shndërruar në një nga konceptet me ndikimin më të madh në shkencat sociale, politike, në ekonomi, sociologji dhe studimet e zhvillimit. Pas popullaritetit të fituar nga punimi i Robert Putnam, si dhe pas pretendimeve të Bankës Botërore se kapitali social ishte "lidhja që mungonte" në procesin e zhvillimit, fraza ka hyrë në debatin publik dhe praktikën e zhvillimit në mbarë botën.

Ky punim ofron një hyrje në literaturën teorike dhe empirike të kohëve të fundit mbi kapitalin social. Një sasi e madhe gjithmonë në rritje e hulumtimeve i kushtohet efekteve të kapitalit social në performancën institucionale. Hulumtuesit kanë identifikuar një marrëdhënie pozitive mes kapitalit social dhe performancës qeveritare në nivel lokal dhe në nivel kombëtar. Kjo literaturë tregon se shoqëritë që karakterizohen nga nivele të larta të kapitalit social kryesisht karakterizohen nga performanca qeverisëse më të mira. Megjithatë përkufizimi i saktë dhe matja e tij mbeten ende të paqarta, tashmë është pranuar gjerësisht se prania e rrjeteve të dendura të shoqatave formale dhe joformale dhe prania e normave shoqërizuese të besimit dhe reciprocitetit të përgjithësuar përfaqëson thelbin e konceptit të kapitalit social. Ashtu si kapitali njerëzor dhe fizik, kapitali social është sjellë përpara si një burim i rëndësishëm në dispozicion të shoqërive.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar procesit të tranzicionit në Europën Qendrore dhe Lindore, i cili pati një efekt të thellë mbi mënyrën se si individët ndërveprojnë, si kanë ndryshuar institucionet sociale dhe ekonomike, gjë që kërkon një proces të përshtatjes drejt ekonomisë së tregut, për të kaluar më pas te rasti i shoqërisë shqiptare. Mbështetur në studime të realizuara nga institute dhe organizata jo-fitimprurëse në Shqipëri, punimi shqyrton perceptimet, besimin, marrëdhënien dhe angazhimin e qytetarëve shqiptarë për sa i përket jetës politike, institucioneve, shoqërisë civile dhe interesin mbi çështjet publike, si faktorë dhe njëkohësisht pasojë e kapitalit social të pranishëm në shoqërinë tonë.

Fjalë kyçe: kapitali social, besimi, rrjetet qytetare, pjesëmarrja politike, performanca qeverisëse

ABSTRACT

Social capital has become one of the most influential concepts in social and political sciences, in sociology, in economics and in development studies. Popularized by Robert Putnam, as well as by claims from the World Bank that social capital was the “missing link” in development, the phrase has entered public debate and development practices worldwide.

This paper provides an introduction to the recent theoretical and empirical literature on social capital. A large and growing unit of research is devoted to the effects of social capital on institutional performance. Researchers have identified a positive relationship between social capital and governmental performance at local and national levels. This literature reveals that societies characterized by higher levels of social capital tend to achieve superior performance. Although the exact definition and measurement remain still unclear, it is by far widely acknowledged that the presence of dense networks of formal and informal associations and the accompanying norms of generalized trust and reciprocity represent the essence of social capital. Just like human and physical capital, social capital has been brought forward as an important resource available to societies.

Special attention is paid to the transition process in Central and Eastern Europe, which had a profound effect on how individuals interact, how social institutions and enterprises have changed, which requires a process of adjustment towards a market economy, to pass then to the case of the Albanian society. Based on studies conducted by institutes and non-profit organizations in Albania, the paper examines the perceptions, trust, relationship and engagement of the citizens in terms of political life, institutions, civil society and interest in public affairs, as factors and also consequences of the social capital present in our society.

Keywords: social capital, trust, civic networks, political participation, governmental performance

FALENDERIMET

Ndonëse puna për këtë temë më ka frymëzuar, shkrimi i këtij punimi nuk ka qenë aspak i lehtë për mua. Janë më se të merituara falenderimet për të gjithë ju mbështetësit e mi. Falenderoj përzemërsisht Universitetin European të Tiranës që më mbështeti me bursë të plotë përgjatë gjithë periudhës së studimeve doktorale si dhe stafin e shkollës doktorale për lehtësitë që më krijoi që të realizoja këtë punim. Falenderoj miqtë e mi për kontributin që kanë dhënë secili: Iva Toskën dhe Albana Mujën për hulumtimin në literaturë, Romina Licaj për ndihmesën logjistike, Linela Markja për redaktimin gjuhësor, Anjeza Xhaferaj dhe Dorina Zenelaj për inkurajimin gjatë punës dhe dhënien e pakursyer të këshillave të nevojshme. Shpesh herë kam menduar të tërhiqesha për shkak të pengesave në realizimin e këtij punimi por udhëheqësi im doktoral më ka ndihmuar të ruaj besimin se do t'ia dal. Falenderime dhe mirënjohje e thellë për Prof. Dr. Fatos Tarifa i cili pranoi të më udhëheqë në këtë studim. Profesor Tarifa ka qenë jo vetëm udhëheqësi im akademik por edhe frymëzuesi e inkurajuesi që tia dilja mbanë deri në këtë ditë. Falenderoj gjithashtu familjen time për mbështetjen që më ka dhënë duke u përpjekur ta finalizonim me sukses së bashku këtë sipërmarrje.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	1
------------	---

Metodologjia	3
--------------------	---

I. Kapitali social dhe rëndësia e tij

1.1 Origjina dhe përkufizime.....	8
1.1.1 Hulumtimi i Literaturës.....	9
1.1.2 Tre baballarët themelues të konceptit: Bourdieu, Coleman, Putnam.....	12
1.1.3 Një koncept shumë-dimensional.....	21
1.1.4 Llojet dhe formimi i kapitalit.....	28
1.2 Rëndësia e kapitalit social.....	34
1.2.1 Rëndësia e kapitalit social në jetën e përditshme.....	34
1.2.2 Kapitali social një mjet i dobishëm për politikën publike.....	38
1.2.3 Përfitimet dhe dobësitë e kapitalit social.....	46
1.3 Problemi i matjes së kapitalit social.....	49
1.4 Kapitali Social në fushën ndërkombëtare.....	53
1.5 Elementet e Kapitalit social sipas Putnam.....	56
1.5.1 Besimi.....	57
1.5.2 Normat e reciprocitetit.....	61
1.5.3 Rrjetet.....	64
1.5.4 Kuadri i OECD-së.....	65

II. Kapitali Social dhe Performanca Qeverisëse

2.1 Kapitali social dhe besimi.....	66
2.1.1 Marrëdhënia mes kapitalit social dhe besimit.....	67

2.1.2	Ndryshime në nivelet e besimit në individë dhe vende të ndryshme.....	72
2.2	Kultura politike dhe performanca e qeverisjes.....	77
2.3	Teoria e Putnam-it mbi ndikimin e kapitalit social në qeverisje.....	78
2.3.1	Teza themelore.....	79
2.3.2	Kritika ndaj qasjes së tij.....	82
2.4	Kapitali social dhe mirë-qeverisja.....	83
2.4.1	Rrjetet sociale dhe shkëmbimi i informacionit.....	84
2.4.2	Kapitali social dhe qeverisja e mirë.....	87
2.4.3	Modelet e marrëdhënieve mes kapitalit social dhe qeverisjes..	89

III. Kapitali social si aset i rëndësishëm në jetën politike

3.1	Institucionet, korrupsioni dhe kapitali social.....	96
3.2	Sektori informal dhe korrupsioni para dhe pas regjimit komunist në Shqipëri	103
3.2.1	Ndikimi i qeverisjes mbi kapitalin social.....	109
3.3	Funksioni politik i kapitalit social.....	112
3.3.1	Si mund të rrisim kapitalin social.....	114
3.3.2	Cfarë mund të bëjë kapitali social për përfshirjen sociale...	117
3.4	Disa kufizime dhe implikimet e tyre për hartimin e politikave.....	118
3.5	Kapitali social në Europë.....	122
3.5.1	Rrënjët e kapitalit social në kontinentin e vjetër.....	123
3.5.2	Tranzicioni post-komunist në Europën Qëndrore dhe Lindore.....	133
3.5.3	Kapitali social dhe trashëgimia socialiste.....	138

IV. Shqipëria dhe qeverisja e hapur..... 159

4.1	Kapitali social në Shqipëri.....	160
4.1.1	Familja shqiptare në kuadër të besimit social.....	162
4.1.2	Kapitali social dhe emigrimi.....	173

4.2 Marrëdhënia mes administratës publike shqiptare me qytetarët.....	175
4.3 Besimi tek autoritetet Institucionale.....	178
4.4 Shoqëria civile si themel i demokracisë.....	185
4.4.1 Shoqëria civile në Shqipëri.....	186
4.4.2 Organizatat Jo-fitimprurëse dhe baza ligjore për shoqërinë civile.....	187
4.4.3 Indeksi i shoqërisë civile.....	189
4.5 Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje dhe zbatimin e politikave.....	194
4.5.1 Pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë në qeverisje.....	196
4.5.2 Tradita komunitare dhe angazhimi publik i qytetarëve....	201
4.5.3 Qëndrimet publike të shqiptarëve ndaj proceseve politike.....	205
4.6 Partitë politike dhe shoqëria civile.....	212
V. Përfundime.....	218
Bibliografia.....	224

LISTA E ILUSTRIMEVE DHE GRAFIKËVE:

Figura 1: Elementet e Kapitalit Social.....	52
Figura 2: Fakte dhe Shifra mbi Shoqërinë Civile 1	182
Figura 3: Fakte dhe Shifra mbi Shoqërinë Civile 2.....	183
Tabela 1: Si perceptohen qytetarët nga administrata publike 2014.....	166
Tabela 2: Vlerësimi i agjencisë së qytetarëve në demokraci 2014.....	168
Grafiku 1: Besimi ndërpersonal dhe besimi te qeveria 1998 dhe 2002.....	153
Grafiku 2: Besimi tek shtypi 2002.....	154
Grafiku 3: Besimi në institucionet ndërkombëtare 1998 dhe 2002	155
Grafiku 4: Besimi te Policia 1998 dhe 2002	156
Grafiku 5: Besimi te Drejtësia 1998 dhe 2002.....	156
Grafiku 6: Respekti dhe dashuria për prindërit 1998 dhe 2002.....	158
Grafiku 7: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që jetojnë vetëm 1998 dhe 2002.....	159
Grafiku 8: Besimi ndërpersonal dhe institucional në përqindje gjatë 2012-2013.....	161
Grafiku 9: Besimit te qeveria, policia dhe drejtësia 2012-2013.....	162
Grafiku 10: Besimi në përqindje 2013-2014.....	170
Grafiku 11: Kënaqësia me shërbimet publike 2014.....	172
Grafiku 12: Pjesëmarrja në qeverisje 2014.....	173
Grafiku 13: Besimi te institucionet 2014.....	174
Grafiku 14: Njohuritë mbi çështje të ndryshme 2016.....	196
Grafiku 15: Anëtarësimi në një parti politike ose OJF/shoqatë 2016.....	198
Grafiku 16: Përfshirja në vendimarrje 2016.....	200
Grafiku 17: Kënaqësia me punën e institucioneve 2016.....	201
Grafiku 18: Perceptimi për funksionet dhe përbërjen e parlamentit shqiptar 2016....	203

Hyrje

Situatat nga përvoja e përditshme na tregojnë se ekzistojnë dallime të mëdha mes arritjeve individuale në jetë. Edhe pse në shumicën e shoqërive traditat kulturore, ligjet dhe besimet fetare mësojnë dhe kërkojnë trajtim të barabartë të anëtarëve të shoqërisë, kjo nuk ndodh. Kështu, disa prej anëtarëve të shoqërisë gëzojnë shëndet më të mirë, më shumë pasuri, ose thjeshtë gjejnë mundësi më të mira për arritjen e qëllimeve në krahasim me të tjerët. Më konkretisht, disa njerëz janë në gjendje të arrijnë në nivelet më të larta të arsimit, të gjejnë një punë më të mirë, të kenë më shumë të ardhura, shtëpi më të mira e me kushte më të përshtatshme, dhe shumë shpërblime të tjera që jeta ka për të ofruar.

Dallime të tilla në arritjet individuale mund të shpjegohen nga këndvështrime të ndryshme. Një nga këto këndvështrime merr në konsideratë kushtet psikologjike: për shembull, njerëzit kanë nivele të ndryshme ambicieje, disa janë më ambiciozë se disa të tjerë, jo të gjithë janë të përgatitur të sakrifikojnë apo të përpiqen njëloj për ndjekjen e një karriere, gjetjen e një partneri ideal, apo sigurimin e një strehimi më të mirë. Rezultatet e veprimeve të tilla mund të tregojnë pra ndryshim të konsiderueshëm. Ndryshimet në arritjet individuale mund të studiohen edhe nga këndvështrimi socio-ekonomik. Për përfundimin me sukses të veprimeve, duhen arritur dhe shfrytëzuar burime. Prandaj, ideja e përgjithshme është se individët të cilët mund të kenë më shumë akses tek burimet ose kapitali do të jenë më të suksesshëm në jetë.

Përveç kontrollit që ka dikush mbi burimet personale, rrethanat sociale ku gjendet personi konsiderohen gjithashtu si një përcaktues i rëndësishëm i suksesit në jetë: faktorët gjenetikë dhe burimet e prindërve në format e tyre të ndryshme formojnë të

gjitha rezultatet individuale. Masa në të cilën statuset socio-ekonomike përcillen brez pas brezi është bërë tashmë tema qendrore e kërkimeve më të mira të shtresëzimit, që mori formën e saj moderne në fund të viteve 1960 nga Blau dhe Duncan (1967). Megjithatë, realizimi i veprimeve individuale nuk ndikohet vetëm nga origjina e familjes. Teorikisht, të gjithë njerëzit e tjerë me të cilët një njëri njihet gjatë jetës mund të influencojnë rezultatet e veprimeve të veçanta: të afërmit, miqtë, të njohurit, fqinjët, kolegët, së bashku formojnë një kontekst në të cilin individët mund të ndjekin qëllimet e tyre. Ndonjëherë ky kontekst mund të shërbejë si një pengesë, dhe të bllokojë mundësitë.

Njohjet shpesh ndihmojnë gjithashtu në ndjekjen e qëllimeve të cilat nuk mund të arrihen vetëm, ose mund të arrihen pjesërisht. Njerëzit shkëmbejnë në mënyrë të rregullt ndihma të përmbajtjeve gjerësisht të ndryshme. Ndonjëherë, ndihma është thjesht praktike, si për shembull marrja hua e një shkalle apo një filxhan sheqeri nga fqinjët. Megjithatë, shkëmbimet përfshijnë edhe ndihma më komplekse si ndihmë me informacione në lidhje me mundësitë e punësimit. Shumica e qëllimeve emocionale në jetë mund të arrihen vetëm me ndihmën e të tjerëve, si për shembull t'i bëjmë shoqëri njëri-tjetrit, koha e mirë që kalojmë së bashku, seksualiteti dhe riprodhimi, por edhe diskutimi i problemeve personale ose ngushëllimi i njëri-tjetrit gjatë një krize apo fatkeqësie. Ideja e përgjithshme është se marrëdhëniet me njerëzit e tjerë mund të shihen si hyrje drejt koleksioneve të burimeve në dispozicion, si shtesë ose si zëvendësim i burimeve personale. Nisur nga këto premisa, lindi ideja për zhvillimin e këtij punimi, që ka për objekt kryesor studimi konceptin e kapitalit social, funksionet dhe dimensionet e tij, marrëdhënien me performancën në qeverisje, si edhe me nivelet e besimit dhe besueshmërisë në shoqëri.

METODOLOGJIA

Studimi ynë është ndër të paktët studime në vendin tonë që përpiqet të analizojë rolin që mund të luajë kapitali social në performancën institucionale në kushtet kur besueshmëria e popullsisë në Shqipëri kundrejt veprimtarisë së institucioneve është mjaft e ulët.

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë mbi rolin që luan kapitali social në komunitetin politik duke përshkruar ndikimet e mundshme që në njësinë bazë të tij te (individi) e deri tek ndërveprimet midis grupeve shoqërore dhe qeverisë për zgjidhjen e dilemave kolektive. Me komunitet politik këtu kam parasysh tërësinë e qytetarëve me vullnet për të jetuar në bashkësi e të aftë për të ndjekur dëshirat e tyre personale duke respektuar gjithashtu sferën publike.

Punimi ka për objektiva:

- Të trajtojë konceptin e kapitalit social në planin teorik duke iu referuar autorëve më në zë që e kanë studiuar atë.
- Të bëjë një analizë krahasimore mbi gjendjen e kapitalit social në Europën Perëndimore dhe atë Qendrore dhe Lindore.
- Të identifikojë variablat që mundësojnë dallimet, si dhe të bëjë një analizë më e thelluar për rastin e Shqipërisë.

Hipoteza bazë e këtij studimi thotë se kapitali social luan një rol të rëndësishëm në performancën e institucioneve dhe në mirëqeverisje. Duke qenë se koncepti në rrënjë të hipotezës është kompleks, hipoteza do të mbështetet tek komponentët diakronik dhe sinkronikë. Pikëpamja sinkronike ka të bëjë me fenomenin dhe faktorët e ndërlidhur paralelisht ndërsa pikëpamja diakronike ka të bëjë me rrënjët historike.

Gjithashtu, për shkak të natyrës holiste të problemit, metodologjia e përzgjedhur bazohet në shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore. Për sa i përket burimeve dytësore, autori ka shfrytëzuar dokumente, raporte, studime të publikuara nga institute të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare njëkohësisht, janë shfrytëzuar artikujt e botuar në revista të ndryshme shkencore. Kjo linjë gërshetohet edhe me disa këndvështrime teorike të autorëve më të njohur të fushës së sociologjisë dhe shkencave politike. Në përzgjedhjen e tyre, është tentuar që tezat të ballafaqohen me njëra tjetrën me qëllim ofrimin e një panorame sa më të gjerë të temës. Për sa i përket kompleksitetit që mbart fenomeni, është e pamundur që të jepet ndonjë analizë shteruese, por të paktën synohet që në rrafshin teorik të ofrohet një kontribut modest në drejtim të njohjes së fenomenit.

Pyetjet kërkimore

Si ndikon në performancën institucionale të një vendi niveli i kapitalit social?

Si ka ndikuar prania e kapitalit social në vendet e Europës Lindore dhe Qëndrore duke marrë parasysh edhe trashëgiminë e tyre socialiste?

Metoda e përdorur është ajo krahasuese, përmes së cilës është bërë e mundur jo vetëm analiza e të dhënave, por edhe diskutimi dhe vlerësimi i teorive të ndryshme, apo i qasjeve të studiuesve të huaj dhe atyre mbi kapitalin social.

Kufizimet e studimit

Ky studim nuk ka grumbulluar të dhëna parësore nëpërmjet instrumenteve të veta, por iu është referuar të dhënave të siguruara nga autorë të tjerë në këtë fushë. Studimi ka pasur një shtrirje të gjerë duke përfshirë qasjet të disa autorëve gjë që mund të mos japë mundësi për tu fokusuar qartazi te një rrymë e caktuar mendimi.

Mungesa e studimeve të thelluara në lidhje me vlerësimin empirik të elementëve që përbëjnë konceptin e kapitalit social në Shqipëri bën të vështirë zhvillimin e një analize krahasimore për të shqyrtuar dinamizmin e indikatorëve në një periudhë të shtrirë kohore. Ato studime të pakta që kanë tentuar të hedhin dritë mbi rolin e kapitalit social në Shqipëri janë sporadike dhe të zhvilluara vetëm nga organizatat jo-fitimprurëse ndërkombëtare dhe kombëtare vetëm për disa nga indikatorët. Kjo vështirësi përbën dhe kufizimin e punimit qoftë në referenca apo në të dhëna që në disa raste duken të vjetëruara.

Autori është i vetëdijshëm se përdorimi i metodave përshkruese dhe interpretative lënë mundësi për të ngjallur dyshime shkencore. Referimi në të dhëna të importuara nga studime të tjera jo domosdoshmërisht i bën ato më pak të besueshme apo më pak të vlefshme. Unë kam synuar të zbërthej konceptin e kapitalit social dhe të operacionalizoj indikatorët e tij duke e parë atë me anë të disa lenteve teorike. Ky vendim është marrë duke pasur parasysh njohjen e pakët të konceptit në literaturën akademike shqipe dhe interesin për ta popullarizuar më tepër atë për studiuesit e ardhshëm. Qëllimi im nuk është të vërtetoj një teori të vetme dhe as të rrëzoj një teori të caktuar me fakte të gjetura prej analizave të mia. Përkundrazi unë kam dashur të paraqes sa më shumë qasje teorike që mbështesin rolin e kapitalit social në performancën institucionale pavarësisht rrugëve të ndryshme që ndjek secila prej tyre për të arritur në këtë përfundim.

Punimi është i natyrës holiste dhe ndërdisiplinare. Koncepti analizohet si në rrafshin sociologjik dhe atë të shkencave politike dhe paraqet një sfond të gjerë teorik duke u fokusuar në tri nga teoritë kryesore që kanë trajtuar konceptin kapital dhe atë social specifikisht teorinë sociale, teorinë e rrjeteve dhe teorinë e funksionalizmit si dhe nxjerr në pah kritikën që janë adresuar secilës prej tyre. Janë pikërisht tezat e Bourdieu,

Coleman dhe Putman që mbahen parasysh për të shpjeguar situatën e kapitalit social në Europën Qendrore dhe Lindore pas ndryshimeve në sistemet politike dhe në mënyrë më specifike në Shqipëri por ato nuk përdoren drejtpërsëdrejti si instrumente analitike.

Punimi është i natyrës cilësore dhe jo empirike duke u përqëndruar kryesisht në interpretimet e të dhënave dytësore për të dhënë dinamizimin në një hark kohor të disa prej indikatorëve kryesorë që e përbejnë konceptin kapital social. Në punim kombinohet modeli i analizës krahasimore me atë të rastit. Për sa i përket modelit të analizës krahasimore synohet të evidentohen dallimet ndërmjet Europës Lindore dhe asaj Perëndimore duke iu referuar vlerave të indikatorëve dhe variablave që i prodhojnë këto dallime në perëndim dhe në lindje. Ndërsa si rast studimor përfaqësues merret Shqipëria për të ilustruar marrëdhënien e qytetarëve me institucionet, nivelin e besimit, mundësitë që ofron terreni në vend për tu organizuar nëpër shoqata apo lëvizje sociale si dhe ndikimin që ka pasur e shkuara nën regjimin komunist.

Në bazë të tematikës kryesore si edhe rëndësisë së çështjeve, struktura fillon me hyrjen, vijon me katër kapituj analizë teorike dhe mbyllet me përfundimet. Në kapitullin e titulluar “Kapitali social dhe rëndësia e tij”, trajtohen fillimet e konceptit, teoritë e para, origjina dhe larmia e përkufizimeve, duke patur si fokus të veçantë punën e Robert Putnam. Në këtë kapitull përshkruhet rëndësia e kapitalit social, pikat e forta dhe dobësitë, elementet e pranuar universalisht si edhe natyra e konceptit, përpjekjet që janë bërë dhe vështirësitë për matjen e tij. Në kapitullin që vijon, studimi thellohet tek mënyra sesi kapitali social lidhet me performancën qeverisëse, duke përshkruar edhe nivelin e ndryshëm të besimit në vende të ndryshme, marrëdhënien me kapitalin social dhe besimit, si edhe modelet e marrëdhënieve me kapitalin social dhe qeverisjes. Në kapitullin me titull “Kapitali social si aset i rëndësishëm në jetën politike”, vendosen

në fokus funksionet e kapitalit social, veçanërisht për sa i përket përfshirjes sociale, hartimit të politikave dhe qeverisjes. Gjithashtu, një çështje me rëndësi të madhe është ajo që i dedikohet rrënjëve të kapitalit social në Europë, analizës së ndryshimeve mes vendeve në kontinent, si edhe përshkrimit të tranzicionit post-komunist dhe pasojave të ideologjisë socialiste për vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore. Kapitulli i fundit teorik, i dedikohet tërësisht kontekstit shqiptar, niveleve të besimit dhe besueshmërisë në Shqipëri, shqyrtuar për vitet 1998-2002, 2012-2013, 2014 dhe 2016, duke u mbështetur në studimet e kryera nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Fondacioni Friedrich Ebert, Instituti Demokratik Amerikan, dhe një sërë organizatash të tjera.

I. Kapitali social dhe rëndësia e tij

Kapitali social është një ndër termat më gjërësisht të diskutueshëm, që është pranuar nga disiplina të ndryshme dhe përshkruan fenomene të shumëllojshme të ndërlidhura me ndërveprimet shoqërore. Ky koncept ka qenë prej vitesh pjesë e debatit akademik dhe vazhdon të egzistojë një interes i madh lidhur me këtë çështje. Ideja themelore e "kapitalit social", është se familja, miqtë dhe bashkëpunëtorët përbëjnë një aset të rëndësishëm, të cilin mund ta përdorësh në rast krize ose për përfitime materiale. Komunitetet e pajisura me një rrjet të pasur social dhe shoqata qytetare, zakonisht janë në një pozitë më të fortë për t'u përballur me varfërinë dhe dobësitë (Moser 1996; Narayan 1997), për të zgjidhur konfliktet (Schafft & Brown 2000), ose për të përfituar nga mundësitë e reja (Isham 1999). Nga ana tjetër, mungesa e lidhjeve shoqërore mund të ketë një ndikim po aq të rëndësishëm sa prania e tyre.

1.1 Origjina dhe përkufizimet

Nocioni i kapitalit social është zhvilluar prej shumë kohësh, falë kontributit të një sërë teoricienëve. Ideja që të tjerët dhe burimet e tyre kontribuojnë në mënyrë domethënëse për arritjet tona personale nuk është ndonjë gjë e re, por është dashur të përshkohet një rrugë e gjatë për ta kuptuar. Termi kapital social është përmendur aksidentalisht në shek. XIX (Lin); autorë të tjerë (Borgatti, 1998; Paxton, 1999) e kanë gjurmuar termin në punën e Hanifan (1920) dhe Jacobs (1961). Rossi (1966) ka përmendur herët termin burime sociale dhe Laumann (1966, 1973) ka shqyrtuar herët lidhjen mes statusit socio-ekonomik dhe burimeve sociale.

1.1.1 Hulumtimi i Literaturës

Kuptimi i përgjithshëm (financiar, politik, njerëzor, kulturor) i burimeve si kapital ka qenë përfshirë me sukses në hulumtimet sociale dekada më parë. Kapitali në përgjithësi kuptohej si një gjendje (në një moment të kohës) e mallrave kapitale të ndryshme, ku mallrat kapitale janë "mallra të prodhuara të cilat kërkohen për prodhim, pavarësisht konsumit" (Hennings, 1987: 327). Në fund, kjo ide u transferua edhe në studimin e marrëdhënieve sociale dhe rrjeteve sociale. Përmes kontributit të dhënë nga disa autorë, gradualisht u pranua një perspektivë e burimeve sociale në të cilën merrej në konsideratë kapitali social. Në rastin e kapitalit social, të mirat kapitale në përkufizimin e Hennings përfaqësohen nga burimet në pronësi të anëtarëve të rrjetit social, ndërsa "konsumi" mund të imagjinohet si vetë burimet, si edhe marrëdhëniet me anëtarët e rrjetit social. Një paralelizëm mes konceptit të kapitalit social dhe të kuptuarit tradicional të kapitalit është se përfitimet nga marrëdhëniet shoqërore (burimet shoqërore) janë të mundura vetëm në qoftë se paraprihen nga investimet, që nuk janë gjë tjetër veçse burime të shpenzuara për të tjerët me qëllim që në një moment të caktuar të kthehen mbrapsht (Flap, 2004).

Gjatë dy dekadave të fundit, ideja e kapitalit social ka treguar se është e frytshme në studimet sociale. Është bërë e ditur se ajo mund të hedhë dritë mbi shpërndarjen e burimeve sociale brenda një shoqërie (Flap, 1999, 2004), dhe mund të zgjerojë njohuritë për mënyrat se si njerëzit mund t'i bëjnë veprimet e tyre në përgjithësi më produktive dhe efektive (Lin, 1999a). Zhvillimi i teorisë së kapitalit social ka ndezur edhe një sërë pyetjesh sociologjike të reja. Pyetjet tradicionale në lidhje me marrëdhënien mes background-it social, kapitalit njerëzor dhe ambicies tani mund të zgjaten me efektet e

marrëdhënieve mbi të tjerët: çfarë arrihet me meritë individuale, dhe çfarë arrihet duke njohur njerëzit e duhur? Cilat kontakte janë të dobishme, nën cilat rrethana, dhe cilat nuk janë? Pse burimet ndonjëherë “dështojnë”? Dhe pse disa njerëz duket se njohin kaq shumë të tjerë? (Flap, 2004). Hulumtimi i kapitalit social gjithashtu premtonte të ofrojë njohuri të reja në kërkimet sociale dhe kërkimet mbi rrjetin e burimeve sociale, duke ofruar një kornizë teorike, në të cilën zhvillimi i rrjeteve sociale, dhe efektet e tyre në arritjen e qëllimave mund të bashkohen. Kapitali social është një nocion i fuqishëm dhe i dobishëm për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me pabarazinë sociale, kohezionin social, dhe ndërlidhjen e dy fushave (Flap, 1999, 2004).

Duke qenë i lidhur me konceptet e shoqërisë civile dhe atë të lidhjeve sociale, disa dijetarë gjurmojnë mbështetjet teorike të nocionit të kapitalit social në mendimtarët e shekullit XIX (Adam dhe Ronçeviç, 2003; Putnam 1993). Alexis de Tocqueville (1863: 130) për shembull, pretendon se fuqia e demokracisë amerikane qëndron tek prirja e qytetarëve të saj për të formuar shoqata civile në mënyrë që të arrijnë bashkarisht objektin e dëshirave të tyre të përbashkëta. " Këto shoqata, thotë ai, i edukojnë njerëzit që të bashkëpunojnë, t'i japin formë vetëdijes së tyre publike dhe nxisin solidaritetin mes anëtarëve të tyre, të cilët në fund, u japin jetë shoqërisë civile (1863: 132). Më vonë, Émile Durkheim (1893) postuloi pjesëmarrjen në grupe si “kundërhelm” për çrregullimet sociale dhe vetë-shkatërrimin, ngjallur nga Revolucioni Industrial.

Konceptet e hershme të kapitalit (koleksionet e burimeve nën pronësi private) merrnin në konsideratë kryesisht burimet materiale dhe financiare (Quesney, 1766; Turgot, 1770; cituar në Hennings, 1987). Përfundimisht, ishte Marx (1867) ai që përfshiu një operacionalizim financiar të 'kapitalit' në një paradigmë të pabarazisë. Weber më pas

(1921) e specifikoi konceptin në drejtim të kapitalit (ekonomik) përgjatë idesë se pasuritë në përgjithësi, dhe paratë në mënyrë më specifike, lehtësojnë prodhimin dhe arritjen e qëllimit dhe për këtë arsye mund të na blejnë mundësi. Përveç kësaj, Weber dallonte kapitalin politik, që përcaktonte autoritet si mjet prodhimi : aftësia për të kërkuar pushtet ofron gjithashtu mundësi. Megjithatë, koncepti i kapitalit social, u prezantua për herë të parë nga Lyda Judson Hanifan (1916: 130) e cila i referohej atij si "vullnet i mirë, shoqëri, simpati reciproke dhe marrëdhënie sociale mes një grupi individësh dhe familjesh të cilët përbëjnë një njësi sociale". Në fillim të viteve 1960 aftësitë personale dhe njohuritë filluan të konsideroheshin si burime që mund të bëjnë dallim mes rezultateve individuale, dhe u drejtuan drejt nocionit të kapitalit njerëzor (Becker, 1964; Johnson, 1970; Schultz, 1961). Vlera e dikujt në tregun e punës varet nga produktiviteti individual, i cili mund të përmirësohet me anë të arsimit. Ky koncept mundësonte një shpjegim më të mirë se pse njerëzit me arsimin më të mirë, njohuritë, dhe më shumë përvojë gjenin punë më të mira. Përveç kësaj, Bourdieu (1973, 1984) paraqiti idenë e kapitalit kulturor, duke iu referuar mbledhjes së njohurive kulturore që mund të punojnë në të mirë të individëve, me kusht që të bëhet produktive në mjedisin e duhur.

Woolcock dhe Narayan (2000: 3) theksojnë se ideja themelore e kapitalit social është që familja, miqtë dhe bashkëpunëtorët e një personi përbëjnë një aset të rëndësishëm, i cili mund të ndikojë jashtëzakonisht në situatë krize. Ky kapital mund të jetë një element i rëndësishëm në fitoren e një çështjeje të caktuar. Fakti që kërkojmë mbështetje përgjatë një sprove, fakti që daljet dhe shëtitjet me miqtë janë pjesë e programeve tona të përditshme, ose fakti që kërkojmë një punë të re, i bën njerëzit që njohim kaq të rëndësishëm. Për më tepër, autorët pohojnë se ajo që vlen për njerëzit, vlen gjithashtu

edhe për komunitetet: ata që kanë një stok kapitali social më substancial janë më të aftë për të negociuar në mënyrë të efektshme nëpër sfida të ndryshme (Adler dhe Kwon, 2002: 17-40).

Pavarësisht elementeve të përbashkëta që mbivendosen në përcaktimet e ndryshme të kapitalit social, asnjë prej këtyre teorive të hershme nuk siguron një koncept të plotë. Koncepti i kapitalit social siç kuptohet në ditët e sotme rrjedh kryesisht nga veprat e Pierre Bourdieu, James S.Coleman dhe Robert Putnam.

1.1.2 Tre baballarët themelues të konceptit

Studimi i qasjeve dominuese të kapitalit social thekson një interes të përbashkët të përgjithshëm për mënyrën sesi dinamika e marrëdhënieve sociale do të mund të ishte një aset i rëndësishëm dhe gjenerator rezultatesh të ndryshme. Për shembull, Bourdieu (1986) ka hulumtuar mënyrën sesi elitat mund të përdorin rrjetet e tyre sociale për të përforcuar dhe për të riprodhuar statusin e tyre të privilegjuar. James Coleman (1988) ka venë re se si kapitali social prodhon kohezion në gjirin e komuniteteve dhe po ashtu ndihmon në mbështetjen e familjeve dhe shpresave që ato kanë për arsimimin e fëmijëve të tyre, duke ndikuar në uljen e normave të braktisjes së shkollave të mesme. Putnam (1993, 2000) argumenton se rrjetet e angazhimeve komunitare mund të krijojnë norma reciprociteti dhe një prirje drejt besimit, të cilat mund të nxisin bashkëpunimin social dhe efikasitetin e institucioneve demokratike. Në veçanti, siç u tha më lart, qasjet dominante mund të ndahen gjerësisht në ato që fokusohen në kapitalin social si një formë e strukturës së rrjetit social, dhe ata që marrin një qasje më funksionale dhe e konsiderojnë kapitalin social si të gjitha burimet sociale që mundësojnë bashkëpunim efektiv. Në praktikë, ky dallim ka një ndikim të madh në aftësinë për të përcaktuar se si

është ndërtuar dhe si funksionon kapitali social. Aftësia për të dalluar kapitalin aksionar nga përcaktuesit e tij dhe rezultatet e tij gjithashtu është e rëndësishme. Nëse marrim parasysh kapitalin social si një formë e veçantë kapitali, dhe në qoftë se ky nocion është i dobishëm për kërkimin dhe eksplorimin e politikave të zhvillimit, në mënyrë ideale duhet përcaktuar qartë se ku konsiston kapitali social, duke shqyrtuar potencialin e tij produktiv dhe duke identifikuar mjetet me të cilat mund të investohet dhe të akumulohet. Qasjet e kapitalit social bazuar te rrjetet sociale dalin në pah ndoshta më mirë në këtë mënyrë. Para se të eksplorojmë nevojën e kësaj qasjeje, mund të konsiderojmë edhe meritat e një konceptimi funksionalist të kapitalit social.

Bourdieu

Kundër sfondit të hetimit të ekzistencës së klasave sociale dhe funksionimit të strukturave të shpërndarjes, Bourdieu (1980: 2; 1986: 248) e përcakton kapitalin social si "agregat i burimeve aktuale apo burimeve të mundshme të cilat janë të lidhura me posedimin e një rrjeti të qëndrueshëm marrëdhëniesh e njohjesh të ndërsjellta pak a shumë të institucionalizuara". Me fjalë të tjera, rrjetet sociale të krijuara dhe të mirëmbajtura nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe përbëjnë një instrument, një aset për individët për të rritur kapitalin e tyre ekonomik. Sipas Bourdieu (1986: 249), kapitali social gjenerohet kolektivisht dhe është në pronësi kolektive.

Këto marrëdhënie mund të ekzistojnë vetëm në gjendjen praktike, në shkëmbime materiale dhe / ose simbolike që ndihmojnë në ruajtjen e tyre. Ato gjithashtu mund të krijohen dhe garantohen në mënyrë shoqërore duke përdorur një emër të përbashkët (emri i një familje, një klase, një fisi ose një shkolle, një parti, etj.) Dhe nga një tërësi aktesh institucionale të hartuara njëkohësisht formojnë dhe informojnë ata që i

nënshtrohen; Në këtë rast, ato janë pak a shumë të miratuara dhe të mirëmbajtura dhe të përforcuara, në shkëmbime. Vëllimi i kapitalit shoqëror në zotërim të një agjenti të caktuar varet nga madhësia e rrjetit të lidhjeve që ai mund të mobilizojë në mënyrë efektive dhe nga vëllimi i kapitalit (ekonomik, kulturor ose simbolik) që i zotëron ai vetë ose secili prej atyre që ky agjent është i lidhur. Fitimet që rrjedhin nga anëtarësimi në një grup janë baza e solidaritetit që i bën ato të mundshme. Ekzistenca e një rrjeti lidhjeje nuk është e dhënë natyrore, madje as një shoqëri e dhënë, e përbërë njëherë e përgjithmonë nga një akt fillestar krijimi, i përfaqësuar në rastin e grupit të familjes, nga përkufizimi gjenealogjik i marrëdhënieve farefisnore, të cilat janë karakteristike e një formacioni shoqëror. Me fjalë të tjera, rrjeti i marrëdhënieve është produkt i strategjive të investimeve, individuale ose kolektive, me qëllim ose me vetëdije, që synojnë krijimin ose riprodhimin e marrëdhënieve shoqërore të cilat janë të përdorshme drejtpërdrejt në afat të shkurtër apo të gjatë. Shkëmbimi i transformon gjërat e shkëmbyera në shenja njohje dhe nëpërmjet njohjes së ndërsjellë dhe njohjes së anëtarësisë në grup që ai nënkupton, riprodhohet grupi. Në të njëjtën mënyrë, shkëmbimi riafirmon kufijtë e grupit, domethënë, kufijtë përtej së cilës përforcohen tregtia, bashkësia ose martesat - nuk mund të ndodhë. Secili anëtar i grupit është krijuar si kujdestar i kufijve të grupit: sepse përkufizimi i kriterëve të hyrjes është në rrezik me çdo hyrje të re. Riprodhimi i kapitalit social presupozon një përpjekje të pandërprerë të shoqërisë, një seri të vazhdueshme të shkëmbimeve në të cilat njohja riafirmohet pafundësisht. Nëse konkurrenca e brendshme për monopolin e përfaqësimit legjitim të grupit nuk është që të kërcënojë ruajtjen dhe akumulimin e kapitalit që është baza e grupit, anëtarët e grupit duhet të rregullojnë kushtet e qasjes në të drejtën për të deklaruar veten Anëtar të grupit dhe mbi të gjitha, të vendoset si përfaqësues (delegat,

zëdhënës, etj.) i të gjithë grupit, duke e angazhuar kështu kapitalin shoqëror të të gjithë grupit. Titulli i fisnikërisë është forma e parë exellence e kapitalit social të institucionalizuar që garanton një formë të veçantë të marrëdhënieve sociale në mënyrë të qëndrueshme. Një grup si tërësi mund të përfaqësohen, nga një nëngrup, i njohur për të gjithë, dhe nga të gjithë, dhe që mund të flasin në emër të të gjithë grupit, dhe ushtrojnë autoritetin në emër të të gjithë grupit. Në mënyrë të ngjashme, fenomenet si "kulti i personalitetit" ose identifikimi i partive, sindikatave ose lëvizjeve me udhëheqësin e tyre janë latentë në logjikën e përfaqësimit. Shenjuesi zë vendin e të kuptuarit, zëdhënësit të grupit që ai duhet të shprehë, jo për arsye se dallueshmëria e tij, shquarja e tij përbëjnë pjesën thelbësore, e cila duke u vendosur plotësisht brenda logjikës së dijes dhe pranimet, është në thelb një fuqi simbolike. Por edhe sepse përfaqësuesi, shenja dhe emblema krijojnë të gjithë realitetin e grupeve që marrin ekzistencë sociale efektive vetëm dhe vetëm nëpërmjet përfaqësimit.

Coleman

Aktualisht, konceptualizimi funksionalist i kapitalit social është ndoshta qasja e miratuar më gjerësisht dhe më me ndikim. Kërkime mjaft të mira në qasjen funksionaliste ndaj kapitalit social janë bërë nga sociologu amerikan James Coleman (1988, 1990). Sipas Coleman (1990: 302), kapitali aksionar përbëhet nga aspektet e një strukture shoqërore që lehtësojnë ndërhyrjet e aktorëve brenda saj. Coleman identifikon format e mëposhtme të kapitalit social: obligimet dhe pritshmëritë, besimin, fuqinë e informacionit, normat dhe sanksionet efektive, marrëdhëniet e autoriteteve, organizatat shoqërore dhe rrjetet sociale.

Coleman (1988) ka meritën e madhe për futjen dhe formulimin e qartë të konceptit të kapitalit social. Një koncept i dytë dhe më i gjerë i kapitalit social e përcakton kapitalin social si "një shumëllojshmëri të subjekteve të ndryshme, me dy elemente të përbashkëta: të gjitha ato përbëhen nga disa aspekte të strukturës sociale, dhe lehtësojnë veprimet e caktuara të aktorëve (qofshin aktorët personale apo të korporatave) në kuadër të strukturës " (1988: 598). Kjo e zgjeron konceptin që të përfshijë si shoqatat horizontale ashtu edhe ato vertikale, dhe gjithashtu sjelljen ndërmjet subjekteve të tjera si për shembull firmat. Shoqatat vertikale karakterizohen nga marrëdhënie hierarkike dhe nga një shpërndarje e pabarabartë e fuqisë midis anëtarëve. Në mënyrë të qartë, kjo gamë e gjerë shoqatash mbulon një gamë të gjerë objektivash, si pozitive ashtu edhe negative. Coleman është i qartë në lidhje me këtë: "Një formë e caktuar e kapitalit social që është e vlefshme për lehtësimin e veprimeve të caktuara, mund të jetë e padobishme, ose madje edhe e dëmshme për të tjerët ". Në fakt, kjo pamje e kapitalit social kap strukturën shoqërore në përgjithësi, si dhe tërësinë e normave që rregullojnë sjelljet ndërpersonale. Ai e përcakton kapitalin social si "detyrimet dhe pritshmëritë, kanalet e informacionit, dhe normat sociale "(Coleman, 1988: 95), si edhe si "disa aspekte të strukturës sociale që mundësojnë arritjen e skajeve të caktuara, të cilat nuk do të ishin të arritshme në mungesë të tij" (Coleman, 1990: 304).

Në mënyrë të ngjashme me Bourdieu, Coleman thotë se kapitali social "trashëgon strukturën e marrëdhënieve ndërmjet dhe midis aktorëve" (Coleman, 1988: 98). Ai pranon se nuk ka "një njësi të vetme", por ka një shumëllojshmëri të subjekteve të kapitalit social, të cilat kanë të gjitha dy elemente të përbashkëta: " të gjitha përbëhen nga disa aspekte të strukturave sociale, dhe ato lehtësojnë disa lloje veprimesh të aktorëve "(1988: 98). Coleman identifikon lloje të ndryshme të marrëdhënieve

shoqërore që funksionojnë si një burim për individët. Para së gjithash, ai përshkruan një regjim të detyrimeve dhe pritshmërive, të karakterizuara nga besimi i ndërsjelltë midis individëve. Lidhjet familjare dhe lidhjet mes organizatave të komunitetit social funksionojnë si një lloj sigurimi, duke rritur ndjenjën e detyrimit të aktorëve për të mbështetur pjesën e tyre të marrëveshjes, ndërkohë që të tjerët mund të besojnë në përmbushjen e angazhimit . Përveç kësaj, Coleman e citon kapitalin social si një mënyrë për të kanalizuar informacionin dhe si një burim të normave dhe sanksioneve efektive. Ndërkohë që si fillim rrit besimin në mesin e aktorëve përmes fitimit të njohurive në lidhje me veprimet e tyre respektive, më vonë u jep atyre sigurinë duke rregulluar veprimet dhe dekurajuar tradhëtitë. Edhe pse autori nuk tregon nëse këto forma mund të ekzistojnë në mënyrë të pavarur, punimi i tij sugjeron se ato janë të ndërrvarura dhe bashkarisht të nevojshme për forcimin e supozuar të "besueshmërisë së mjedisit social", në të cilën mbështetet nocioni i kapitalit social të Coleman.

Putnam

Nëse Coleman ishte promotori kryesor i një përkufizimi funksionalist të kapitalit social, ndikimi i gjerë i këtij koncepti në programet kërkimore duhet t'i atribuohet në masë të madhe punës së hershme mbi kapitalin social të profesorit të shkencave politike Robert Putnam, profesor i Universitetit të Harvardit (1993, 1995). Edhe pse Coleman (1990: 302) e ka konceptuar në mënyrë të qartë kapitalin social si një pasuri për njerëzit, Putnam u interesua më shumë në studimin e mënyrave në të cilat kapitali social shihet si një pasuri kolektive. Një përkufizim të ngjashëm propozoi edhe në një artikull të vitit 1995 me titull "Bowling Alone", ndikimi i të cilit ka qenë i konsiderueshëm, në të cilën Putnam lë të kuptohet se rënia e kapitalit social në Shtetet e Bashkuara - nën formën e

një erozioni të angazhimit qytetar - e kishte penguar efektivitetin e institucioneve publike.

Putnam (1993) më vonë paraqiti një kthesë konceptuale: ndërkohë që bazohej në dy elemente qëndrore të Coleman, besimi dhe rrjetet sociale, Putnam argumenton se kapitali social është pronësi e komuniteteve dhe kombeve (Portes, 1998: 18). "Kapitali social këtu i referohet tipareve të organizimit shoqëror, si besimit, normave dhe rrjeteve, që mund të përmirësojnë efikasitetin e shoqërisë duke lehtësuar veprimet e koordinuara "(Putnam, 1993: 167). Në studimin e tij të performancave institucionale ndër-rajonale në Itali, Putnam identifikoi kapitalin social si përcaktues kryesor të një demokracie të suksesshme (Putnam, 1993: 185), për shkak se institucionet vendosin si parakusht "aftësitë ndërpersonale dhe besimin" për bashkëpunimet efektive (Putnam, 1993: 180). Ai arsyeton se komunitetet me nivele të larta të kapitalit social janë më të afta për të organizuar veten e tyre dhe për tua komunikuar kërkesat e tyre në mënyrë më efektive institucioneve qeveritare, ndërsa këto të fundit nga ana tjetër janë më të përgjegjshme (175, 182). Me fjalë të tjera, besimi social, normat e reciprocitetit dhe rrjetet e angazhimit qytetar formojnë një "rreth të virtytshëm" (177-80). Për më tepër, ata formësojnë karakterin e shoqërisë civile, duke e bërë atë përgjithësisht më të besueshme dhe "qytetare". Në kontrast me përkufizimin e gjerë të Coleman, duke përfshirë një shumëllojshmëri të marrëdhënieve shoqërore, Putnam fokusohet në një formë të veçantë të kapitalit social, përkatësisht tek rrjetet horizontale të shoqatave vullnetare. Fakti që çdo anëtar ka të njëjtën fuqi ndihmon për të kapërcyer mosbesimin e ndërsjelltë dhe fuqizon pjesëmarrësit duke i inkurajuar të angazhohen në bashkëpunim, i cila për pasojë, mbështetet tek besimi social (115,174). Gjithashtu, duke e barazuar kapitalin social me "qytetarinë", Putnam shkon përtej nocionit burimor të Coleman dhe e

portretizon kapitalin social si një kulturë qytetare, të rrënjosur thellë në histori. Kundër kësaj qasjeje, Ronald Inglehart (1997: 188) përcakton kapitalin social si "kultura e besimit dhe tolerancës, nga e cila dalin rrjetet e gjera të shoqatave vullnetare".

Megjithatë, është e qartë se konceptualizimi funksionalist i kapitalit social siç është propozuar nga Coleman dhe Putnam nuk do të kishte gjetur një audiencë të tillë, nëse idetë themelore nuk do të kishin merita të konsiderueshme. Interesi mbi rolin që luajnë marrëdhëniet shoqërore si katalizatorë dhe përforcues të rezultateve të ndryshme është parë nga shumë studiues si një korrigjim i qasjeve të ekonomisë dhe politikës, të cilat më parë kishin anashkuar rëndësinë e sferës sociale. Për më tepër, problemi themelor që kjo qasje përpiket të zgjidhë, qoftë për individët apo komunitetet, është bindëse. Grupet, familjet, lagjet dhe shoqëritë në të cilat qytetarët janë të gatshëm për të bashkëpunuar dhe janë të gatshëm të besojnë njëri-tjetrit, dhe në të cilat veprimi kolektiv është i mirëpritur, do të jenë në gjendje të bëjnë më shumë për anëtarët e tyre se grupet, familjet, lagjet dhe shoqëritë e privuara nga këto attribute. Megjithatë, dallimet e shprehura mes niveleve të bashkëpunimit dhe mbështetjes së veprimeve kolektive nxjerrin në pah vështirësitë e qenësishme në arritjen e tyre. Qasja funksionaliste synon të identifikojë faktorët që përditësojnë potencialin produktiv nga të qenët i shoqërueshëm dhe në këtë mënyrë hap rrugën për një zhvillim të mundshëm përmes ndërhyrjes në formën e politikave publike (Healy dhe Cotè, 2001). Kjo qasje funksionaliste e kapitalit shoqëror përveç se ka marrë miratime, gjithashtu është kritikuar rëndë. Për shembull, përkufizimi i paqartë i Coleman dhe "lista e bardhë" e formave - një listë që kombinon në mënyrë shumë të diskutueshme përcaktuesit, shkaqet dhe rezultatet e kapitalit social - janë kritikuar nga Portes (1998), sipas të cilit “është krijuar konfuzion dhe kundërthënie në literaturë për sa i përket kapitalit social”.

Gjithashtu, Portes beson se qasja funksionaliste është tautologjike dhe nuk mund të krijojë një ndarje të duhur ndërmjet përcaktimit të konceptit në një këndvështrim sa teorik po aq edhe empirik.

Të shumtë janë ata që janë interesuar për mënyrën sipas së cilës institucionet publike, po ashtu edhe organet e tjera politike dhe gjyqësore, përbëjnë forma të kapitalit social duke promovuar dhe koordinuar një veprim kolektiv publik. Në të vërtetë, qasja funksionaliste çon në një listë gjithnjë e më të gjatë elementesh që mund të konsiderohen si forma të kapitalit social. Megjithatë, kjo listë që nuk resht së zgjatur, nganjëherë ndërlikon izolimin e kapitalit aksionar të formave të tjera të kapitalit, duke rigrupuar fenomene të ndryshme, me dinamika të ndryshme, madje edhe kontradiktore. Për shembull, një ekonomi e fortë dhe me një prurje burimesh të shpërndara në mënyrë të barabartë mund të konsiderohet si një formë e kapitalit social në rast se promovon sjellje bashkëpunuese. Në mënyrë të ngjashme, njohja e dinamikës ndërpersonale dhe aftësive sociale mund të jetë e favorshme për bashkëpunim. Përkundrazi, fakti i të përcaktuarit të tyre si "kapitali social" mund të errësojë më shumë se sa të qartësojë kuptimin e tyre. Qasja funksionaliste grumbullon fenomene të shumta nën një etiketë, duke fshehur dinamikën e tyre dhe duke dëmtuar zhvillimin e një bazë solide për kërkime rigorozë dhe, në fund të fundit, zhvillimin e një politike të bazuar në prova.

Çështja e gjerë e identifikimit të burimeve të bashkëpunimit social dhe veprimit kolektiv mbetet një arsye e vlefshme për hulumtime të mëtejshme. Studime serioze dhe të kujdesshme mund të përdorin një përkufizim funksionalist duke shmangur kurthet e mundshme të kësaj qasjeje. Megjithatë, një përkufizim funksionalist mund të rrezikojë të mbështesë kërkime shpesh të çorientuara që e errësojnë më shumë se sa e ndriçojnë

këtë qasje. Për më tepër, përpjekjet e konsolidimit në një teori të vetme të të gjitha fenomeneve të gjeneratorëve të veprimeve kolektive mund të jenë një kompleksitet i pakapërcyeshëm dhe në një periudhë të gjatë kohore, mund të kufizojnë dobinë e këtij koncepti për kërkimin dhe zhvillimin e politikave. Një përkufizim më i qartë i kapitalit social, që nuk lë në harresë çështjet themelore të ngritura nga qasjet funksionaliste mund të ndihmonte shmangien e një rrugë pa krye.

Përkufizime të tjera në literaturë përfshijnë: "Institucionet, marrëdhëniet dhe normat që formësojnë cilësinë dhe sasinë e ndërveprimeve sociale të një shoqërie" (Banka Botërore); "Rrjetet së bashku me normat e përbashkëta, vlerat dhe kuptimet që lehtësojnë bashkëpunimin brenda ose midis grupeve" (OECD, 2001); "Tiparet e organizimit shoqëror, të tilla si pjesëmarrja qytetare, normat e reciprocitetit dhe besimi tek të tjerët, që lehtësojnë bashkëpunimin për përfitim reciprok" (Kawachi et al, 1997); "Rrjetet, normat dhe marrëdhëniet që ndihmojnë komunitetet dhe organizatat të punojnë në mënyrë më efektive" (MacGillivray, 2002).

1.1.3 Një koncept shumëdimensional

- Efekte të fuqishme kanë rezultuar edhe falë lagjes ose grupeve të bashkëmoshatarëve, të cilat mund të jenë pozitive ose negative në varësi të kontekstit dhe aspiratave arsimore të grupit (Sun, 1999).

Një sërë efektesh të tjera nënvizojnë rëndësinë e kapitalit social:

-Marrëdhëniet më të gjera sociale, dhe karakteri i shoqërisë rreth e rrotull, mund të kenë një rol në shëndet përmes ndikimit në perceptimet e individëve për statusin e tyre social; stresin; forcën e lidhjeve sociale (lidhjet më të dobëta sociale janë të ndërruara me shëndetin e dobët); vështirësitë e përditshme dhe ndjenjat më të përgjithshme të sigurisë dhe frikës (Wilkinson, 2002);

-Kapitali social, veçanërisht ai i siguruar nga familja dhe miqtë e ngushtë, ofron ndihmë konkrete dhe kujdes e gjithashtu krijon një ndjenjë mirëqënieje e përkatësie, ndërsa mungesa e tij çon në izolim dhe depresion (Brown dhe Harris, 1978);

-Marrëdhëniet mbështetëse dhe stresi social, kanë gjithashtu efekte të rëndësishme mbi fiziologjinë e njeriut dhe funksionimin e sistemit imunitar, dhe kjo ndihmon për të shpjeguar ndikimin e tyre mbi shëndetin fizik. Edhe akti i thjeshtë i të paturit besim ka dëshmuar ndikime të rëndësishme pozitive në funksionimin e sistemit imunitar të njeriut (Kennedy et al., 1990).

1.3 Problemi i matjes së kapitalit social

Sasia e madhe e studimeve të përkushtuara ndaj kapitalit social, dhe rritja gati shpërthyes e fushës në gjysmën e dytë të viteve 1990 ka sjellë një numër të madh problemesh. Një nga këto është që po rritet rreziku që “kapitali social” mund të bëhet një frazë e uritur që mund të ngecë në çdo hulumtim që përfshin çdo gjë sociale, dhe mund të përdoret për të tërhequr vëmendjen nga kërkimet më të vjetra. Disa autorë kanë bërë thirrje që të bëhet kujdes për parandalimin e shndërrimit të kapitalit social në një “frazë gjithëkapërfshirëse”, dhe përqëndrimin në problemet specifike dhe çështjet brenda fushës (Flap, 2004; Paldam 1999; Lin, 1999a).

Ka pasur shumë diskutime rreth asaj se si kapitali social duhet të matet, duke shfaqur një numër problemesh të veçanta. Më e rëndësishmja nga këto është renditja e larmisë së koncepteve teorike që luajnë një rol në nivele të ndryshme në të cilët mund të kuptohet kapitali social. Matjet e drejtuara nga teoria mbi kapitalin social kanë qenë relativisht të rralla, dhe shpesh të një natyre shumë *ad hoc*, duke treguar standartizim të ulët (Flap 1999; Snijders 1999; Lin, 1999a, 2001a). Shumë studime parashikojnë meritat e cilësive specifike dhe shpërndarjes së kapitalit social në nivel teorik, por shpesh elemente të ngjashme janë vënë në zbatim ndryshe. Për më tepër, një bollëk masash është zhvilluar duke u bazuar në të dhënat që nuk janë projektuar specifikisht për matjen e kapitalit social, por janë në dispozicion për analizë (Van der Gaag dhe Snijders, 2004). Megjithatë, ekziston nevoja për matje të standardizuara, për shkak se është bërë e paqartë nëse të gjitha këto operacionalizime të ndryshme u përkasin të njëjtave koncepte, ose u referohen elementeve të veçanta. Mungesa e mundësive për krahasime strukturore e ka bërë të vështirë testimin e plotë dhe specifik të kapitalit

social, dhe pengon zhvillimin empirik dhe teorik në fushë, për të cilën informacioni i besueshëm sasior është i nevojshëm (Flap, 1999, 2004; Snijders, 1999).

Kapitali social është një koncept i përbërë, dhe secili prej elementeve të tij është subjekt ndryshimi, gjë që e bën atë të vështirë për t'u kapur dhe për të matur besueshmërinë e konceptit (Flap, Snijders, dhe Van winden, 1996). Për disa kohë, egzistonte një farë ngurrimi në fushën e kapitalit social në zhvillimin e matjeve, për shkak të kompleksitetit të konceptit. Një thënie e Coleman shpesh kthehej në diskutime: “A do të jetë kapitali social një koncept i dobishëm sasior në shkencat sociale siç janë konceptet e kapitalit financiar, kapitali fizik, dhe kapitali njerëzor? Mbetet për t'u parë!”. Vlera e tij aktuale qëndron kryesisht në dobinë e tij për analiza cilësore të sistemeve sociale dhe për ato analiza sasiore që përdorin treguesit cilësorë (Coleman, 1990: 304-5). Ndryshe nga format e tjera të kapitalit, kapitali social nuk është automatikisht në dispozicion të individit, dhe i referohet burimeve të zotëruara nga aktorë të tjerë: "Nuk ka të drejta ekskluzive mbi kapitalin social "(Burt, 1992: 9).

Disa autorë shohin konflikt në këtë fushë dhe theksojnë se ka më shumë diferencë konceptuale sesa metodologjike (Van Deth, 2003). Përbërësit e ndryshëm të kapitalit social që identifikohen në nivelin teorik (ndryshimet, burimet, marrëdhëniet, dhe/ose normat dhe masat e besimit), e bëjnë atë një koncept shumëdimensional. Vetëm me thjeshtëzim ekstrem mund të përmblihet me një matje të vetme.

Për fat të mirë, janë zhvilluar mendime produktive në matjen sasiore të kapitalit social. Edhe pse ndoshta në mënyrë implicite, Bourdieu (1980) e nisi idenë me përdorimin e termit “vëllim” si sasi teorike e kapitalit social. Ai e përcaktoi këtë si një funksion të madhësisë së rrjetit dhe vëllimit të kapitalit (financiar, kulturor, human) të zotëruar nga

individë brenda rrjetit. Flap (2002, 2004) e shtjelloi këtë duke thënë se, përveç se zotërojnë burime, anëtarët e rrjetit gjithashtu duhet të jenë të gatshëm për të lejuar aksesin në burimet e tyre.

Theksimi strukturor i matjes së kapitalit social bazohet në studimin e lidhjeve të ndërsjella të rrjetit social, dhe nisi në fillim të viteve 1970 me nocionin e “forcës së lidhjeve të dobëta” të Granovetter, që pohonte se pozita të caktuara të një individi në një rrjet social marrin për të mirëqenë kthimin mbrapsh të kapitalit social. Të tjerë e përpunuan këtë ide, duke sugjeruar se meqë nga pozita të caktuara të rrjetit kthimi mbrapsh i kapitalit social ndodh më mirë, cilësitë strukturore të këtyre rrjeteve mund të përdoren për të përmbledhur kapitalin social të një personi (Borgatti, Jones, dhe Everett, 1998). Për shkak se morën më shumë vëmendje, hulumtimet rreth rrjetit social kanë qenë relativisht të standardizuara mirë.

Hulumtuesit që u fokusuan në matjet e burimeve të përfshira në rrjetet sociale përkthyen matjen e kapitalit social me hyrjen e anëtarëve të rrjetit social në pozita të caktuara në shoqëri, nga e cila mund të përmbledhen disa karakteristika të kapitalit të tyre social (Flap, 1991, 1999, 2002, 2004; Lin, 1999a, 2001a; Lin & Dumin, 1986; Erickson, 1996, 1998, 2001, 2004a). Kjo ka rezultuar në dy nocione të rëndësishme. Së pari, kapitali social që tregon më shumë diversitet në marrëdhënie dhe burime është më i dobishëm (Flap, 1991: 6182, Erickson, 2003). Së dyti, ai është i dobishëm për njerëzit që duan të arrijnë në pozitat më të larta në hierarki, pasi ato kontrollojnë më shumë burime, kanë më shumë informacione në lidhje me të tjerët, dhe kanë më shumë influencë (Lin & Dumin, 1986; Lin, 2001a: 64-65). Shumë studime kanë përcaktuar sasinë e idesë së kapitalit social, por e vënë theksin vetëm në disa nga elementet e tij. Për matjen e kapitalit social, rekomandohet përfshirja e katër dimensioneve të mëposhtme: 1)

anëtarët e rrjeteve në të cilat dikush ka akses 2) burimet e tyre 3) disponueshmërinë e këtyre burimeve për dikë 4) strukturën e rrjetit social (Flap, 2002, 2004).

Matja e kapitalit social duhet të përqendrohet në zhvillimin e matjeve që kapin koleksionet e përgjithshme të burimeve sociale, për një popullsi të përgjithshme, që mund të tregojnë kontrast mes grupeve sociale në mundësinë e tyre për të hyrë ose përdorur burimet sociale.

Nëse qëllimi është matja e kapitalit të përgjithshëm social do të thotë që duhen pasur parasysh burimet sociale që shërbejnë për një qëllim domethënës për shumicën e individëve në një popullsi të caktuar. Në mënyrë që çdo burim që mund të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të një individi, por që në fakt është në pronësi të një anëtari të rrjetit social, mund të konsiderohet kapital social, koleksioni i burimeve sociale të marra në konsideratë do të duhet të jetë jashtëzakonisht i larmishëm. Rrjedhimisht, matja e burimeve duhet të merret gjerësisht dhe të arrijë disa fusha të jetës (nga shtëpia apo puna), dhe nga ato instrumentale (marrja hua e sheqerit) në ato jomateriale (sigurimi i informacionit, afeksionit, dhe reputacionit).

Para së gjithash, nevoja individuale për ndihmë ndikohet drejtpërdrejt nga disponueshmëria e zgjidhjeve institucionale për arritjen e qëllimeve individuale, dhe çmimi relativ i këtyre zgjidhjeve në krahasim me përdorimin e kapitalit social (Flap, 1991, 2004). Për shembull, në vendet larg botës së industrializuar perëndimore dhe me popullsi të dendur, kushton shumë shtrenjtë të riparosh makinën tek një profesionist: një garazh dhe një mekanik (zgjidhja institucionale për qëllimin) mund të jenë shumë larg, dhe rrjeti social mund të mobilizohet më lehtë dhe me çmim më të ulët. Në vendet e industrializuara, zgjidhjet institucionale për arritjen e qëllimit janë përgjithësisht të mira,

ndaj kapitali social është relativisht i parëndësishëm për shumë veprime (Flap, 2004). Studimet empirike tregojnë se mbështetja që shkëmbehet në disa vende është më shpesh socio-emocionale apo ndihmë e vogël instrumentale, ndërsa në vende të tjera kapitali social mbetet i rëndësishëm për transaksionet më të mëdha, të tilla si ndërtimi i një shtëpie së bashku (SIK, 1984).

Së dyti, shkalla e përdorimit të kapitalit social varet nga diferencat kulturore dhe “etika për të ndihmuar”. Gjithashtu, qëndrimet etike ndaj të kërkuarit ndihmë njerëzve të tjerë kanë një komponent kulturor, i cili mund të jetë një shpjegim shtesë për diferencat e vërejtura në përdorimin e kapitalit social brenda vendit: në disa popullata dhe kultura, kërkitimi i ndihmës në përgjithësi është i pranueshëm, ndërsa në disa të tjera ajo mund të konsiderohet shpesh dobësi personale. Për më tepër, nocioni i Coleman (1990: 306-7) për "nivelin e besueshmërisë" në një shoqëri vlen edhe për përdorimin e kapitalit social: në situata ku njerëzit nuk mund t'i besojnë më njëri-tjetrit, reciprociteti i vonuar është i brishtë, dhe roli i kapitalit social është më i vogël.

1.4 Kapitali Social në fushën ndërkombëtare

Janë zhvilluar hulumtime të shumta ndërkombëtare, nga ana e institucioneve të mëdha, me qëllim ndërtimin e një mase të përbashkët të kapitalit, nëpërmjet përdorimit të një gasjeje sa më të harmonizuar dhe të krahasueshme që të jetë e mundur. Ndër këto nisma janë ato të Bankës Botërore, Statistics Canada, Shteteve të Bashkuara, OECD-së, Zyrës

së Statistikave Kombëtare (ONS) të Britanisë së Madhe, nga Statistikat për Zelandën e Re, Zyra Australiane e Statistikave (ABS) dhe Istat.²

Banka Botërore u ka paraprirë duke theksuar rëndësinë e kapitalit social në kuadër të reduktimit të varfërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim. Një aspekt i rëndësishëm në afrimin e matjes së kapitalit social të zbatuar nga Banka Botërore ishte identifikimi i modeleve të kapitalit social, vecanërisht dallimi mes tipeve "*bonding*" (i cili ekziston në një grup dhe mes njerëzve të ngjashëm - përjashtues) dhe "*bridging*" (që ekziston mes grupeve të ndryshme - përfshirës).

Në raportin e OECD-së për mirëqenien e kombeve (2001) theksohet se kapitali social ndihmon shpjegimin jo vetëm të ndryshimeve në organizimin e prodhimit dhe zhvillimit ekonomik, por edhe dallimeve në fusha të tjera të jetës shoqërore, të tilla si shëndetësia, strehimi, etj (Di Giacomo, 2006).

Në Workshop-in e organizuar nga Ministria e Arsimit të Hungarisë dhe OECD (me pjesëmarrjen e 13 vendeve të OECD-së, Komisionit Europian dhe Eurostatit), të mbajtur në Budapest në maj të vitit 2003, u identifikuan katër dimensionet kryesore të kapitalit social: 1) Pjesëmarrja sociale; 2) Rrjetet sociale dhe ndihmat; 3) Besimi dhe reciprociteti; 4) Pjesëmarrja civile. Zyra e Statistikave Australiane (ABS) ka zhvilluar kohët e fundit një sërë treguesish të kapitalit social për të cilët janë përdorur të dhënat nga përgjigjet individuale: rrjetet sociale dhe strukturat mbështetëse; pjesëmarrja sociale

²http://oikonomia.it/old/pages/2006/2006_giugno/studi_6.htm, parë për herë të fundit më 07.06.2016 .

dhe komunitare; angazhimi politik dhe fuqizimi i qytetarëve; besimi tek njerëzit dhe institucionet shoqërore; toleranca e diversiteti; altruizmi, filantropia dhe vullnetarizmi.

Anketa e përgjithshme sociale e Kapitalit Social (General Social Survey on Social Capital 2003), e kryer në Kanada, në një mostër prej rreth 25,000 personash, përfshiu modulet e mëposhtme: pjesëmarrjen sociale; pjesëmarrjen qytetare; angazhimin politik; periudhën e qëndrimit në zonë, lëvizshmërinë dhe sigurinë në lagje; pjesëmarrjen fetare; besimin, reciprocitetin; rëndësinë e krijimit të lidhjeve me njerëz me prejardhje të ngjashme / të ndryshme kulturore.

Anketa e World Values Survey është një sondazh i kryer nga një rrjet ndërkombëtar sociologësh që ka për qëllim matjen e ndryshimeve në vlerat dhe besimet themelore të njerëzve në më shumë se 65 vende. Ajo u bazua në anketën europiane (European Values Survey), dhe pyetjet në lidhje me kapitalin social të pranishëm në WVS, përfshinin kryesisht, besimin ndërpersonal apo besimin e deklaruar tek organet tatimore.

Në Shtetet e Bashkuara është zhvilluar një anketim telefonik në shkallë të madhe për të matur kapitalin social (The Social Benchmark Community Capital). Përveç kësaj, Iniciativa Inter-Amerikane e Kapitalit Social, Etikës dhe Zhvillimit kryer nga Banka Inter-Amerikane për Zhvillim, me mbështetjen e Qeverisë Norvegjeze, është përshtatur për të promovuar forcimin e vlerave etike dhe të kapitalit social në rajonet e përfshira. Ndër objektivat e saj rradhitën:

-bashkëpunimi në fusha të tilla si promovimi i punës vullnetare, zgjerimi i përgjegjësisë sociale të korporatës dhe miratimi i kodeve të etikës nga ana e aktorëve socialë në mënyrë që të zhvillohet kapitali social i fshehur i rajonit;

-nxitja e mobilizimit të kapitalit social në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit nga organizatat ndërkombëtare dhe agjensitë qeveritare;

-nxitja e integritetit të programeve sistematike e mësimi të etikës për zhvillimin e programeve arsimore që fokusohen në zhvillimin e kapitalit social.


Në Irlandë, anketa e vitit 2002 udhëhequr nga Forumi Kombëtar Ekonomik dhe Social (NESF) mbi dimensionet kryesore të kapitalit (si angazhimi social dhe vullnetarizmi, efektiviteti shoqëror; pjesëmarrja qytetare në rrjete informale të mbështetjes sociale/tëqenët i shoqërueshëm, rregullat e besimit dhe reciprociteti) tregoi se në Europë ekziston një dallim i madh mes Veriut dhe Jugut të kontinentit, me nivele shumë më të larta të besimit në Skandinavi.

Në Itali, ISTAT identifikon tre nivelet e kapitalit social: mikro (perspektiva individuale: mundësitë e një individi për të mobilizuar burimet përmes një rrjeti social); meso (perspektiva strukturore: procesi i zhvillimit dhe shpërndarjes së kapitalit social në rrjet); makro (mënyra e rrjetit për të vendosur rrënjët në sistemin politik, ekonomik dhe social) (Di Giacomo, 2006).

1.5 Elementet e kapitalit Social sipas skemës së Putnam

Sipas kuadrit të përpunuar nga Putnam (figura 1), egzistojnë tre përbërës kryesorë të kapitalit social, të cilët janë besimi, normat e reciprocitetit dhe rrjetet e angazhimit qytetar.

Figura 1: Elementet e Kapitalit Social sipas Putnam



1.5.1 Besimi

Koncepti i parë është besimi, përcaktimi i të cilit varet sigurisht nga perspektiva e studiuesit. Disa autorë e konsiderojnë po aq të rëndësishëm sa kapitali social, Fukujama është një shembull (1995); disa të tjerë si Giddens (1990), Coleman (1994) dhe Ikeda, Yamada e Kohno (2003) e konsiderojnë një formë të vecantë të kapitalit social. Pastaj ka edhe pikëpamje të tjera që e konsiderojnë një përbërës të kapitalit social (Callahan, 2005; Newton, 2003; Putnam 1993, 2000). Në këtë mënyrë, mbetet një koncept në zhvillim e sipër, duke mos patur një përkufizim universal. Sidoqoftë, të gjithë autorët bien dakord me idenë se besimi nuk është dicka e lindur, e dhënë nga natyra, por ka një origjinë, një rrugëtim dhe një zhvillim të caktuar përgjatë marrëdhënieve sociale.

Ka shumë mënyra për ta kategorizuar besimin gjithashtu, por me rëndësi të vecantë për këtë punim janë dy tipet kryesore të besimit: besimi social dhe besimi politik, të cilët nuk duhen parë kurrësi si e njëjta gjë. Besimi tek njerëzit e zakonshëm dhe besimi tek politikanët nuk janë njëjloj. Individet mund të kenë nivel të lartë besimi të fqinjët, por ndoshta nuk mund të thonë të njëjtën gjë për përfaqësuesit në parlament.

Besimi social

Koncepti i besimit social ka fituar shume popullaritet tek shkencat sociale vitet e fundit (Newton, 2001; Delhey&Newtn, 2003; Fukuyama, 1995; Rahn&Transue, 1998; Subramanian et al., 2006). Gambetta (1988, fq.217) e përkufizon si “besimi i një aktori që një person apo një kolektiv do të kryejë veprime ose japë informacione që do të jenë të dobishme dhe jo të dëmshme për të, duke lejuar kështu ndërtimin e një marrëdhënieje bashkëpunimi”. Për Newton (2001: 204) besimi social shpjegohet si besim tek anëtarët e shoqërisë dhe organizimet si lagjet, komunitetet dhe kombet. Mund të vazhdojmë me përkufizime të larmishme, por në përgjithësi, boshti rreth të cilit sillen është besimi se të tjerët nuk do të na lëndojnë apo dëmtojnë.

Një nga burimet kryesore të lindjes së besimit social konsiderohet pjesëmarrja nëpër organizata vullnetare (Fennema dhe Tillie, 2001: 32; Fukujama, 1995: 204-207; Shah, 1998: 485-491; Stolle, 1998: 498). Këta autorë besojnë se përfshirja nëpër organizata vullnetare i aftëson anëtarët të zhvillojnë besimin dhe sjelljet bashkëpunuese me të tjerët. Fukujama (1995:206) përmend shoqërinë japoneze si një rast i pashembullt i një sistemi social që shfaq një shkallë shumë të lartë besimi, që lind në mënyrë spontane e mbi baza vullnetare mes grupeve të ndryshme të njerëzve që s’janë të lidhur me njëri-tjetrin. Ai beson se është pjesëmarrja aktive në shoqata vullnetare faktori që e bën shoqërinë japoneze ndër më të besuarat në botë. Stolle (1998: 521) shton se sa më shumë eksperiencë vullnetare të kenë njerëzit aq më shumë ata do të besojnë tek të tjerët, pavarësisht se studimi i tij nuk shpjegon tamam se sa kohë i duhet një personi për të zhvilluar besimin social, apo sesa përfshirja vullnetare e promovon besimin. Përfitimet e besimit social, janë tashmë të ditura, promovon bashkëpunimin dhe mbështetjen morale mes komuniteteve (Delhey dhe Newton, 2003; Uslaner, 2000),

krjon komunitete të reja (Ikeda et al.,2003), promovon zhvillimin ekonomik (Fukuyama, 1995; Rahn dhe Transue, 1998), inkurajon pjesëmarrjen e njerëzve në çështjet publike (Kwak, Shah dhe Holbert, 2004; Putnam, 1993; Uslaner, 1999) etj.

Besimi politik

Besimi politik përshkruhet si besimi që institucionet publike dhe punonjësit e tyre do të kryejnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre më efektivitet, dhe që rezultatet e politikave dhe të punës së administratës do t'u shërbejnë shumicës në shoqëri, ose pjesës më të madhe të saj (Anderson dhe Lotempio, 2002: 336; Damico et al., 2000: 378-380; Li, 2004: 230; Mishler dhe Rose, 2001: 31). Këtu duhet bërë dallimi mes besimit tek institucionet publike, si për shembull Parlamenti, dhe besimi tek personat politikë, si Presidenti, autoritetet politike etj. Duke qenë se besimi politik dallon nga besimi social, atëherë edhe origjinat e tyre do të jenë të ndryshme.

Nga njëra anë, teoria institucionale (Shi, 2001: 41) tregon se besimi politik vjen si rezultat i punës së kënaqshme të institucioneve (Mishler dhe Rose, 2001; Newton, 2001; Williams, 1985). Nëse performanca e qeverisë kënaq pritshmëritë e qytetarëve, atëherë ata do të kenë besim, dhe aspekte si projektimi i mirë i institucioneve, performanca efektive, korrektësia e vendimeve politike, të gjitha kontribuojnë në rritjen e besimit të përfaqësuesit e politikës. Siç theksojnë Mishler dhe Rose (2001) “institucionet që punojnë mirë prodhojnë besim, ato që performojnë keq prodhojnë skepticizëm dhe mosbesim”. Nga kjo perspektivë arrihet në konkluzion që qeveritë kanë në dorë mundësinë për të krijuar ose jo besimin.

Nga ana tjetër, teoria kulturore pretendon se besimi politik nuk vjen nga sfera politike, por krijohet gjatë procesit të socializimit (Damico et al.,2000; Mishler&Rose, 2001; Shi,

2001), pavarësisht se nuk kundërshton parimin sipas të cilit efektshmëria e institucioneve politike i jep formë besimit të njerëzve te qeveria. Kulturalistët argumentojnë se ky besim nuk mund të krijohet në një kohë të shkurtër, mund të duhen edhe dekada për ta krijuar, dhe se vetë procesi i krijimit të besimit është në thelb i politizuar. Gjithësesi, ata bien dakord se burimi kryesor i kësaj forme të besimit është kultura politike, që përfshin vlerat politike, normat, sjelljet dhe besimet (Putnam, 1993: 177-181; Shi, 2001: 415-416).

Autorë të ndryshëm kanë diskutuar përfitimet që sjell për demokracinë besimi politik. Si fillim, ai tregon sesa shumë besim dhe mbështetje gëzojnë përfaqesit e popullit në qeveri (Damico et al., 2000: 378-379; Hadenius, 2004: 56), lidh njerëzit e thjeshtë me autoritetet dhe funksionarët politikë (Hetherington, 1998: 803; Mishler dhe Rose, 2001: 30), që mund të përkthehet në bashkëpunim mes njerëzve dhe qeverisë, gjithashtu inkurajon pjesëmarrjen politike, aktivizmin për mbrojtjen e të drejtave civile (Damico et al., 2000: 381) dhe thekson legjitimitetin dhe efektshmërinë e performancës së qeverisë. Pa këtë besim, qeveritë do të punonin nën një presion të madh dhe vetë demokracia e stabiliteti do të vihej në dyshim.

Pavarësisht se të gjitha qeveritë meritojnë besim, në një formë apo tjetrën, njerëzit nuk mund të kenë besim gjatë gjithë kohës. Madje disa autorë (Hardin, 1999; cituar në Newton, 2001: 205; Shi, 2001: 405) argumentojnë se edhe mungesa e besimit ka funksionin e vet, si për shembull e shtyn qeverinë të punojë duke pasur më shumë transparencë, barazi dhe inkurajon njerëzit që të vënë në diskutim dhe të vlerësojnë seriozisht punën e qeverisë.

Së fundi, besimi politik nuk sjell vetëm përfitime në sferën politike, por edhe në atë sociale. Besimi politik ndihmon në krijimin e shoqërive të besueshme dhe ka aftësinë të krijojë besim të përgjithshëm (Rothstein dhe Stolle, 2003: 199-208; Stolle, 2004: 201-202; Uslaner, 2003: 171-172). Individët që ngelin të kënaqur me shërbimet e marra nga nëpunësit publikë, mund ta manifestojnë besimin e tyre edhe tek të tjerët, dhe kanë më shumë gjasa të ndërveprojnë me njerëz që nuk i njohin (Brehm dhe Rahn, 1994: 1008).

1.5.2 *Normat e reciprocitetit*

Baza e kapitalit social është se tërheq individët të shkëmbejnë burimet me njëri tjetrin. Konceptet themelore për të kuptuar se si funksionojnë shkëmbime të tilla janë besimi dhe reciprociteti. Normat e reciprocitetit (balancues, marrës dhe dhënës) ekzistojnë në të gjithë botën dhe janë një nga parakushtet kryesore për kapital social. Ato mund të ndahen në dy forma: marrëdhënie pozitive dhe negative midis dhënësve dhe marrësve (Diekmann, 2004: 489; Gouldner, 1960: 172, Marques, 2004: 14). Duhet nënvizuar fakti që normat e reciprocitetit kanë një rol të rëndësishëm për formimin e respektit reciprok dhe bashkëpunimit mes dhënësve dhe marrësve. Gouldner (1960) i shpjegon normat e reciprocitetit duke treguar sesi “njerëzit duhet të ndihmojnë ata që i kanë ndihmuar dhe nuk duhet t’u shkaktojnë dëm”. Marques (2004) e konsideron reciprocitetin si “kujtesa morale e njerëzimit që shpreh atë që shoqëritë, komunitetet dhe madje grupet e vogla përcaktojnë si mënyrat e duhura për të reaguar ndaj veprimeve të dikujt, qoftë në terma simpatie apo ofendimi”. Kjo marrëdhënie bashkon njerëzit nëpërmjet një shkëmbimi privilegjesh të përbashkëta. Interesante është edhe mënyra sesi reciprociteti konsiderohet një aset i vlefshëm për zhvillimin e korrelacionit mes

njerëzve dhe qeverisë duke rritur përgjithësisht nivelin e solidaritetit (Marques, 2004: 29).

Idetë e përgjithshme të reciprocitetit u përpunuan fillimisht në fushën e antropologjisë nga Malinowski (1922), i cili pohon se nuk ka dallime në shkallën në të cilën njerëzit presin kthim mbrapsht. Sahlins (1974) i vazhdoi më tepër këto ide, duke propozuar që me rritjen e distancës së farefisnisë, pritet më tepër reciprocitet dhe solidaritet nga një marrëdhënie. Ai ndërtoi një vazhdimësi të reciprocitetit, bazuar në periudhën kohore dhe barazinë e mallrave të shkëmbyera. Kur koha që kalon mes një burimi të dhënë (një dhuratë) dhe një burimi të kthyer është e shkurtër, dhe përmbajtja gati e barabartë, ekziston një shkëmbim i balancuar. Nëse kjo kohë është më e gjatë, e papërcaktuar, dhe përmbajtjet e dhuratave të shkëmbyera janë të një natyre heterogjene, ekziston një reciprocitet i përgjithësuar. Gjithashtu ka raste të veprimeve jo reciproke. Në qoftë se dhurata nuk kthehet mbrapsht, kjo quhet një dhuratë e pastër. Nëse është dhuratë e pavullnetshme, quhet vjedhje, ose reciprocitet negativ.

Sipas mjeteve, shkëmbimi direkt dhe i balancuar i mallrave është i mundur deri në një pikë të caktuar. Për shkak se vlerësimi i përbashkët i mallrave dhe shërbimeve është i komplikuar, dhe shpesh nuk ka ko incidencë dëshirash (Edgeworth, 1881; cituar në Coleman, 1990: 119), shkëmbimi mund të paraqesë disa vështirësi. Për të zgjidhur këtë problem, zhvillohen dy procedura për ndarjen e një transaksioni në dy gjysma. Së pari, me zhvillimin e parasë, një mall shkëmbimi jo i drejtpërdrejtë, u bë i mundur krijimi i një mjeti të përgjithshëm shkëmbimi (Coleman, 1990: 119). Paraja në vetvete është e pavlefshme, por ajo jep sigurinë që mungesa e besimit është kapërcyer, dhe transaksioni është përfunduar. Një tjetër zgjidhje është shkëmbimi i përgjithësuar midis dy palëve. Kur burimet janë marrë nga pala A, duke ndjekur normat e reciprocitetit, pala B fiton të

drejtën për të pretenduar në të ardhmen disa nga burimet e A-së. Kjo është baza për transaksionet e kapitalit social, duke lejuar marrëdhënie specifike dhe borxhe të tilla, njerëzit e detyrojnë njëri-tjetrin të përmbushin detyrimet në të ardhmen. Në përgjithësi njerëzit nuk kanë dëshirë të kenë borxhe, dhe rëndësia e reciprocitetit në marrëdhëniet shoqërore kufizon numrin e kërkesave që bëhen nga anëtarët e rrjetit.

Nevoja për reciprocitet ndryshon kur objekt i shkëmbimit janë burime të tjera, për shembull dhënia e informacionit mund të jetë praktikisht 'falas', ose pa pritur në këmbim kthim informacioni mbrapsht, dhe në përgjithësi nuk kërkohet apo pritet ndonjë shpërblim për çdo filxhan sheqer të huazuar. Gjithashtu, nevoja për reciprocitet ndryshon me kalimin e marrëdhënieve, lidhjet më të dobëta janë më pak të bazuara në besim sesa lidhjet më të forta, ato kërkojnë reciprocitet të shpejtë (Van Busschbach, 1996; Wellman, Carrington dhe Hall, 1988). Shkëmbimet variojnë edhe në varësi të lidhjeve të rrjetit, shkëmbimet me lidhje më të dobëta shpeshherë motivohen nga empatia, ndërsa shkëmbimet me njerëzit e afërt mund të kenë shpesh karakterin e detyrës (Degenne et al, 2004). Në marrëdhëniet afatgjata mund të jetë e vështirë të kesh akses, ndërkohë që të gjitha shkëmbimet janë të balancuara, ndaj rëndësia e reciprocitetit ulet.

1.5.3 Rrjetet e angazhimit qytetar

Janë marrëdhëniet ndërpersonale që mund të krijohen duke u shoqëruar me të tjerët, si në formën e jetës personale civile ashtu edhe midis një grupi njerëzish (Pelling dhe Hogh, 2005: 310; Putnam, 2000: 31-180). Rrjetet e angazhimit qytetar konsiderohen si “zemra e demokracisë” (Verba, Schoolman dhe Brady, 1995: 1), dhe kjo kryesisht

sepse duke u angazhuar nëpër rrjete qytetare, individët fitojnë sjellje të vlefshme politike. Mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme, ka disa autorë që i ndajnë në bazë të karakteristikave horizontale ose vertikale të organizatave (Annen, 2003: 461). Në rrjetet me lidhje vertikale, marrëdhëniet mes grupeve ose institucioneve janë të një natyre hierarkike, të pabarabartë dhe varësie (Putnam, 1993: 174). Kurse në rrjetet me lidhje horizontale, çdo anëtar trajtohet si i barabartë, në terma statusi dhe fuqie.

Për më tepër, mund të kategorizohen si formale ose joformale (Foley dhe Edwards, 1999; Giddens, 1990). Marrëdhëniet mes njerëzve në rrjetet formale organizohen me anë të ligjeve ose rregulloreve, të cilat përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e gjithësecilit. Kurse rrjetet informale karakterizohen nga fleksibiliteti dhe lidhjet e dobëta. Nuk kanë strukturë të qëndrueshme dhe janë pak të organizuara. Zakonisht lidhin njerëz me lidhje sociale që burojnë nga familja, të afërmit, miqtë, fqinjët, kolegët e punës dhe komuniteti (Giddens, 1990; Putnam, 2000). Anëtarët e një rrjeti të tillë, me shumë mundësi ndajnë të njëjtin status social, me një shkallë të lartë intimiteti, intensiteti emocional dhe jetëgjatësie. Sa më horizontal të jetë rrjeti, aq më shumë rritet dendësia e tij dhe aq më i fortë impakti në integrimin social.

Ndër përfitimet më të mëdha të këtyre rrjeteve mund të rendisim forcimin e besimit politik (Putnam, 2000: 336-346), zhvillimin e aftësive sociale, aftësive të bashkëpunimit, shpirtit publik dhe sjelljes pozitive ndaj të tjerëve, forcimin e tolerancës dhe respektit kundrejt të gjitha sjelljeve dhe zërave (Ikeda dhe Kobayashi, 2007: 4-26), si edhe rritjen e kontributit politik (Bowen et al., 2001: 84-90).

1.5.4 Kuadri i OECD-së

Në mënyrë të ngjashme me skemën e Putnam-it, kuadri i prezantuar nga OECD (OECD, Scrivens dhe Smith, 2013) ka për qëllim të mbulojë të gjitha dimensionet e kapitalit social. Ai bazohet në katër aspekte të ndryshme të kapitalit social, përshkruar si më poshtë:

Marrëdhëniet personale: Ky aspekt i kapitalit social i referohet "strukturës dhe natyrës së marrëdhënieve personale mes njerëzve" (OECD, 2013), dhe ka të bëjë me njohjet e njerëzve dhe çfarë bëjnë ata për të krijuar dhe për të ruajtur marrëdhëniet e tyre personale.

Rrjeti i Mbështetjes Sociale: Kjo i referohet "nivelit të burimeve apo mbështetjes që një person mund të përfitojë nga marrëdhëniet e tij personale" (OECD, 2013), por gjithashtu përfshin edhe çfarë njerëzit bëjnë për individë të tjerë në baza personale.

Angazhimi Qytetar: Kjo i referohet "veprimeve dhe sjelljeve që mund të shihen si kontribute pozitive në jetën kolektive të komunitetit apo shoqërisë" (OECD, 2013). Ai përfshin veprimtari të tilla si punë vullnetare, pjesëmarrja politike dhe forma të tjera të veprimeve në komunitet.

Besimi dhe normat bashkëpunuese : Kjo lidhet me besimin dhe normat bashkëpunuese ose vlerat e përbashkëta që formojnë mënyrën se si njerëzit sillen ndaj njëri-tjetrit dhe si anëtarë të shoqërisë. Besimi dhe vlerat që janë të dobishme për shoqërinë si një e tërë (si për shembull solidariteti dhe barazia) mund të përcaktojnë se sa shumë njerëz në një shoqëri janë të gatshëm të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

II. Kapitali Social dhe Performanca Qeverisëse

Kapitali social është një koncept kompleks, shumëdimensional. Rëndësia e tij për shkencat shoqërore është themelore. Kapitali social është një burim njerëzor që mund të ndikojë mundësinë, cilësinë dhe suksesin e ndërveprimeve ekonomike, politike dhe sociale. Lidhja mes kapitalit social dhe qeverisjes së mirë është diskutuar gjerësisht në literaturë. Në thelb të debatit qëndron para së gjithash, ideja se ekziston një hendek teorik mes kapacitetit bashkëpunues të një komuniteti dhe prodhimit të të mirave kolektive nga institucionet politike.

Zhvillimi i konceptit të kapitalit social është mjaft tërheqës për akademikët për shkak të lidhjes pozitive që egziston mes tij dhe rezultateve kolektive shoqërore (Billiet & Cambre', 1999). Kapitali social është me të vërtetë një burim i rëndësishëm në dispozicion të shoqërive, së bashku me kapitalin njerëzor dhe fizik, dhe ka ndikime të dobishme për fenomene të ndryshme ekonomike, sociale dhe politike. Arsytet për këtë në përgjithësi, nuk janë kuptuar mirë, por janë marrë në shqyrtim disa elemente në lidhje me efektin e tij për sa i përket performancës institucionale apo qeveritare.

2.1 Kapitali social dhe besimi

Besimi është i lidhur ngushtë me kapitalin shoqëror. Coleman (1988) argumenton se sistemi i besimit reciprok është një formë e rëndësishme e kapitalit social në të cilën mund të bazohen detyrimet e ardhshme dhe pritshmëritë. Putnam (1993) e konsideron besimin si një burim të kapitalit social që mbështet dinamizmin ekonomik dhe performancën e qeverisë. Nahapiet dhe Ghoshal (1998) e trajtojnë besimin si një aspekt kyç në dimensionin relacional të kapitalit social. Këto perceptime të ndryshme por të

ndërlidhura mes besimit dhe kapitalit social janë pjesërisht rezultat i marrëdhënieve të ngushta midis burimeve të besimit dhe burimeve të kapitalit social (Adler dhe Kwon, 2000).

2.1.1 Marrëdhënia mes kapitalit dhe besimit

Besimi përfshin marrjen përsipër të rrezikut. Të dyja palët komunikuese e dinë se veprimet e njëres mund të ndikojnë tek tjetra, të dyja ndajnë idetë, shqetësimet dhe çështje me ndershmëri. Literatura sociologjike e përcakton besimin ose si pronë të individëve, marrëdhëniet sociale, ose si sistem shoqëror me vëmendje të shpërdarë në bazë të veprimeve në nivel individual (Misztal, 1996). Në rastin kur konsiderohet si një karakteristikë apo pasuri e personave, besimi është një variabël personaliteti, që vendos theksin tek karakteristikat individuale si ndjenjat, emocionet, dhe vlerat (Wolfe, 1976). Një perspektivë e dytë e konsideron besimin si një atribut të përbashkët që mund të nxirret për të arritur qëllimet organizative. Prandaj ai mund të aplikohet tek fabrika institucionale e shoqërisë (Misztal, 1996). E treta e trajton besimin si një të mirë publike me vlerë, të mundësuar dhe mbështetur nga sistemi shoqëror. Unë gjykoj se besimi është një atribut i sistemit shoqëror në pronësi të anëtarëve që e përbëjnë atë. Putnam (1993), për shembull, argumenton se besimi brenda komunitetit është ajo që e ka bërë demokracinë të funksionojë në veri të Italisë. Këto tre nivele të ndryshme të besimit janë të ndërlidhur. Në nivel individual, dikush ka besim tek një individ për të bërë diçka bazuar në disponueshmërinë, aftësinë e tij, reputacionin e kështu me radhë. Në nivel kolektiv, në qoftë se një individ nuk i beson një agjensie apo një organizate me të cilën është lidhur, atëherë nuk do të ketë besim në përmbushjen e marrëveshjes nga ana e kësaj organizate (Dasgupta, 1988). Gjithashtu mund të themi se individët marrin në

konsideratë background-in, kulturën dhe sistemin social të një individi tjetër kur kërkojnë të përcaktojnë nëse mund t'i besojnë. Kjo ndërlidhshmëri sugjeron se ndërtimi i besimit në nivel mikro kontribuon në përcaktimin e një forme akoma më abstrakte të besimit në nivelin makro (Luhmann, 1988).

Një sërë studiuesish ofrojnë argumente të ndryshme për sa i përket marrëdhënieve mes besimit dhe kapitalit social. Në shkollë e konsideron besimin si një parakusht të kapitalit social ndërsa një tjetër e konsideron besimin si një produkt apo një përfitim të kapitalit social. Për shumë studiues, kapitali social varet nga besimi. Marrëdhëniet, komunitetet, bashkëpunimi dhe angazhimi i ndërsjellë që karakterizojnë kapitalin social nuk mund të ekzistojnë pa një nivel të arsyeshëm të besimit. Pa një themel të besimit, kapitali social nuk mund të zhvillohet. Ndonëse Bourdieu (1986) nuk e përmend në mënyrë specifike besimin, nënkuptohet qartë në argumentin e tij në lidhje me riprodhimin shoqëror "riprodhimi i kapitalit social nënkupton një përpjekje të vazhdueshme për të qenit i shoqërueshëm, një seri të vazhdueshme të shkëmbimeve në të cilat njohja afirmohet dhe riafirmohet pafund" (Bourdieu, 1986: 250). Njerëzit duhet të bazojnë angazhimet e tyre në besim për të zgjeruar lidhjet e tyre të dobishme. Coleman (1988) dhe Putnam (1993) e përcaktojnë besimin si një komponent kyç të kapitalit social. Besimi gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në konceptin që ka Fukuyama për kapitalin social. Ai e përkufizon besimin si një tipar themelor të kapitalit social, "kapitali social është një aftësi që lind nga mbizotërimi i besimit në një shoqëri ose në pjesë të caktuara të saj" (Fukuyama, 1995: 26). Po ashtu, Francois (2003) argumenton se besueshmëria është një komponent ekonomik i rëndësishëm i kulturës së një shoqërie që përfshin kapitalin e saj social. Këta studiues e konsiderojnë besimin një parakusht të kapitalit të shëndoshë social.

Në mënyrë të ngjashme, Coleman barazon besimin reciprok me kapitalin shoqëror dhe e përcakton atë në terma funksionale si uljen e kostos së transaksionit në ndërveprime të rrezikshme sociale. Por duket se si kapitali social i Putnam, ashtu edhe përshkrimet e zgjedhjes racionale të kapitalit social të Coleman, nuk specifikojnë sa duhet mekanizmat shkakore midis origjinës së tij dhe përfitimeve të tij të supozuara për performancën politike dhe ekonomike (Farrell dhe Knight, 2003: 338).

Ndryshe nga Coleman, Putnam dhe Fukuyama, Woolcock (1998) ka argumentuar se përkufizimet e kapitalit social duhet të përqendrohen kryesisht tek burimet më tepër sesa tek pasojat. "Besimi dhe normat e reciprocitetit, drejtësia dhe bashkëpunimi janë 'përfitimet' që ushqehen me kombinime të veçanta të marrëdhënieve sociale; ata kanë rëndësi të pamohueshme për lehtësimin dhe forcimin efikas të performancës institucionale, por ato nuk ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga marrëdhëniet shoqërore. Pasojat mund të jenë një nga treguesit e llojeve të kapitalit shoqëror që janë të pranishme, por ato nuk mund të ngatërrohen me vetë kapitalin social" (Woolcock, 1998: 185).

Woolcock (2001: 13) propozon se besimi më mirë mund të shihet si "pasojë e kapitalit social jo si komponent integral i kapitalit social". Axelrod (1984) e përforcon këtë mendim duke u mbështetur në teorinë e lojës për të sugjeruar se edhe atje ku besimi është shumë i kufizuar dhe mundësitë për komunikim janë shumë të pakta, bashkëpunimi mund ende të zhvillohet në qoftë se arrihen kushtet e tjera. Axelrod argumenton se besimi duhet të ekzistojë në shoqëritë dhe grupet që janë të suksesshme për shkak të aftësisë së tyre për të bashkëpunuar, dhe duhet të përbëhet nga asgjë më shumë se sa besimi në suksesin e bashkëpunimeve të mëparshme (1984: 225). Në mënyrë të ngjashme, Field (2003: 64) argumenton se besimi nuk mund të trajtohet si një

variabël komponent sepse shumë marrëdhënie mund të funksionojnë shumë mirë me një minimum besimi, duke përfshirë shumë nga ato që mbeten tek sanksionet institucionale. Sipas tij, besimi duhet të trajtohet më mirë si një faktor i pavarur, i cili është zakonisht një pasojë, më shumë sesa një pjesë integrale e kapitalit social (2003: 65).

Problemi është se shumë forma të besimit në përgjithësi dhe besimit tek institucionet publike, janë të vendosura nën një etiketë që lexon "besimi tek qeveria". Ajo që dua të them është se literatura nuk ka bërë dallime mes besimit tek institucionet në anën përfaqësuese të sistemit politik (partitë, parlamentet, kabinetet, etj) dhe besimit tek institucionet në anën zbatuese të sistemit politik. Besimi te institucionet përfaqësuese shpesh mund të ngatërrohet me bindjet ideologjike të qytetarëve dhe shpreh orientimin e tyre parimor më shumë se sa kënaqshmërinë me performancën e këtyre institucioneve. Ndërkohë që besimi te institucionet zbatuese është një tregues më objektiv sa i përket kënaqshmërisë nga performanca e tyre. Arsyeja teorike pse besimi që njerëzit vendosin tek këto dy lloje institucionesh politike ndryshon, shpjegohet në vijim. Nga ana përfaqësuese, një nga rolet kryesore të institucioneve politike është që të jenë partiake. Një parti politike që mban pushtetin e qeverisë, ose shumicën në një parlament, supozohet që të përpiqet të zbatojë ideologjinë e saj në një mënyrë partiake. Kështu, njerëzit që mbështesin ideologjinë e partisë në pushtet (ose palët) ka të ngjarë të kenë besim në to, ndërsa qytetarët që kundërshtojnë ideologjinë e tyre me shumë mundësi shfaqin mungesë besimi.

Megjithatë, ka pak të ngjarë që ky lloj i besimit ose mosbesimit partiak mund të ndikojë besimin e përgjithshëm të dikujt tek njerëzit e tjerë. Nuk njohim ndonjë mekanizëm të besueshëm shkakor që lidh këto dy fenomene. Kjo është arsyeja pse zakonisht gjendet një korrelacion i fortë midis prirjeve politike dhe besimit politik, por një lidhje e dobët

mes besimit tek këto lloje institucionesh politike dhe besimit social (Citrin, 1974; Newton 1999a; Newton dhe Norris, 2000). Përgjithësisht, gjetjet e dobëta të marrëdhënieve shkakësore ndërmjet besimit të përgjithshëm, dhe "besimit tek qeveria" janë kryesisht për shkak të këtij dështimi për të bërë dallimin midis asaj që shërben si shkak i besimit në lloje të ndryshme të institucioneve politike.

Kjo arsye pra paqartësia midis besimit të institucionet përfaqësuese dhe atyre zbatuese bën që në Shqipëri të ketë një amulli në miratimin që qytetarët i japin sjelljeve të qeverisë. Burimi kryesor i variacioneve të besimit të përgjithshëm gjendet në anën tjetër të makinerisë shtetërore, përkatësisht tek degët ligjore dhe administrative të shtetit, përgjegjëse për zbatimin e politikave publike. Këto degë të qeverisë duhet të dallohen nga ndikimi i institucioneve përfaqësuese, si legjislativi dhe ekzekutivi për tre arsye kryesore. E para është se, ndërkohë që baza e besimit (ose mosbesimit) tek institucionet e dominuara nga politikanët është partiake, arsyeja për të besuar tek nëpunësit civilë, gjykatësit, policia, apo institucionet e shërbimit social është për shkak të bujarisë dhe paanshmërisë së tyre (Rothstein dhe Teorell, 2005). Së dyti, në krahasim me institucionet e tjera politike, gjykatat, policia dhe institucionet e tjera ligjore të shtetit kanë një detyrë të veçantë, pikërisht të zbulojnë dhe të ndëshkojnë njerëzit që, në termat e teorisë së lojës, përdorin strategji oportuniste. Me fjalë të tjera, këto institucione politike, të cilat ne i etiketojmë institucionet e rendit, janë pjesë e biznesit të përkujdesjes ndaj njerëzve, ndaj të cilëve është më mirë të mos kesh besim. Së treti, paanshmëria, efikasiteti dhe drejtësia e institucioneve politike të nivelit të rrugës janë dimensione të rëndësishme të besimit institucional dhe besueshmërisë që mund të ndahet konceptualisht nga besimi konvencional tek politikanët, partitë, dhe "qeveria".

2.1.2 Ndryshime në nivelet e besimit në individë dhe vende të ndryshme

Ka dallime të mëdha në masën me të cilën njerëzit shprehin besimin ose besueshmërinë. Një masë standarte e besimit që përdoret në krahasimet mes vendeve është përgjigja që njerëzit u japin pyetjes së shtruar nga World Values Survey: "Në përgjithësi, do të thonit se shumicës së njerëzve mund t'u besoni, apo se kujdesi nuk është i tepërt në marrëdhëniet me njerëzit? " Më pak se 10 për qind e brazilianëve, peruanëve dhe filipinasve në anketat e sondazhit botëror janë përgjigjur se mund t'u besohet shumicës së njerëzve. Gjithashtu, më shumë se 50 për qind e të anketuarve nordike (norvegjezët, finlandezët, suedezët dhe danezët) pajtohen me mendimin që shumicës së njerëzve mund t'u besohet (Knack dhe Keefer 1997; Zak dhe Knack 2001). Nuk ka asnjë masë të ngjashme standarte të besueshmërisë për një numër të madh vendesh, por ka dëshmi të konsiderueshme se shoqëritë dallojnë gjithashtu edhe në këtë dimension.

Në një eksperiment të kryer nga Reader's Digest, në 20 qytete, të përzgjedhur nga 14 vende të ndryshme të Europës perëndimore, u lanë në rrugë njëzet kuleta që supozohej se kishin rënë "aksidentalisht", të cilat përmbanin 50 dollarë, adresat dhe numrat e telefonit të pronarëve të tyre. Në mënyrë të ngjashme dhjetë kuletat u "humbën" në 12 qytete të SHBA-së. Numri i kuletave të kthyer me përmbajtje të paprekur u regjistrua për çdo qytet. Proporcionet e numrit të kuletave të kthyer u llogaritën më pas dhe u ekspozuan me një variacion të gjerë, nga 30 për qind e kuletave të kthyer në Itali, 45 për qind në Portugali, 60 deri 75 për qind në qytete të ndryshme të SHBA-së, deri në 100 për qind në Norvegji dhe Danimarkë. Nisur nga sondazhi i World Values, Knack dhe Keefer (1997) zhvilluan një masë për matjen e besueshmërisë që ata e quajtën "bashkëpunimi qytetar". Ajo bazohet në besimet e të anketuarve nëse veprimet e mëposhtme mund të justifikohen ndonjëherë ose jo: kërkimi i përfitimeve nga qeveria

për të cilat të anketuarit nuk kishin të drejtë, shmangia e tarifës së transportit publik, mashtrimi me taksat kur u jepej mundësia, mbajtja e parave të gjetura, ose mosraportimi i dëmit që u kishin shkaktuar aksidentalisht një automjeti të parkuar. Fukuyama (1995) pretendon se është e rëndësishme për shoqëritë të emërtohen si shoqëri me besim të lartë apo të besimit të ulët, besimi dhe besueshmëria janë në fakt produkt i sjelljes dhe vendimeve individuale.

Glaeser et al. (2000) kryen një eksperiment në të cilin formonin çifte individësh; çdo palë takohej dhe më pas ndahej. Njërit anëtar, dërguesit, i jepeshin 15 dollarë, dhe mundësia për t'i dërguar deri në 15 dollarë anëtarit tjetër, marrësit. Për çdo dollar të dërguar, "eksperimentuesi" jepte një dollar shtesë për marrësin. Marrësi pastaj mund të kthente paratë për dërguesin. Të gjitha rregullat e lojës ishin të njohura për të gjithë lojtarët. Shuma e parave të dërguara është një tregues i sjelljes së besimit; shuma e parave të kthyera në këtë rast është një tregues i besueshmërisë. Shuma mesatare e dërguar gjatë eksperimentit ishte 12.41 dollarë, por devijimi standard ishte mjaft i lartë (4.54 dollarë), që tregon se pjesëmarrësit dërgonin sasi shumë të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, dërguesit mesatarisht kthyen 45.5 për qind të shumës që morën, por devijimi standard ishte 26.7. Rezultate e studimit kapën nivelet totale të besimit në shoqëri dhe treguan se ka dëshmi të konsiderueshme e të drejtpërdrejtë të korrelacionit mes besimit dhe besueshmërisë.

Fukuyama (2000) thekson se normat e besimit dhe besueshmërisë mund të kenë një "rreze" të ngushtë ose të gjerë. Normat që kapërcejnë problemet e veprimit kolektiv dhe që ndërtojnë besimin brenda, por jo midis familjeve, klasave sociale apo grupeve etnike shpesh imponojnë eksternalitete negative për ata që nuk janë anëtarë të këtyre grupeve. Besimi i fortë brënda-etnik në një shoqëri që është heterogjene për sa i përket etnive,

mund të kufizojë mundësitë për transaksione dhe të segmentojë tregjet, duke ulur fitimet që vijnë nga specializimi dhe ekonomitë e shkallës (Greif, 1994). Të njëjtat lidhje të forta që i ndihmojnë anëtarët e një grupi mund të përdoren për të përjashtuar (shpesh në nevojë) anëtarë të tjerë të komunitetit nga të mirat e veprimit kolektiv (Pantoja, 2002). Nga ana tjetër, në qoftë se një pjesë e madhe e shoqërisë, për shkak të normave sociale, mund të mbështeten tek njëri-tjetri për të përmbushur kontratat dhe detyrimet e tyre, mund të thuhet se besueshmëria ka një rreze të gjerë. Në shoqëritë e karakterizuara nga një rreze e gjerë besueshmërie, individët nuk janë partnerë të besueshëm vetëm për sa i përket këmbimeve, qoftë politike apo ekonomike, por mund të veprojnë në interes të të tjerëve deri diku edhe në kurriz të vetvetes, për shembull, duke u kthyer kuletat e humbura pronarëve përkatës (me para në dorë).

Besimi dhe manifestime të tjera të kapitalit social mund të kenë rëndësi thelbësore për mbijetesën e qeverisë demokratike. Paxton (1999) dhe Inglehart (1999) argumentojnë se kultura e besimit është e nevojshme që qeveritë të jenë të gatshme për t'i dorëzuar pushtetin opozitës, dhe për këtë arsye për mbijetesën e demokracisë. Inglehart (1999) gjen një lidhje të fortë mes besimit dhe stabilitetit të institucioneve demokratike, duke përdorur të dhëna nga vende të ndryshme. Në një studim klasik krahasues mes SH.B.A-së, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Italisë, dhe Meksikës, Almond dhe Verba (1963) argumentojnë se një sistem i qëndrueshëm demokratik politik varet nga një "kulturë qytetare" e fortë me besim të lartë ndërpersonal dhe përfshirjen aktive në shoqatat vullnetare. Studimet që lidhin besimin me rezultate të gjera, të tilla si rritja dhe mbijetesja e regjimit, janë plotësuar me punime që kërkojnë kanale të veçanta me anë të të cilave normat joformale të besimit dhe besueshmërisë mund të ndikojnë në këto rezultate të gjera. Duke përdorur të dhënat e anketës, Knack dhe Keefer (1997)

raportojnë se besimi i qytetarëve tek qeverisja - besueshmëria e qeverisë - është dukshëm më i madh në vendet me nivel të lartë besimi. La Porta et al. (1997) dhe Knack dhe Keefer (1997) tregojnë se vendet ku qytetarët besojnë më shumë shfaqen në renditje më të larta në vlerësimet e rrezikut të investitorëve të huaj për sa i përket masave subjektive të efikasitetit qeveritar, korrupsionit, dhe cilësisë së infrastrukturës. Knack (2002) raporton rezultate të ngjashme për shtetet amerikane, duke përdorur masa më "teknokrate" për matjen e cilësisë qeveritare. Këto rezultate sugjerojnë se normat që përshkruajnë bashkëpunimin dhe besueshmërinë çojnë në rritjen e efektivitetit qeveritar. Boix dhe Posner (1998) dhe Knack (2002) argumentojnë se kjo gjë ndodh duke i ndihmuar votuesit të kapërcejnë problemin e veprimit kolektiv në monitorimin dhe sanksionimin e zyrtarëve publikë. Çelësi për mbikëqyrjen e zyrtarëve të qeverisë është gatishmëria e qytetarëve për të mbledhur dhe vlerësuar informacionet në lidhje me performancën e qeverisë dhe gatishmërinë e tyre për të marrë masa (të tilla si votimi, të shkruajnë letra, nënshkruajnë peticione, demonstrata etj) për tua përcjellë preferencat e tyre zyrtarëve dhe për të përzënë performuesit e varfër. Qytetari që është i interesuar vetëm pas gjërave që i përkasin vetes, do të lërë pas dore detyrat, dhe do të përfitojë nga përpjekjet e të tjerëve. Qytetari i motivuar nga norma e bashkëpunimit qytetar (një manifestim i besueshmërisë) është më i informuar në lidhje me politikën dhe çështjet publike, dhe më i gatshëm për të votuar ose kontrolluar aftësinë e politikanëve dhe burokratëve për të pasuruar veten apo ndjekur interesat e tyre të ngushta.

Marrëdhënia e dokumentuar mes besimit dhe performancës së qeverisë tregon heterogjenitetin social, po në atë masë që ndikon tek besimi, duhet gjithashtu të ndikojë edhe performancën e qeverisë. Easterly dhe Levine (1997) pohojnë se heterogjeniteti etnik është i lidhur me një sërë treguesish të politikave joefikase, duke përfshirë nivelet

e larta të korrupsionit, normat e ulëta të shkollimit, mungesën e zhvillimit financiar, dhe infrastrukturën e varfër. Keefer dhe Knack (2002) kanë arritur në përfundimin se të drejtat e pronësisë janë më të pasigurta në shoqëritë shumë të polarizuara, që maten jo vetëm nga tensionet etnike dhe heterogjeniteti, por edhe nga të ardhurat dhe pabarazia e tokës (pronës).

Homogjeniteti i shoqatave, qoftë ky i matur nga ana farefisnore, gjinore, vendndodhja, niveli i të ardhurave apo tokë, nuk karakterizohet nga norma më të larta të shlyerjes, pjesërisht për shkak se goditjet e të ardhurave mund të variojnë më shumë brënda grupet homogjene (Van Bastelaer, 2000). Megjithatë, shpenzimet shtëpiake, pronësia e aseteve, dhe aksesit i kredive, janë të lidhura pozitivisht me anëtarësimin nëpër shoqata heterogjene. Diversiteti në nivelet e arsimit, profesionit dhe statusit ekonomik janë veçanërisht të dobishme, duke shënuar më shumë përfitime prej shkëmbimit atëherë kur njohuritë dhe shkathtësitë janë më të specializuara. Provat tregojnë se heterogjeniteti social minon normat shoqërore në të cilën besimi dhe besueshmëria mbështeten. Dy shpjegime të tjera të mundshme, vijnë së pari nga Alesina, Baqir dhe Easterly, të cilët argumentojnë se, njerëzit mund të preferojnë të financojnë të mira publike prej të cilave përfitojnë edhe njerëz të tjerë si vetja e tyre. Së dyti, Keefer dhe Knack (2002) argumentojnë se atëherë kur individët në një kolektiv kanë preferenca të ndryshme, vendimmarrja kolektive është natyrisht edhe më e vështirë, edhe ka më pak të ngjarë të prodhojë rezultate optimale për të gjithë, pavarësisht nga çdo normë bashkëpunimi apo pëlqimet e ndërsjellta.

2.2 Kultura politike dhe performanca e qeverisjes

Qasja e kulturës politike që shpjegon performancën e qeverisë ka një histori të gjatë në kohë (Almond dhe Verba, 1963, 1980; Barry, 1970; Laithin, 1995). Nocioni qëndror i saj është se një grup normash të përvetësuara strukturojnë sjelljen politike dhe se përhapja e gjerë ose mungesa e një norme apo një tjetre dikton shanset që ka çdo shoqëri për të pasur një regjim qeveritar të suksesshëm apo të pasuksesshëm. Këto norma vetë rrjedhin nga procesi i shoqërizimit dhe përforcohen ose riprodhohen gjatë zhvillimit normal të jetës sociale. Qasja e kulturës politike, parë në sytë e një kritiku, ka qenë në një gjendje të gjatë agonie (Laitlan, 1995), por një avokat i kësaj qasjeje kohët e fundit ka sugjeruar se ajo po shijon një periudhë rilindjeje (Ingelhart, 1988). Ndërkohë që kërkesa ishte ndoshta e parakohshme, publikimi i hulumtimit të Putnam-it mbi qeveritë rajonale italiane dhe shumë nga reagimet fillestare lidhur me të, mund të sugjerojnë se qasja e kulturës politike është në rritje (shih., p.sh. La Palombara, 1993; Laitlan, 1995). Ky punim bën përpjekje për të vlerësuar rëndësinë e konceptit të Putnam-it rreth kapitalit social në lidhje me ndryshimet në performancën e qeverisjes vendore për sa i përket Shqipërisë.

Një tjetër mënyrë për të shpjeguar variacionet në suksesin e qeverive mund të shihet në traditën e gjatë që i ka kushtuar rëndësi dallimeve në tiparet institucionale të qeverisjes. Në literaturën bashkëkohore (p.sh. Lijphart, 1984; Baylis, 1989; Weaver dhe Rockman, 1993; Schmidt, 1995; Taagepera, 1996) gjendet një sasi e konsiderueshme pune për sa i përket diferencave në strukturën institucionale në nivel kombëtar. Në formën e vet më të avancuar, kjo qasje e përgjithshme i ka kushtuar vëmendje të veçantë formalizimit të argumenteve për mënyrën se si struktura formon stimuj dhe strategji dhe në këtë mënyrë si ndikon në performancën e qeverisë (Shepsle, 1989). Duke u mbështetur në një model

të kësaj tradite, një model i fokusuar në një sistem të vendimmarrjes veto mes lojtarëve, (Tsebelis, 1995), është bërë një përpjekje për të ndriçuar efektet e dallimeve institucionale të mundshme në performancën e qeverisjes vendore.

2.3 Teoria e Putnam-it mbi ndikimin e kapitalit social në qeverisje

Robert Putnam (1993) pohon se faktorët kulturorë kanë marrë një pjesë të madhe të vëmendjes si qëndrorë në përcaktimin e performancës institucionale. Në bazë të një argumenti teorik të përpunuar si edhe provave të gjera të nxjerra nga studimi përgjatë disa dekadave i qeverive rajonale në Itali, Putnam pretendon se komunitetet e karakterizuara nga rezerva të mëdha të kapitalit social kanë më shume gjasa të kenë qeveri më të mira sesa ato me rezerva të ulëta.

2.3.1 Teza themelore

Që nga publikimi i "*Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy*" në 1993, puna e Putnam-it ka shkaktuar më shumë diskutime dhe debate se çdo punë tjetër e viteve të fundit në shkencat politike. Për shkak të argumenteve bindëse, metodologjisë inovative që ndërmerr dhe agjendës emocionuese që nis, kjo është një punë e cila ka ndryshuar tashmë mënyrën sesi akademikët dhe politikëbërësit e shohin marrëdhënien midis politikës dhe shoqërisë. Implikimet e gjetjeve të Putnam-it janë të thella. Sociologët tashmë janë të detyruar të shtojnë kapitalin social në listën e variablave kur përpiqen të shpjegojnë dukuritë politike dhe ekonomike. Putnam, njëlloj si teoricienët e zgjedhjes racionale mbi të cilët mbështetet, argumenton se bashkëveprimi intensiv social nëpër shoqatat qytetare lehtëson bashkëpunimin, sepse ul kostot e transaksionit të përpjekjeve bashkëpunuese.

Teza kryesore e studimit italian të Putnam-it ishte roli i angazhimit qytetar në krijimin e kapitalit social, që rezultonte në qeveri më të suksesshme rajonale. Analiza e tij krahasuese mbi qeveritë rajonale italiane zbuloi se rajonet që karakterizoheshin nga rrjete qytetare më të gjalla kishin institucionet më të suksesshme të qeverisjes rajonale. Suksesi tregohet edhe në efikasitetin me të cilin qeveritë rajonale punonin, si dhe mënyrën sesi perceptoheshin nga publiku. Hipoteza mbi marrëdhëniet midis kapitalit social dhe qeverisjes së mirë bazohet në nocionin "Tocquevillian" të aktivizmit qytetar, duke theksuar efektet e dyfishta të shoqatave të qytetarëve: efektet e brendshme për anëtarët individual dhe efektet e jashtme për sistemin politik. Putnam argumenton se pjesëmarrësit e shoqatave fitojnë "zakonet e bashkëpunimit, solidaritetit dhe gjallërisë publike" (Putnam, 1993: 89-90), dhe gjithashtu fitojnë aftësitë që janë të rëndësishme për funksionimin në një demokraci pjesëmarrëse. Për këtë arsye, shoqatat civile mund të funksionojnë si shkolla për qytetarët në demokraci. Efektet e jashtme shfaqen në lidhjet institucionale që shoqatat qytetare krijojnë mes anëtarëve të tyre dhe sistemit politik dhe lejimin e rrjedhjes së informacionit dhe artikulimit të interesave. Këto efekte të dyfishta të pjesëmarrjes supozohet të prodhojnë zyrtarë publikë më të përgjegjshëm, si dhe qytetarë të angazhuar që kanë kapacitetin të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe në rezultatet politike. Për më tepër, nocioni i marrëdhënieve ndërmjet kapitalit shoqëror dhe qeverisjes së mirë të Putnam-it duhet të kuptohet si një zhvillim përforcues dhe kumulativ, jo si një mekanizëm që vepron vetëm në një drejtim.

Argumenti i Putnam mund të përmbledhet në pesë pikat e mëposhtme:

- (1) Kapitali social promovon bashkëpunimin dhe bashkëpunimi lehtëson zgjidhjen e problemeve brenda komunitetit;

(2) përbërësit e kapitalit social përforcojnë njëri-tjetrin, ata janë të lidhur në mënyrë reciproke dhe përdorimi i tyre lehtëson krijimin e rezervave më të mëdha, ndërkohë që mospërdorimi i tyre zvogëlon rezervat;

(3) nëse nuk pësojnë ndonjë ndryshim dramatik, komunitetet janë të shënuar nga të dyja nivelet e kapitalit social, ose i lartë ose i ulët;

(4) stoku i kapitalit social në kulturën masive të një komuniteti reflektohet tek stoku brenda kulturës së elitës politike të komunitetit;

(5) në bashkësitë demokratike me nivele të larta të kapitalit shoqëror, performanca e qeverisë do të jetë e mirë; në komunitetet ku nivelet e kapitalit social janë të ulëta, performanca e qeverisë do të jetë e varfër.

Egzistojnë një sërë aspektesh të ndërvarura të kapitalit social, nga të cilat Putnam thekson tre. Së pari, besimi, i cili është konsideruar një "komponent thelbësor i kapitalit social" për shkak se lehtëson bashkëpunimin e nevojshëm për koordinim brenda shoqërisë (Putnam, 1993: 170). Së dyti, normat e reciprocitetit të përgjithshëm, që lehtësojnë "zgjidhjen e dilemave të veprimit kolektiv " dhe janë përshkruar si një "komponent tejet produktiv i kapitalit social " (Putnam, 1993: 172). Së treti, rrjetet e angazhimit qytetar, të cilat gjithashtu përbëjnë "një komponent thelbësor të kapitalit social" (Putnam, 1993: 173). Duke qenë të përfaqësuara nga shoqatat dytësore, të tilla si klubet sportive apo shoqëritë korale, ato ofrojnë hapësirë për "ndërveprim horizontal intensiv "që nxit "besimin social dhe bashkëpunimin " (Putnam, 1993: 173-4). Në fund të fundit, vlera e kapitalit social mund të shihet në lehtësimin e bashkëpunimit mes qytetarëve brenda një komuniteti. Në të njëjtën kohë, "besimi social, normat e angazhimit qytetar dhe bashkëpunimit të suksesshëm janë reciprokisht përforcuese

"(Putnam, 1993: 180). Për shembull, njohja e faktit që besimi nuk do të shfrytëzohet, lehtëson dhe nxit normën e reciprocitetit të përgjithësuar (Putnam, 1993: 172). Ky i fundit inkurajon pjesëmarrjen bashkëpunuese në rrjetet sociale, e cila nga ana tjetër ushqen dhe përforcon këtë normë (Putnam, 1993: 176). Për më tepër, ndryshe nga sa ndodh me kapitalin fizik, përdorimi i kapitalit social e rrit stokun e këtij malli, kurse mungesa e përdorimit e zvogëlon atë (Putnam, 1993: 170). Këto attribute të përforcimit të ndërsjellë, vetë-përforcimit dhe shtimit, sjellin një nga dy ekuilibrat social (Putnam, 1993: 177-81). I pari është rezultat i një "rrethi të virtytshëm", ku rezervat e larta të kapitalit social mbështesin veten e tyre dhe gjenerojnë më shumë kapital social; i dyti është produkt i një "rrethi vicioz", ku mungesa relative e këtyre tipareve përforcon dezertimin dhe mungesën e bashkëpunimit dhe në këtë mënyrë dëmton çdo kapital social ekzistues.

Duke qenë se kapitali social promovon virtytin qytetar tek qytetarët, atëherë duhet edhe të krijojë komunitete më qytetare, qeveritë demokratike të të cilëve supozohet të performojnë mirë (Putnam, 1993: 175-176). Putnam sugjeron dy kanale nëpërmjet të cilave krijohet ky efekt. I pari, për shkak se qytetarët e virtytshëm janë kaq të angazhuar në komunitetet e tyre, ato janë më efektive nëse kërkojnë dhe veprojnë për një qeverisje të mirë. Nëpërmjet rrjeteve të tyre të dendura të organizatave, ata mund t'i bëjnë presion qeverisë që të performojë mirë. Kanali i dytë, duke siguruar një infrastrukturë sociale të fuqishme për komunitetin dhe duke ngulitur vlerat demokratike brenda elitave dhe masave, kapitali social lehtëson atë lloj bashkëpunimi që është i nevojshëm për të identifikuar, miratuar dhe zbatuar politika efektive për komunitetin (Putnam, 1993: 182).

Pasojat e kësaj për teorinë demokratike mund të shihen si nga një perspektivë pesimiste, ashtu edhe nga një perspektivë optimiste. Nga njëra anë, perspektiva pesimiste sugjeron se asnjë lloj inxhinierie institucionale nuk do ta lejojë të performojë me sukses një qeveri demokratike, nëse kapitali shoqëror nuk është pjesë e kulturës në të cilën ajo vepron. Perspektiva tjetër, nënkupton që ndërkohë që performanca degradon në kushtet e mungesës së kapitalit social, institucionet ende mund të punojnë për një efekt të pavarur; megjithatë çdo lloj efekti pozitiv që një dizajn institucional mund të ketë, thjesht do të punonte më mirë nëse mjedisi në të cilin ekziston do të paraqitej më i favorshëm.

2.3.2 Kritika ndaj qasjes së tij

Goldberg (1996) sugjeron se ka një sërë problemesh të mëdha me argumentat dhe provat e Putnam dhe se të marra së bashku këto probleme minojnë konkluzionet e punës së tij. Një problem i madh vihet re për shembull nga ana empirike, sipas mendimit të Goldberg. Për të mbështetur argumentin e kapitalit social, kovarianca e fortë midis kapitalit social dhe performancës në të gjithë Italinë (pra Veriore dhe Jugore) duhet të përputhet në nivele të ngjashme të kovariancës brenda dy pjesëve të Italisë; ndërkohë që përmend një numër shembujsh ku në të vërtetë një marrëdhënie e tillë nuk ekziston. Një problem tjetër është argumenti i rrugës së varësisë sipas së cilit kushtet historike kanë një peshë të madhe në prodhimin dhe riprodhimin e kulturës qytetare dhe mungesa e saj nuk është bindëse dhe përputhet me provat historike.

Levi (1996) sheh tre probleme me punën e Putnam-it, të cilat kanë të bëjnë me (1) problemin e rrugës së varësisë në termat e kapitalit social; (2) mekanizmat që supozohet

të prodhojnë kapital social; dhe (3) se si qeveria, veçanërisht qeveria demokratike, prodhohet nga kapitali social. Ajo tregon dy analizat e argumentit të tij të rrugës së varësisë, si dhe dëshmitë historike që ai ofron për të mbështetur këtë argument janë të pamjaftueshme. Ajo vë në mëdyshje përkufizimin e tij për besimin dhe nëse ndërvlerësia mes tij dhe komponentëve të tjerë të kapitalit social, si për shembull jetës së fortë asociative, normave të reciprocitetit, me të vërtetë mban. Lidhja e supozuar mes kapitalit shoqëror dhe performancës së mirë demokratike mund të mos jetë bindëse.

Kundërshtime të tjera përfshijnë problemin e *free riding*, zinxhirin shkakësor mes jetës aktive asociative dhe pjesëmarrjes politike demokratike, pengesat mes pjesëmarrjes dhe efektivitetit të kërkesave, çështjen nëse shkakësia rrjedh në drejtimin tjetër, dmth, nga performanca e qeverisë drejt kulturës politike. Një tjetër argument i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë është që kapitali social mund të mos funksionojë në mënyrë universale. Sic pohojnë Carpenter, Daniere dhe Takahashi (2004: 885) "kapitali social me shumë gjasa ndryshon në varësi të vendit, popullsisë dhe komuniteteve". Për më tepër, Ikeda, Yamada dhe Kohno (2003: 12) konfirmojnë që "llogjika e Putnam-it mbi demokracinë mund të ketë disa kufizime për sa i përket aplikueshmërisë në ambiente të ndryshme kulturore". Në këtë mënyrë, teoria e Putnam-it mund të mos zbatohet efektshëm në çdo lloj konteksti.

2.4 Kapitali social dhe mirëqeverisja

Ka edhe dëshmi se kapitali social çon në "risi të madhe dhe fleksibilitet në hartimin e politikave", duke lejuar krijimin e asaj politike që mund të përgjigjet më lehtë për krizat ose të shfrytëzojë mundësitë. Kapitali social është gjithashtu një parakusht i rëndësishëm për prodhimin e risive pasi stimulon ndërveprimet ndërpersonale,

formimin e rrjeteve dhe qarkullimin e njohurive të vlefshme (Tura dhe Harmaakorpi, 2005). Kurse rrjetet që lidhin individët, grupet, firmat, industritë me baza të ndryshme njohurish janë një parakusht i rëndësishëm për prodhimin dhe transferimin e njohurive. Në këtë kontekst, procesi kumulativ i ngulitur në kontekstin social dhe sistematikisht i ndikuar nga proceset e të mësuarit interaktiv që stimulojnë shkëmbimin e njohurive prodhon risi (Asheim, 1999; Lundvall, 1992).

2.4.1 Rrjetet sociale dhe shkëmbimi i informacionit

Rrjetet e mbyllura e me dendësi të lartë, në të cilët shumë anëtarë njohin dhe kanë lidhje të forta me njëri-tjetrin, janë konsideruar si të rëndësishëm për mbrojtjen e personave nga streset mendore dhe fizike (Kadushin, 1982), veçanërisht midis shtresave të ulëta ekonomike (Fischer, 1982a). Rrjetet e mbyllura mund të jenë të dobishme në situata emergjente, fatkeqësie dhe pionere (Hurlbert, Beggs dhe Haines, 2001). Së fundi, dhe ndoshta më e rëndësishmja, studimet empirike kanë treguar se njerëzit me rrjetet e dendura jetojnë më gjatë (Berkman dhe Syme, 1979; House, Landis, dhe Umberson, 1988). Coleman (1990) pohon se rrjetet sociale me “lidhje të lartë” janë të dobishëm bazuar në argumentet e kohezionit social: nëse të gjithë njerëzit në një grup njohin njëri-tjetrin, mund të ndajnë ata të njëjtin sistem normativ dhe të kenë një sistem sanksionues efektiv, i cili kontribuon për besimin dhe mobilizimin aktual të mbështetjes së mundshme. Rrjetet e dendura që përfshijnë marrëdhënie më intime dhe reciproke mund të rrisin gjasat e mobilizimit të të tjerëve, për shkak të interesave të përbashkëta (Lin, 1999a).

Në kundërshtim me këtë, Burt (1992), duke u bazuar tek idetë e Granovetter (1973, 1974) për funksionet e urave dhe lidhjeve të dobëta në rrjetet sociale, pohon avantazhet krahasuese të kapitalit social ngulitur në rrjetet e hapura e me densitet të ulët. Rrjetet sociale që nuk janë të lidhur në mënyrë perfekte, me të ashtuquajturat vrima strukturore mund të jenë më të vlefshme për arritjen e qëllimeve individuale për dy arsye. Së pari, në rrjete të tilla njerëzit kanë më pak gjasa të ndajnë informacione të njëjta ose të zotërojnë të njëjtat burime, dhe kështu ata mund të përfitojnë nga njëri-tjetri. Së dyti, hapja e strukturës së rrjetit social ka përparësi në aspektin e informacionit dhe të kontrollit: një strukturë e hapur përmirëson pozicionin e bisedimeve të dikujt (Burt, 1992).

E ashtuquajtura "hipoteza e lidhjeve të dobëta" e propozuar nga Granovetter (1973) është e rëndësishme në këtë kontekst. Marrëdhëniet mes njerëzve mund të karakterizohen ose nga kontaktet emocionale dhe të shpeshta ose nga ndërveprime sporadike me përfshirje të ulët emocionale. Kategoria e parë identifikohet në përgjithësi si "lidhje të forta", të tilla janë marrëdhëniet brenda familjes apo miqve të ngushtë, ndërsa e dyta është e lidhur me përkufizimin e "lidhjeve të dobëta", që lidh individët të cilët janë pjesë e rrjeteve me njohuri të gjera. Janë pikërisht "lidhjet e dobëta" që mund të shihen si burime informacioni dhe përgjegjëse për përhapjen e ideve (Granovetter, 1982; Rogers, 1995), ndërkohë që "lidhjet e forta" rrisin rrezikun e shkëmbimit të njohurive të tepërta thjesht sepse ato lidhin ata që kërkojnë njohuri me individë të tjerë që me shumë gjasa merren me informacion të njohur dhe njohuri familiare (Levin dhe Cross, 2004).

Me fjalë të tjera lidhjet e dobëta janë themelore për përhapjen e informacionit, sepse veprojnë si urë midis grupeve sociale të ndara (Ruef, 2002). Lidhjet e dobëta shërbejnë

si mekanizëm lidhës ndërmjet komuniteteve brenda së njëjtës shoqëri, ndërsa lidhjet e forta funksionojnë si mjet lidhës brenda grupeve homogjene, mundësisht duke penguar shoqërizimin jashtë qarqeve sociale të kufizuara (Beugelsdijk dhe Smulders, 2003). Nëse njohuria qëndron shumë brenda komuniteteve të lidhura, të cilët nuk kanë besim te njëri-tjetri, atëherë përhapja e saj do të jetë e kufizuar dhe e pabarabartë. Krijimi i lidhjeve u jep komuniteteve me më shumë njohuri besimin se njohuritë e tyre do të përdoren nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera për përfitime të përbashkëta (Rodríguez-Pose dhe Storper 2006: 8).

Në këtë mënyrë "ana e errët e kapitalit social " qëndron tek tipologjia e lidhjeve dhe rrezja e besimit tek rrjeti më tepër sesa tek intensiteti i përgjithshëm i marrëdhënieve mes individëve që kanë njohuri, pra duhet kërkuar për tipologjinë më të "drejtë", në vend të një "sasie" optimale të kapitalit social, nëse duam të synojnë në rritjen e performancës lokale.

Bollëku i informacionit në lidhje me besueshmërinë e anëtarëve të rrjetit e lehtëson bashkëpunimin brenda tij, ndërsa mungesa relative e një informacionit të tillë në lidhje me partnerët e mundshëm bashkëpunues nga rrjetet e tjera e bën bashkëpunimin me anëtarët e rrjeteve të tjera relativisht më të rrezikshëm. Disponueshmëria e sanksioneve të grupit (të tilla si përjashtimi nga përfitimet e transaksioneve të ardhshme të grupit) kundrejt një anëtari të rrjetit që "gabon" mungon në transaksionet jashtë rrjetit, duke e bërë bashkëpunimin ndërmjet rrjeteve më pak të sigurt. Përveç kësaj, duke qenë se rrjetet janë të bazuara në një lloj shkalle të lidhjeve të përkatësisë etnike apo familjare, dhe duke qenë se lidhje të tilla ofrojnë një model kulturor të përcaktuar për bashkëpunim, mungesa e modeleve të tilla në bashkëpunim ndërmjet rrjeteve i bën bashkëpunime të tilla relativisht më të vështira. Për të gjitha këto arsye, ushtrimet

bashkëpunuese që kërkojnë koordinim mes rrjetesh, do të jenë shumë më të kushtueshme se përpjekjet bashkëpunuese që ndodhin brenda rrjeteve sociale. Politikëbërësit, të cilët po mendojnë të investojnë burime për kultivimin e kapitalit social që prodhon shoqatat civile si mjet për promovimin e zhvillimit ekonomik apo efektivitetit qeveritar, do të ishte mirë që së pari të merrnin në konsideratë nëse anëtarësimi nëpër grupe të tilla do të ndante apo do të përfshinte segmente të gjera dhe të ndryshme të shoqërisë. Në këtë rast, projekti i nxitjes së një jete më të gjallë të shoqatave mund të sjellë si rezultat një shoqëri më të ndarë dhe më pak bashkëpunuese se ajo që ishte para se nisma të ndërmerrej. Ndërkohë që një politikë e tillë mund të sjellë përfitime në një periudhë afatgjatë (kur rezervat e kapitalit social të arrijnë një prag tepër të lartë për të lejuar shfaqjen e ndërveprimeve akomoduese në të gjithë kufijtë e grupit), minimi i kapaciteteve të bashkëpunimit më afatshkurtër mund të jetë jashtëzakonisht i kushtueshëm.

2.4.2 Kapitali social dhe qeverisja e mirë

Dëshmi për marrëdhëniet mes kapitalit të lartë social dhe mirëqeverisjes gjenden në shembujt e niveleve të ndryshme, nga mikro në ndërkombëtar. Për shembull, në nivel mikro, suksesi relativ i skemave të strehimit të qiramarrjes mbështetet në nivelet para-ekzistuese të kapitalit social mes banorëve (Saegert dhe Winkel, 1998). Në nivel kombëtar, nivelet e korrupsionit dhe cilësia e burokracisë janë të lidhur në mënyrë të konsiderueshme me nivelet e përgjithshme të besimit social (La Porta et al, 1997), ndërsa në nivel ndërkombëtar kapitali social është i rëndësishëm për shembull tek rrjetet

sociale ndërkombëtare etnike, të cilat mbajnë bashkë qytetarët në anë të kundërta të kufijve kombëtarë, duke nxitur iniciativa më efikase nëpër rajone (Chen, 2000).

Roli i kapitalit social mund të kuptohet edhe në sajë të marrëdhënies së dyanshme që egziston mes shoqërisë civile dhe qeverisë. Siç vë në dukje Maloney (et.al., 2000) "qeverisja e një vendi ndikohet por gjithashtu edhe ndikon mbi kapitalin social". Qeveritë (sidomos në nivel lokal) u japin formë kushteve sipas të cilave rrjetet shoqërore dhe shoqatat vullnetare mund të lulëzojnë ose jo. Përvec se në krijimin, qeveria ndikon edhe në mobilizimin e kapitalit social, dhe përcakton shkallën e ndikueshmërisë që qytetarët individualisht dhe interesat e organizuara mund të kenë mbi funksionimin dhe performancën e demokacisë. Thënë kjo, mund të deduktohet se qeveritë paskan edhe fuqinë të "shkatërrojnë" rrethet vicioze dhe të promovojnë ato virtuoze.

Pse disa qeveri janë më të qëndrueshme, më efikase, më të reja dhe më të mirë-menaxhuara se disa të tjera? Përgjigjet tradicionale të këtyre pyetjeve fokusohen në faktorë të tillë si konkurrenca zgjedhore, dizajni institucional, polarizimi politik, kapacitetet burokratike dhe moderniteti socio-ekonomik. Teoricienët e kapitalit social na kanë dhënë një variabël shtesë të fuqishëm shpjegues. Logjika sesi kapitali social prodhon efektivitet qeveritar, megjithatë, nuk është e specifikuar mirë. Tradita e teorisë së lojës tek e cila zakonisht mbështeten studiuesit e kapitalit social tregon se si kapitali shoqëror lehtëson bashkëpunimin që të bën të mundur që aktorët të arrijnë rezultate sociale më të larta. Por kjo na lë pa një artikulum të qartë të mekanizmit me të cilin aftësia e njerëzve për të bashkëpunuar në shoqëri ndikon në performancën e institucioneve qeveritare në krye të tyre.

2.4.3 Modelet e marrëdhënieve mes kapitalit social dhe qeverisjes

Deri tani, teoria e kapitalit social nuk e ka specifikuar logjikën e mikro-lidhjeve që bashkon kapacitetin bashkëpunues të një komuniteti për arritjen e një qeverisjeje të mirë. Për të mbushur këtë boshllëk, na vijnë në ndihmë pesë modele të marrëdhënieve mes kapacitetit bashkëpunues të shoqërisë dhe performancës së institucioneve të saj politike.

Votues Racionale dhe Elita Konkurruese

Në themel të modelit të parë qëndron imazhi i një demokracie të përkryer konkurruese në të cilën votuesit janë të informuar mirë, të aftë për tu mobilizuar shpejt dhe të etur për të ndëshkuar në kutinë e votimit përfaqësuesit e zgjedhur që nuk performojnë mirë. Duke ditur këtë, përfaqësuesit shqetësohen që të kënaqin votuesit dhe të qeverisin sipas dëshirave të tyre. Ata punojnë shumë për të zbatuar politikat e preferuara nga shumica e votuesve të tyre dhe u bëjnë presion burokratëve për t'i kryer shërbimet në mënyrë sa më efikase që të munden.

Meqë funksionimi efektiv i institucioneve politike varet nga aftësia e qytetarëve për t'u kërkuar përfaqësuesve të tyre llogari për cilësinë e qeverisjes që ofrojnë, kapitali social do të prodhojë qeverisje të mirë e sa më të sofistikuar. Pjesëmarrja aktive në shoqatat e komunitetit do t'u ofronte qytetarëve mundësi për të diskutuar rreth çështjeve civile, do të rriste ndërgjegjësimin e tyre rreth çështjeve politike dhe do të siguroheshin nëse qeveria është duke bërë çdo gjë që duhet për të përmirësuar mirëqenien e tyre. Një komunitet qytetar, është në një pozicion më të mirë për t'i kërkuar qeverisë së vet të jetë përgjegjëse për veprimet e saj. Duke e ditur këtë, votuesit e tyre vëzhgojnë dhe

diskutojnë sjelljen e tyre, elitat politike punojnë më shumë për të qeverisur në mënyrë sa më efektive, që të mos të largohen nga detyra në kohë zgjedhesh.

Në mënyrë që qytetarët të jenë më të informuar dhe të ndërtojnë aftësitë e tyre të gjykitimit, kapitali social kontribuon në qeverisjen efektive duke lehtësuar artikulumin e kërkesave të qytetarëve. Literatura rreth veprimit kolektiv thekson se organizimi dhe përfaqësimi i të gjitha interesave të shoqërisë nuk është automatik, vetëm një pjesë e popullsisë është e organizuar në grupe interesi dhe preferencat janë të përfaqësuara në mënyrë të pabarabartë në arenën politike. Në një kontekst të tillë asimetrik të interesit, qytetarët që janë të organizuar do ta kalojnë koston e politikave të tyre të preferuara tek shumica, duke mos arritur rezultate efikase. Në komunitetet shumë qytetare, nga ana tjetër, qytetarët do të jetë në gjendje të kapërcejnë dilemat e veprimit kolektiv dhe të artikulojnë interesat e tyre ndaj qeverisë.

Sa më qytetar të jetë një komunitet, aq më të aftë do të jenë anëtarët e tij për të kapërcyer dilemat e veprimit kolektiv që qëndrojnë në rrugën e organizimit të grupeve të afta të artikulojnë interesat e tyre ndaj qeverisë. Sa më e vetëdijshme të bëhet qeveria për dëshirat e komunitetit, aq më shumë politikat e saj do ta reflektojnë. Sipas këtij modeli ka dy mënyra themelore nëpërmjet të cilave kapitali social mund të përmirësojë performancën qeveritare:

Së pari, duke rritur përgjegjshmërinë e qeverisë, kapitali social rrit përfshirjen politike të qytetarëve, duke e bërë më të lehtë për të kapërcyer problemin e veprimit kolektiv për t'i kushtuar vëmendje dhe ndjekur qeverinë. Frymëzon aktivitete si monitorimi i zyrtarëve, duke protestuar dhe duke shprehur preferencat, të cilat mund ta bëjnë qeverinë më të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve në përgjithësi në krahasim me interesat e

veçanta. Këto aktivitete po ashtu eliminojnë humbjet, mashtrimin, mungesën e efikasitetit dhe paaftësinë nëpërmjet zbulimit apo parandalimit. Kur ka një fond kapitali social, "free riding" është më pak i shpeshtë dhe performanca qeveritare mund të përmirësohet duke ndikuar nivelin dhe karakterin e pjesëmarrjes politike (Knack, 2002: 773).

Së dyti, kapitali social mund ta bëjë qeverisjen më efikase, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe gjallërinë publike në mesin e zyrtarëve dhe administratorëve; këto cilësi luftojnë bllokimin dhe polarizimin.

Respektimi i Rregullave

Një model i dytë që lidh kapitalin shoqëror me efikasitetin e qeverisë thekson mënyrën sesi kapitali social redukton kostot e zbatimit të politikave dhe rregulloreve qeveritare. Ky model ka në qendër rolin kryesor të kapitalit social në reduktimin e kostove të transaksionit në arenën e marrëdhënieve qytetarë-qeveri. Qeveritë u imponojnë kosto qytetarëve dhe kështu sigurojnë përfitime të vlefshme. Ato mbledhin taksat për të paguar shkollat, policinë, rrugët dhe shërbime të tjera publike dhe vendosin rregullore të shtrenjta për të garantuar siguri në vendet e punës, një mjedis më të pastër, ilaçe dhe ushqime më të sigurta. Për të siguruar respektimin e rregullave, qeveritë duhet të krijojnë mekanizma komplekse dhe të kushtueshme, dhe kapitali social zvogëlon nevojën për mekanizma të tillë duke u dhënë formë pritshmërive që kanë qytetarët në lidhje me sjelljen e të tjerëve. Nëse njerëzit presin që shokët e tyre të paguajnë taksat, atëherë edhe kostoja e zbatimit të pajtueshmërisë do të jetë e ulët. Nga ana tjetër, në qoftë se njerëzit presin që të tjerët të mos i paguajnë taksat ose të mos pajtohen me to, atëherë ka më pak gjasa që edhe ata vetë ta bëjnë një gjë të tillë, ndaj kostot e zbatimit të

pajtueshmërisë do të jenë të larta. Duke i dhënë qytetarëve pritshmëri më optimiste në lidhje me sjelljen e bashkëqytetarëve të tyre, kapitali social mund të lehtësojë qeverinë nga barra e detyrimit të respektimit të rregullave dhe disa prej këtyre burimeve mund të përdoren për rritjen e efikasitetit ose zgjerimin e gamës së shërbimeve që ofrohen.

Virtyti Qytetar

Kapitali social promovon qeverisjen e mirë duke zhvendosur shijet e komunitetit nga interesat e veçanta (si mund të bëhem i pasur?) drejt shqetësimeve të komunitetit (si mund të përmirësohet lagjia jonë?). Duke rritur interesimin e qytetarëve për përfitime kolektive, zhvillimin e "Unë" në "Ne" sic shprehet Putnam, kapitali social inkurajon artikullimin e kërkesave ndaj qeverisë, kërkesa të cilat janë për të mirën e të gjithëve, në vend që të ndihmojë disa anëtarë të shoqërisë në kurriz të të tjerëve. Për të njëjtat arsye, prania e rezervave të bollshme të kapitalit shoqëror në një komunitet mund t'i ulë kërkesat për shpenzimet e konsumit afatshkurtër dhe të inkurajojë llojet e investimeve që do të përmirësonin në mënyrë dramatike jetën e pjesëtarëve të bashkësisë në sensin afatgjatë.

Për Putnam, virtyti qytetar është një përzierje tiparesh. Një qytetar i virtytshëm është i interesuar për punët publike, është i lidhur me komunitetin nëpërmjet anëtarësimit nëpër shoqata qytetare karakteristika përcaktuese kryesore e të cilave është barazia, është një person i cili nëpërmjet pjesëmarrjes mëson t'u besojë të tjerëve dhe të tolerojë pikëpamjet divergjente. E gjithë bashkësia qytetare është një rrjet i dendur shoqatash. Një mjedis i tillë promovon "zakonet e bashkëpunimit, solidaritetit, dhe gjallërinë publike". Ky efekt i brendshëm është i favorshëm për të prodhuar qytetarë të aftë për të punuar në mënyrë efektive në një sistem politik demokratik. Më tej, ai ndihmon

procesin politik demokratik me efektet e tij të jashtme duke lehtësuar "grumbullimin" dhe "artikulimin" e interesit. Duket se virtyti qytetar është një manifestim i nivelit individual i asaj që Putnam përshkruan si kapital social, i cili përcaktohet si një tipar i shoqërisë që promovon efikasitetin social me anë të "lehtësimit të veprimeve të koordinuara" (Putnam, 1993: 167).

Efikasiteti burokratik

Një hipotezë e katërt thotë se kapitali social promovon efikasitetin institucional përmes ndikimit në sjelljen e politikë-bërësve dhe elitave burokratike. Ai e bën këtë në dy mënyra. Së pari, nxit aftësinë e burokratëve të qeverisë për të bashkëpunuar me njëri-tjetër gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Për aq kohë sa elitat politike dhe burokratët përgjegjës për shkrimin e legjislacionit të reformës, që administrojnë qendrat e përkujdesjes ditore ose iu përgjigjen pyetjeve të qytetarëve janë anëtarë të një shoqërie më të madhe të pasur me kapital social, ata do të jenë në gjendje të bëjnë kompromis me njëri-tjetrin, të punojnë së bashku në mënyrë efikase dhe t'u rezistojnë tundimeve për të lënë pas dore punën e tyre. Cilësia e qeverisjes, pra, do të rritet.

Së dyti, kapitali social rrit kapacitetin e zyrtarëve të qeverisë për të menaxhuar agjensitë publike. Në shoqëritë moderne, prodhimi dhe shpërndarja e mallrave dhe shërbimeve kërkon marrëveshje komplekse institucionale për të strukturuar dhe bashkërenduar aktivitetet e punëtorëve. Duke parë që menaxherët e lartë (drejtorët) janë përgjegjës për mbikqyrjen e punës së një numri shumë të madh personeli administrativ të nivelit të mesëm dhe të ulët, egziston mundësia që të joshen për të shfrytëzuar pozicionet e tyre të punës. Në këtë mënyrë, menaxherët e lartë duhet të devijojnë një pjesë të konsiderueshme kohe dhe burimesh për monitorimin e performancave joproduktive.

Nëse ata arrijnë ta minimizojnë sasinë e kohës dhe burimeve dedikuar këtij qëllimi, organizata që ata drejtojnë do të jetë më efikase dhe produktive.

Për të ulur kostot e monitorimit, tradicionalisht, zhvillohen institucione formale (si paga të bazuara në performancë dhe rregulloret strikte të punës) që krijojnë pengesa për agjentët që veprojnë në mënyrë oportuniste. Prania e niveleve të larta të kapitalit social mes anëtarëve të organizatave, përbën një institucion informal shtesë, që mund të ketë produktivitetin më të lartë duke ndikuar pritshmëritë që kanë agjentët në lidhje me sjelljen e kolegëve dhe eprorëve të tyre. Në komunitetet (dhe agjensitë publike) të pasura me kapital social, agjentët e marrin të mirëqenë që drejtuesit dhe kolegët punojnë për suksesin e tyre të përbashkët, ndaj priren ta bëjnë këtë edhe vetë. Në agjensitë e vendosura në komunitete që kanë kapital social të varfër, në të kundërt, drejtorët do të jenë të detyruar të investojnë në monitorimin e punonjësve të tyre dhe në pajisje sanksionuese për t'u mbrojtur kundër sjelljeve oportuniste. Duke mos pasur besim, të punësuarit nga ana e tyre do ta zvarrisin punën për të shmangur zbulimin dhe dënimin. Në të tilla situata, ofrimi i të mirave dhe shërbimeve kolektive do të jetë më i ngadalshëm dhe më i shtrenjtë.

Përshtatja e elitave

Një model i pestë lidh kapitalin social dhe qeverisjen e mirë përmes aftësisë për të nxitur praktikën e përshtatjes mes elitave, pa të cilat këto të fundit do të ishin antagonistë. Ky model zbatohet për një nënbashkësi të veçantë vendesh dhe institucionesh, në të cilat problemet e qeverisjes së mirë përbëhen nga fakti se qytetarët

janë të ndarë në blloqe antagonistë etnike, fetare apo klasore. Zgjidhja e preferuar institucionale për situata të tilla është futja e institucioneve konsocionale, ose konsociacionalizmi. Suksesi apo dështimi i kësaj taktike varet nga dy faktorë: përkushtimi i udhëheqësve për ta bërë sistemin të funksionojë, si dhe aftësinë e këtyre udhëheqësve për të bërë kompromiset e nevojshme pa humbur mbështetjen e anëtarëve.

Në shoqëritë me ndarje të thella, rrjetet e jetës asociative priren të jenë ndarë, dhe kapitali social që këto rrjete prodhojnë nuk është i përshtatshëm për nxitjen e bashkëpunimit përtej kufijve të rrjetit. Akumulimi i kapitalit social, pra, do të përforconte ndarjet shoqërore dhe zvogëlonte stimujt për udhëheqësit e grupit për të bërë kompromis me njëri-tjetrin. Kur rezervat e kapitalit social arrijnë nivele shumë të larta, ky efekt mund të përmbysset.

Ndërveprimet që e bëjnë bashkëpunimin mes rrjeteve relativisht më të rrezikshëm, njëkohësisht do t'i bënin ata që veprojnë brenda rrjetit më pak të ndjeshëm ndaj rrezikut. Ndërkohë që në nivele të ulëta dhe të mesme të kapitalit social mund të paraqiten pengesa për elitat e interesuara në nxitjen e bashkëpunimit mes grupeve, nivele shumë të larta mund të gjenerojnë një gadishmëri më të madhe mes udhëheqësve të grupeve të ndryshme dhe mes ndjekësve të tyre për të kapërcyer ndasitë shoqërore dhe për të bërë propozime që tejkalojnë kufijtë e grupit. Kështu, kapitali social mund ta bëjë demokracinë të funksionojë në shoqëritë e ndara duke bërë të mundur demokracinë konsociacionale.

III. Kapitali social si aset i rëndësishëm në jetën politike

Adler dhe Kwon (2000) argumentojnë se institucionet formale dhe rregullat të cilat ndihmojnë për të formuar strukturën e rrjetit dhe për të ndikuar në norma dhe besime, kanë një efekt të fortë mbi kapitalin social. Qeveritë transparente e të përgjegjshme ndaj nevojave të njerëzve janë një faktor kyç në krijimin e rregullave dhe institucioneve formale në qeveri. Levi (1996: 51) argumenton se "Qeveritë sigurojnë më shumë sesa thjesht lehtësimin e besimit mes qytetarëve; ato gjithashtu ndikojnë sjelljen qytetare në masën që nxit besimin ose mosbesimin ndaj vetvetes".

3.1 Institucionet, korrupsioni dhe kapitali social

Pse praktikat e padrejta, të korruptuara, joefikase dhe të njëanshme të makinerisë administrative të shtetit ndikojnë në prirjen e njerëzve për tu besuar ose jo të tjerëve në shoqëri? Lidhja shkakësore nuk është aspak e qartë, por gjenden (të paktën) dy përgjigje të mundshme për këtë çështje. Së pari, supozohet se në shoqëritë ku njerëzit nuk mund të kenë besim tek policia apo sistemi gjyqësor, qytetarët do ta kompensojnë duke rritur rrjetin e tyre të bazuar tek besimi. Në këtë mënyrë, Michael Woolcook shkruan se "korrupsioni i shfrenuar, vonesa frustruese burokratike, liritë e shtypura civile, dështimi për të mbrojtur të drejtat e pronësisë dhe respektimin e sundimit të ligjit, detyron komunitetet të kthehen përsëri mbrapsh tek vetja, duke kërkuar të furnizohen privatisht dhe jozyrtarisht me atë që do të duhej të dorëzohej publikisht dhe zyrtarisht "(Woolcook, 2001: 16). Della Porta, një studiues kryesor i korrupsionit, pohon se në mënyrë që të bëhen shkëmbime të korruptuara, duhet patur besim tek të tjerët të cilët janë të përfshirë në korrupsion.

Në një sistem shkëmbimi të paligjshëm, është e nevojshme një shkallë e lartë besimi dhe reciprociteti mes pjesëmarrësve, kështu që është i nevojshëm brendësimi i disa rregullave të lojës. Aktorët e përfshirë vlefësojnë shumë reputacionin e mirë për të respektuar kushtet e shkëmbimit të paligjshëm, të cilin pjesëmarrësit shpesh e quajnë "ndershmëri". (Della Porta, 2000: 223).

Megjithatë, lloji i besimit që mund të lulëzojë në komunitete të tilla është i veçantë dhe nuk mund të barazohet me besimin e përgjithshëm. Për shembull, rrjetet e vogla të dendura në ish-Gjermaninë Lindore karakterizoheshin nga nivele të larta të besimit në grup veçanërisht sepse në të vërtetë, ato ishin krijuar si mbrojtje kundër lidhjeve të dobëta dhe llojet e tjera të rrjeteve më të gjera (Volker dhe Flap, 2001). Shkalla e lartë e normës së konformitetit që Della Porta përshkruan midis atyre që janë të përfshirë në korrupsion mund të jetë bindëse, por është një lloj i veçantë i marrëdhënieve të besimit, që nuk mund të zbulohet në botën e jashtme. Për më tepër, njerëzit e përfshirë në korrupsion nuk duhet të kenë vërtetë besim te njëri-tjetri, sepse janë në një situatë "parandalimi të ndërsjellë", që do të thotë se të dyja palët do të humbisnin nëse shkëmbimi i korruptuar zbulohet. Parandalimi nuk është tamam njëlloj si besimi se tjetri nuk do të shkaktojë dëm. Bazuar në prova shumë interesante empirike, Varese argumenton se operacionet e brendshme të organizatave kriminale, si mafia, nuk janë të bazuara të gjitha në besim, por më tepër në frikë, dyshim dhe mosbesim të thellë (Varese, 2004).

Një sistem administrativ i njëanshëm, i padrejtë dhe i korruptuar në përgjithësi shkon dorë për dorë me nivele të ulëta të kapitalit social, veçanërisht kur matet si besim i përgjithësuar. Institucionet e ligjit dhe rendit kanë një detyrë veçanërisht të rëndësishme, pikërisht zbulimin dhe ndëshkimin e njerëzve të cilët janë "tradhtarë",

atyre që prishin kontratat, ofrojnë ose marrin rryshfet, angazhohen në operacione klienteliste, mashtrojnë, vjedhin dhe bëjnë gjëra të tjera jo-bashkëpunuese dhe për këtë arsye nuk u duhet besuar. Kështu, nëse qytetarët mendojnë se këto institucione të rendit bëjnë atë që supozohet të bëjnë në mënyrë të drejtë, efikase dhe të paanshme, atëherë kanë gjithashtu arsye për të besuar se mundësia që njerëzit që sillen në mënyrë të pabesë t'ja dalin pa u lagur është relativisht e vogël. Kështu, qytetarët besojnë se shumica e njerëzve kanë arsye të forta për të mos vepruar në mënyrë të pabesë dhe arrijnë në përfundimin se "mund të kesh besim tek shumica e njerëzve". Megjithatë, nuk është vetëm efikasiteti me të cilin sjellja e pabesë dënohet që ka rëndësi për besimin e përgjithësuar, por edhe kombinimi i efikasitetit dhe drejtësisë së institucioneve të rendit. Oficerët e policisë, burokratët e shërbimit social, gjykatësit dhe mësuesit e shkollave publike janë përfaqësues të popullit, si dhe ekspozues të vlerave të institucionalizuara. Me pak fjalë, sjelljet e tyre funksionojnë si sinjale të rëndësishme për qytetarët në lidhje me standartin moral të shoqërisë në të cilën jetojnë (Kydd, 2000; Delhey dhe Newton 2004).

Kjo teori mund të punojnë në mënyrë asimetrike, në kuptimin që me kalimin e kohës ndërtimi i institucioneve të ndershme dhe efikase mund të japë sukses të ngadalshëm dhe më pak të dukshëm se rënia e cilësisë institucionale. Për shkak se në përgjithësi besimi shkatërrohet më lehtë sesa fitohet, kjo asimetri pritet (Offe, 1999). Disa nga dimensionet e rëndësishme të institucioneve shtetërore janë të lidhura ngushtë me besimin e përgjithësuar. Më poshtë, paraqiten katër pjesë të ndryshme të këtij mekanizmi shkakësor ndërmjet karakteristikave institucionale dhe besimit të përgjithësuar. Nivele të ndryshme të efikasitetit institucional dhe drejtësisë:

1. Ndikojnë perceptimin e agjentit individual mbi sigurinë dhe mbrojtjen. Mungesa ose prania e frikës nga të tjerët padyshim do të ndikojë në besimin se "shumë njerëz" duhen ose nuk duhen besuar.

2. Përcaktojnë konkluzionin e agjentit individual në lidhje me ata që kanë përgjegjësinë për ruajtjen e interesit publik për pjesën tjetër të shoqërisë. Për shembull, në qoftë se nuk mund t'u kesh besim atyre që janë në pozita me përgjegjëshmëri, atëherë as "shumicës së njerëzve të tjerë" me siguri nuk mund t'u kesh besim.

3. U japin formë ndjekjes së sjelljes të bashkëqytetarëve. Mesazhi i sistemeve të korruptuara është që, për shembull, në mënyrë që të merrni atë për të cilën keni nevojë në jetë, duhet të jeni të angazhuar në forma të ndryshme të korrupsionit. Për këtë arsye, agjenti individual do të shohë përdorimin e korrupsionit në mesin e bashkëqytetarëve, dhe do të ndjehet i detyruar të angazhohet në praktika të korruptuara në mënyrë që të marrë atë që ai ose ajo e sheh të nevojshme. Megjithatë, nuk mund të ketë ndonjë besim të përgjithësuar tek ata individë të cilët vetëm përfitojnë nga të tjerët dhe sistemi.

4. Shkaktojnë përvoja pozitive apo negative me këto institucione, kur janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ta. Institucionet e korruptuara dhe të padrejta, për shembull, mund të çojnë në përvojat e diskriminimit dhe padrejtësisë, të cilat ndikojnë negativisht në besimin e përgjithësuar.

Shembujt e dhënë deri më tani e bëjnë të qartë se kapitali social është një input për procesin e zhvillimit së bashku me format e tjera të kapitalit. Megjithatë, është gjithashtu një output i këtij procesi, një tipar që e ndan nga kapitalin njerëzor. Arsimi duhet ndjekur, dhe një popullsi e arsimuar është një rezultat i rëndësishëm i zhvillimit të suksesshëm. Po kështu, shumë njerëz do të pajtoheshin me idenë se një rrjet i pasur i

shoqatave të qytetarëve dhe një grup institucionesh qeveritare që funksionojnë mirë janë të vlefshme, pavarësisht efektit të tyre në të ardhmen e rritjes ekonomike. Kapitali njerëzor dhe social ndajnë atributin që janë në të njëjtën kohë një konsum dhe një investim i mirë. Dallimi kritik është se arsimi mund të mishërohet tek një individ dhe mund të fitohet nga një individ, pavarësisht nga çfarë bëjnë njerëzit e tjerë. Sipas përkufizimit, kapitali social mund të fitohet vetëm nga një grup njerëzish dhe kërkon një formë bashkëpunimi mes tyre.

Kjo i jep kapitalit shoqëror një karakter të pashmangshëm si e mirë publike dhe ka implikime për prodhimin e tij (Coleman, 1988, 1990). Në mënyrë të veçantë, si të gjitha të mirat publike, do të priret të prodhohet pak në krahasim me optimalen shoqërore, vetëm nëse grupi përgjegjës për prodhimin e tij mund të përvetësojë eksternalitetet e përfshira. Kjo është arsyeja pse shoqatat horizontale, të karakterizuara nga ndarja e barabartë e energjisë mes anëtarëve, kanë tendencë të jenë më të suksesshme në gjenerimin e kapitalit social. Anëtarët kanë më shumë gjasa për të kontribuar, sepse ata kanë shanse më të mira për të marrë pjesën e tyre të përfitimit.

Është e qartë pra, në shumicën e rasteve prodhimi i kapitalit social ka kosto, që kërkojnë burime, e sidomos kohë. Për këtë arsye, sasia e kapitalit social që do të prodhohet është pjesërisht pjesë e kostos oportune të kohës dhe kthimit mbrapsht të pritur të kapitalit social (që është, shkalla në të cilën një agjent ekonomik do të gëzojë të mirën publike që është krijuar).

Përcaktimi i grupit më të përshtatshëm për prodhimin e kapitalit social varet kryesisht nga qëllimi dhe madhësia e grupit, e nevojshme për ta përvetësuar atë në mënyrë efektive dhe për të shmangur efektin "free riding": në rastin e ndonjë lloj sigurimi, grupi

është lokal; në rastin e sundimit të ligjit është kombëtar dhe qeveria qendrore duhet të luajë një rol të rëndësishëm. Megjithatë, si një eksternalitet, kapitali social mund të shërbejë si produkt i proceseve të tjera të prodhimit. Për shembull, nëse punëtorët në një fabrikë krijojnë shoqata për aktivitetet e kohës së lirë, gjë që nga ana tjetër ul krimin nëpër lagje, "kostoja" e bashkimit të njerëzve dhe zhvillimit të besimit përthithet në masë të madhe në procesin e prodhimit të fabrikës. Sigurisht, kostoja është më e vogël sesa do të ishte në qoftë se këto shoqata do të ishin krijuar nga njerëz që nuk njihen falë një pune të përbashkët.

Të krahasosh angazhimin nëpër shoqata është më e vështirë sesa duket. Ne mund t'i vlerësojmë më mirë këto vështirësi në rastin e sindikatave. Përqindja e sindikalizmit është me të vërtetë i vetmi informacion për të cilën është e mundur njohja e të dhënave me burime të tjera, në këtë rast statistikat (e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik).

Sipas burimeve, dallimet mund të jenë shumë më të mëdha, ndonjëherë edhe të dyfishuara. Këto dallime rezultojnë të vërteta në rastet e shërbimeve të oraganizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (ose më saktë, vendet që ofrojnë statistika) të cilët përcaktojnë emërues (të punësuarve) dhe numërues (anëtarësimin në këtë bashkimi). Ndërkohë që kufijtë e gabimit të qartë rrjedhin nga pasaktësitë e deklaratave të të anketuarve (tek lëshimet, gabimet, etj).

Shkalla e statizmit dhe faktorët e neglizhuar të kapitalit social

Le të kthehemi tek besimi. Si mund të shpjegojmë dallimet midis vendeve? Yann Algan dhe Pierre Cahuc sugjerojnë një hipotezë të guximshme nisur nga rasti francez: mosbesimi shpjegohet kryesisht nga shkalla e statizmit. Sipas tyre, zbatimi i shtetit të fortë pas Luftës së Dytë Botërore nxiti mosbesimin në Francë. Hipoteza është interesante, por vështirë të mbështetet nga të dhënat europiane, ku shpjegime të tjera janë konsideruar si vlerë. Për më tepër, ky reflektim do të zgjerohej duke marrë parasyh nëse, në analizën e kapitalit social, implikimet politike të besimit nuk kanë qenë të prirura të mbivlerësohen.

Nëse teza që kombinon kontrollin e shtetit dhe besimin është tërheqëse, është e qartë se ajo është provuar më tej nga rasti francez. Një kontroll minimal konsiston në krahasimin ndërkombëtar: Nëse teza është e saktë, duhet të vërejmë me kujdes këtë korrelacion domethënës ndërmjet rëndësisë së shtetit dhe nivelit të mosbesimit. Për të vlerësuar shkallën e statizmit, treguesi më i thjeshtë është pjesa e të ardhurave të qeverisë (taksat dhe kontributet) në produktin e brendshëm bruto (PBB). Rëndësia e kësaj mase është diskutuar, por ende mund të konsiderohet si pjesë e pasurisë

kombëtare që është imponuar nga administrata dhe një tregues i mirë i shkallës së kontrollit shtetëror të shoqërisë (Bourdieu, 1992).

Analiza tregon se nuk ka asnjë lidhje të qartë mes rëndësisë së shtetit dhe mosbesimit ndërpersonal. Korrelacioni funksionon më shumë në drejtim të kundërt me atë që është në fakt qëllimi, sepse koeficienti i korrelacionit është pozitiv (është i barabartë me 0.42). Thënë ndryshe, në qoftë se ekziston një marrëdhënie, ajo është më së shumti në kuptimin e një shoqate mes statizmit dhe besimit. Sa më i fortë të jetë shteti, aq më shumë njerëzit kanë besim tek njëri-tjetri. Shpjegimi përmes shkallës së kontrollit shtetëror është pak funksional, të paktën jo aq sa duhet dhe jo në drejtimin e pritur. Faktorë të tjerë janë më bindës. Konstatohet se ka një korrelacion negativ ndërmjet besimit dhe pasurisë. Pra shoqëritë më të barabarta duken më të favorshme për besim.

Këtu, korrelacioni është mjaft i lartë. Ai sigurisht që është larg absolute, por mbetet fakti se niveli i zhvillimit ekonomik të një vendi është një element i rëndësishëm i besimit. Në vetvete, shkalla e kontrollit shtetëror nuk mund të konsiderohet një faktor mosbesimi, kur ky i fundit lidhet në mënyrë të ngjashme me faktorët konvencionalë ekonomikë të tillë si pabarazia mes të ardhurave dhe nivelit të pasurisë.

Feja, si faktor i neglizhuar

Ekonomia nuk shpjegon gjithçka. Mund të supozohet se besimi ndërpersonal varet edhe nga faktorë të thellë kulturorë. Si argument në këtë kuptim mund të shërbejë fakti se besimi po ndryshon ngadalë me kalimin e kohës, gjë që tregon se ky dimension është shumë i ndjeshëm ndaj faktorëve ciklikë. Pastaj, vendet më të sigurta duket të jenë ato ku mbizotëron besimi protestant.

A bën pjesë feja tek faktorët shpjegues? Kjo hipotezë, sugjeruar tashmë nga autorë të tjerë, është konfirmuar nga të dhënat. Kjo ndodh në të vërtetë në vendet e traditës protestante ku besimi është më i lartë, edhe pse ka përjashtime (p.sh. Irlanda); vendet më të sigurta janë edhe ato që kanë fituar ndaj shekullarizimit (përqindja e jofetarëve është zakonisht e lartë), ndoshta për shkak se ata kanë qenë popujt më të hershëm që janë dalluar për tolerancën fetare. Nga ana tjetër, vendet ku besimi është i ulët janë ato ku feja myslimane dhe ortodokse janë dominuese dhe ku laicizmi është pak i zhvilluar (Bourdieu et al., 1983).

Vendet me një besim mesatar janë zakonisht ato që i përkasin besimit katolik. Të dhënat gjithashtu tregojnë efektin e kontekstit duke shtuar se besimtarët katolikë e zhvillojnë më tej besimin ndërpersonal, ndërsa në vendet ku mbizotëron besimi protestant ose në vendet me besim ortodoks, kultura lokale duket se ka një efekt imponues në ndjeshmërinë fetare të individëve. Një analizë e tillë meriton të thellohet edhe më tej për shkak se natyra e ndikimit të fesë duhet të verifikohet dhe të shpjegohet në detaje . Madje ky faktor, faktori fetar, përbën sfondin që ka shenjuar prej një kohe të gjatë këtë proces. Në këtë mënyrë, s'mund të ketë lidhje logjike mes të paturit besim dhe pjesëmarrjes nëpër shoqata, pra që pjesëmarrja asociative rritet me nivelin ndërpersonal të besimit.

Pyetja është nëse ky korrelacion duhet të analizohet në aspektin e shkakësisë, siç e sugjeron shpesh literatura akademike (besimi ndërpersonal nxit angazhimin), ose në qoftë se këto dy dimensionet janë thjesht e njëjta pasojë e kulturave të lëna trashëgim nga feja.

Besimi ndërpersonal dhe ai politik

Analizat që janë bërë mbi kapitalin social konsiderojnë se ekziston një lidhje e ngushtë mes besimit ndërpersonal dhe atij politik. Natyra e kësaj marrëdhënie mund të konsiderohet në dy drejtime. Nga njëra anë, besimi ndërpersonal është konsideruar si një parakusht për besimin politik dhe do të nxisë mbështetjen për demokracinë (besim se të tjerët janë të detyruar të pranojnë një regjim demokratik), nga ana tjetër institucionet nxisin besimin ndërpersonal meqenëse ato ftojnë njerëzit të punojnë së bashku. Vihet re, gjithsesi, se në çështjet e besimit, kalimi mes nivelit ndërpersonal dhe në nivel politik nuk është i qartë, gjë e cila çon në relativizimin e ndikimit politik nga besimi ndërpersonal.

Besimi tek politika

Për të matur besimin politik, ne mund të përdorim dy grupe treguesish. I pari lidhet me demokracinë dhe përfshin dy pyetje, njëra për sa i përket demokracisë në përgjithësi: "Demokracia mund të shkaktojë probleme, por është më e mirë se çdo formë tjetër e qeverisë? Tjetra çon në mohimin e pushtetit personal: "A do të ishte një gjë e mirë që në krye të vendit të vendoset një njeri i fortë që nuk ka pse të shqetësohet as për Parlamentin e as për zgjedhje"? Rezultatet tregojnë se demokracia mbështetet në mënyra të ndryshme në Europë. Në shumë vende, veçanërisht në Europën Lindore, angazhimi në demokraci është më i cekët dhe perspektiva e të pasurit një pushtet autoritar personal çon në një anëtarësim jo krejtësisht të neglizhueshëm. Nëse të dy treguesit janë të lidhur logjikisht mjaft mirë, ka disa përjashtime si (në Kosovë, Luksemburg, Gjeorgji, Turqi), gjë e cila na orienton të pyesim nëse kultura demokratike në disa vende merr karakter sipërfaqësor. Grupi i dytë i treguesve lidhet me besimin në institucione. Një rezultat interesant është se institucionet e mëdha të

demokracisë (partitë politike, qeveria, shtypi, parlamenti) nxisin mesatarisht ose më pak besimin se sa institucionet që mishërojnë rendin si (ushtria, policia).

Kapitali social dhe besimi politik: një lidhje e vërtetë, por e kufizuar

A ka lidhje logjike ndërmjet besimit ndërpersonal dhe besimi politik? Nëse do të shikonim rezultatet në nivel individual, korrelacionet ekzistojnë: në shumicën e vendeve, sa më i lartë të jetë besimi te të tjerët, aq më shumë tendencë kanë njerëzit t'u besojnë institucioneve dhe demokracisë. Megjithatë, koeficientët janë në përgjithësi të ulët (ato janë edhe zero në disa vende si Greqia dhe Rumania). Për më tepër, korrelacionet nuk janë shumë bindëse në nivelin agregat. Nëse për shembull shqyrtojmë lidhjen mes besimit ndërpersonal dhe angazhimit për demokracinë, shohim se ekziston një konvergjencë e lehtë. Sa më i lartë të jetë besimi tek njëri-tjetri në një vend të caktuar, aq më shumë ky vend ka mundësi për të mbështetur demokracinë dhe të jetë armik i pushtetit autoritar. Por tendenca nuk është krejtësisht e qartë (Bourdieu, 1994).

Për të njëjtin nivel të besimit ndërpersonal, mund të gjejmë nivele shumë të ndryshme të besimit politik, dhe anasjelltas. Atë që e konstatojmë në nivel individual e gjejmë gjithashtu edhe në nivel kolektiv. Niveli i lartë i besimit ndërpersonal në një vend nuk do të thotë domosdoshmërisht se besimi politik nuk do të jetë më i fortë. Mendimi se besimi në demokraci është i rrënjosur mekanikisht në besimin ndërpersonal, ose se besimi politik promovon mekanikisht besimin ndërpersonal, nuk është plotësisht i saktë. Ne mund ta ilustrojmë këtë analizë me një shembull shumë konkret: sindikatat. Është bërë i zakonit shpjegimi i rënies së sindikatave për shkak të "krizës së besimit". Por nëse krahasojmë shkallën e sindikalizmit me besimin në sindikata, ne shohim se në qoftë se ekziston korrelacioni, ky i fundit është i nxitur në disa raste të veçanta.

Me pak fjalë, niveli i besimit ose mosbesimit shfaqet si një variabël e një shkalle të ulët të sindikalizimit dhe kjo duket e përshtatshme për të dhënë shpjegime për të kuptuar dallimet mes shteteve. Mendojmë po ashtu për funksionin që kryejnë sindikatat në çdo vend, funksion që rrjedh nga historia kombëtare e luftërave sociale dhe rregullimeve institucionale. Ndonëse besimi mes individëve është sigurisht një aspekt i rëndësishëm i jetës së komunitetit, kjo nuk do të thotë se ai është çelësi për të kuptuar shoqëritë dhe evolucionin e tyre. Për më tepër, në kundërshtim me diskutimet alarmuese nuk ka asnjë provë që na lejon të themi se ka një rënie të përhapur të shoqërizimit edhe në raport me të tjerët.

3.5.2 Tranzicioni post-komunist në Europën Qëndrore dhe Lindore

Procesi i tranzicionit në Europën Qëndrore dhe Lindore (EQL) pati një efekt të thellë në mënyrën sesi individët bashkëveprojnë. Institucionet ekonomike dhe sociale ndryshuan, gjë që u kërkon individëve të përshtaten duke lëvizur drejt ekonomisë së tregut. Përdorimi i kapitalit social prej tyre varet nga mënyra sesi çdo individ futet, manipulon dhe përdor rrjetet sociale. Niveli i pritshëm i kapitalit social që egziston brenda vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore është i ulët. Rrjetet sociale dhe përdorimi i këtyre rrjeteve (dhe i kapitalit social) po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme nën qëllimin e anëtarësimit në BE, veçanërisht kur mundësitë brenda vendit dhe aksesit tek programet e zhvillimit rural dhe rajonal janë të varura nga rrjetet ekzistuese. Kapitali social shihet si një entitet dinamik, një formë e ndryshimeve institucionale që sjell risi në qeverisje.

Kështu, kapitali social ofron një mjet të fuqishëm për shpjegimin e proceseve e ndryshimeve institucionale. Në Europën Qëndrore dhe Lindore (EQL), proceset e ndryshimeve institucionale kanë ardhur si rezultat i goditjeve të jashtme, të imponuara nga regjimet politike dhe ndryshimet e papritura të regjimit gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit. Regjimet socialiste dhe ekonomitë e planifikuara nga qendra ndryshuan strukturën shoqërore të EQL, si pasojë edhe llojet e veçanta të sjelljeve mes individëve. Më i rëndësishmi, ishte efekti mbi besimin ndërpersonal, që çoi në modele besimi mjaft komplekse (në të dy nivelet, qoftë të lartë dhe të ulët) ndërmjet individëve dhe grupeve të individëve. Si teoritë ekonomike, ashtu edhe ato sociologjike, njohin rëndësinë e ndihmës institucionale ndaj personave, dhe një pjesë e kësaj ndihme fillon me lidhjet sociale ose komunitete e shoqata të ndryshme. Kjo është ajo që është quajtur kapital social, dhe ka të bëjë me masën në të cilën individët përfitojnë nga rrjetet e tyre personale dhe shoqatat e komunitetit (Bourdieu, 1986). Konteksti social është i rëndësishëm për të kuptuar procesin e bashkëpunimit në Europën Qëndrore dhe Lindore, pasi ndërveprimet midis njerëzve janë ndikuar më tej gjatë pesëmbëdhjetë-njëzet viteve të fundit nga demokratizimi i sferës politike dhe procesi i tranzicionit nga një ekonomi e planifikuar në një ekonomi të orientuar drejt tregut të lirë. Ndryshimi i institucioneve formale, veçanërisht ndryshimet në legjislacionin në lidhje me të drejtat e pronësisë dhe shkëmbimin e tregut, kushtëzuan dhe ndikuan edhe institucionet joformale.

Kapitali social është një term relativisht i panjohur në studimet dhe kërkimet e kryera në Europën Qëndrore dhe Lindore (EQL). Interesi për këtë temë ka lindur kryesisht nga aktivitetet e agjensive të zhvillimit, të tilla si Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara edhe programet e Bankës Botërore. Pjesa më e madhe e hulumtimit të

kapitalit social të botuar në gjuhën angleze është e lidhur disi me nismat praktike të zhvillimit, veçanërisht pas vitit 1996, pasi Banka Botërore shpalli se kapitali social mund të jetë "elementi që mungon në zhvillim." Për këtë arsye, pjesa më e madhe e hulumtimit të kapitalit social në EQL mund të konsiderohet si një dimension politik i strategjive të ndryshme zhvillimore në rajon. Nismat e Bankës Botërore kanë dhënë padyshim një stimul të rëndësishëm për interesin mbi këtë temë. Banka ka organizuar disa seminare mbi kapitalin social, për shembull në Kroaci, Rumani, Bullgari dhe Shqipëri. Autorët kryesorë, akademikë dhe praktikues kanë marrë pjesë në mënyrë që të ndihmojnë në trajnimin e pjesëmarrësve lokalë për përdorimin e konceptit dhe të kryejnë kërkime efektive. Disa autorë që e kanë pasur objekt studimi prej kohësh rajonin, tani shtojnë edhe kapitalin social në sfondin e përvojës së tyre të gjerë në Europën Qendrore dhe Lindore. Në tërësi, ata tentojnë të kritikojnë supozimet e ndryshme të bëra në lidhje me kapitalin social dhe konstatimet që mesa duket janë të pajustificueshme duke pasur parasysh metodologjitë e hulumtimit (për shembull Adam dhe Ronçeviç 2002).

Në Europën Qendrore dhe Lindore, proceset e ndryshimeve institucionale kanë rezultuar nga goditje të jashtme, të vendosura nga regjimet politike dhe ndryshimet e papritura të regjimit gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit. Regjimet socialiste dhe ekonomitë e planifikuara e të centralizuara kanë ndryshuar strukturën shoqërore të këtyre vendeve dhe kanë prodhuar lloje të veçanta të sjelljes ndërmjet individëve. Duke pasur parasysh se modelet e shoqërisë dhe rrjeteve ndërpersonale dhe sociale kanë qenë të ndikuara nga ndryshimi i regjimeve politike në EQL, roli i kapitalit social si një faktor shpjegues për sjelljen ekonomike dhe sociale është i ndryshëm nga vendet e tjera që nuk kanë përjetuar një fazë socialiste, me planifikimin e tij qendror dhe kontrollin

mbi strukturat sociale.Me pranimin në BE të dhjetë prej shteteve të EQL-së, në vitin 2004, janë përjetuar ndryshime të mëtejshme, që kërkojnë përshtatjen me "acquis communautaire" të BE-së.

Në mënyrë të veçantë, tre teori ,kritika i ka parë si të rëndësishme për Europën Qëndrore dhe Lindore, në bazë të: a) teorisë së zgjedhjes racionale; b) teorisë së angazhimit qytetar dhe aktivitetit vullnetar; dhe c) teorisë së rrjetit.. Interpretimi i kapitalit social, si rrjete të bashkëpunimit, që varen nga besimi dhe reciprociteti është mbrojtur nga Ostrom(2000) dhe konsiderohet si më i përshtatshmi për të eksploruar proceset shoqërore në EQL.

Në kuadër të teorisë së parë, kapitali social ka fituar besueshmëri në ekonomi për faktin se përcjell idetë që patën humbur në mendimin neoklasik mbi ekonominë. Ai ofron një argument kundër idesë se të drejtat pronësore të përcaktuara mirë dhe tregjet konkurruese mund të shfrytëzohen me sukses nga motivime egoiste (individualiste) për qëllime publike, duke e bërë kështu virtytin qytetar të panevojshëm. Kjo pikë e fundit duhet të kihet parasysh në çdo analizë të ekonomive në tranzicion, ku ka pasur një rregullim të regjimit të së drejtës pronësore, me një prirje drejt privatizimit të drejtave. Kapitali social është i rëndësishëm për të kapërcyer dështimet e caktuara të tregut në sigurimin e të mirave publike lokale dhe shumë lloje të sigurimit.Qasja e zgjedhjes racionale është bazuar në strategjitë e përdorura nga individët për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin, duke u varur nga besimi i llogaritur prej këtij bashkëveprimi.Qasja mbi rrjetet është një qasje më sociologjike e kapitalit social, që afirmon rëndësinë e ngulitjes dhe lejon një diskutim të strukturave të pushtetit brenda shoqërisë.

Qasja e shoqërive civile shtrihet diku ndërmjet këtyre dy qasjeve, pasi është përdorur koncepti i besimit (si ai ndërpersonal dhe ai formal dhe po ashtu besimi institucional), si edhe lidhja e individëve me arenat e tyre sociale. Marrëdhëniet sociale ndërmjet individëve janë të rëndësishme, sepse lejojnë akses në burime dhe gjithashtu ndikojnë në qeverisjen e tyre. Dimensioni strukturor i kapitalit social është identifikuar gjërësisht në literaturë. Struktura ka të bëjë me pozicionin në një rrjet, dhe ndikon në qasjen e individëve të tjerë dhe në fund të fundit ndikon në kushtet e përdorimit të kapitalit social (Hazleton dhe Keenan, 2000). Megjithatë, edhe pse njerëzit kanë lindur dhe janë shoqërizuar në një rrjet shoqëror ekzistues, në realitet çdo individ ka në dorë zgjedhjen për të ndryshuar ose modifikuar rrjetet e tij. Integrimi i këtyre tri përkufizimeve të kapitalit social integron dhe formulimin e konceptit ndërmjet themeleve të ndryshme sociologjike dhe ekonomike në afat të caktuar (Mateju, 2002; Mihajlova, 2004a) dhe kjo lejon një analizë në bazë të zgjedhjes racionale duke përfshirë vlerësimin dhe strukturat e pushtetit dhe ato shoqërore të cilat çojnë në riprodhim shoqëror dhe pabarazi.

Raiser et al. (2001) supozon se ekziston një nivel i ulët i kapitalit social në Europën Lindore në krahasim me vendet perëndimore, pavarësisht potencialit të madh njerëzor (një numër i madh, i mirëarsimuar dhe i kualifikuar njerëzish) në EQL. Autorët argumentojnë se ka qenë më lehtë për të ndërtuar shoqëri civile në ato vende që gjeografikisht janë më afër me Europën Perëndimore dhe se kjo afërsi e ka mbështetur procesin e tranzicionit. Një nga rekomandimet politike që ata bëjnë është që të mbahet gjallë miti i kthimit në Europë për të ndihmuar në ndërtimin e kapitalit social në vendet e tjera (Raiser et al., 2001: 22). Një logjikë e ngjashme, edhe pse në një situatë tërësisht të ndryshme, ndjek edhe Petro (2001).

Ekzistojnë nivele komplekse dhe të ndryshme të modeleve të besimit në zhvillim në Europën Qëndrore dhe Lindore, dhe një nivel i ulët i besimit në një sferë kompensohet nga nivelet e larta të besimit në të tjerat. Përveç rëndësisë së besimit në marrëdhëniet sociale dhe në ndërveprime (informale), besimi është njohur si bazë për kontratat tregtare dhe marrëveshjet mes njerëzve. Pritjet e zyrtarizimit të niveleve të besimit në tregje mund të shihen si një "hap drejt besimit" për shumë individë, se si ata lëvizin nga rrjetet relativisht të mbyllura të besimit (të tilla si familja dhe miqtë) në nivele të besimit më të hapur e më të përgjithshëm të të huajve me të cilët ata ndërveprojnë (Cook et al, 2004) duke pasur parasysh se përvojat në kohët e mëparshme socialiste çuan në një klimë të frikës dhe mosbesimit ndaj shtetit dhe aparaturës së tij për shumë individë.

Në një studim të ndërmarrjeve të vogla dhe firmave private në 26 vende në tranzicion, Raiser dhe autorë të tjerë (2004) ekzaminuan besimin e përgjithshëm në transaksionet e biznesit, bazuar në mjedisin kontraktues brenda këtyre vendeve. Ata panë se besimi rrit reformat dhe sjell përparim brenda vendeve. Në të vërtetë ideja e progresit ekonomik mund të shihet si një largim nga mbështetja (besimi) në rrjetet familjare dhe joformale të besimit të përgjithshëm. Megjithatë, besimi i lartë informal tek familja dhe tek miqtë e ngushtë është një mekanizëm i njohur për shumë njerëz gjatë kohës së socializmit, dhe mekanizma të tillë nuk do të zhduken thjesht me ndryshimet në regjimet politike dhe ekonomike.

3.5.3 Kapitali social dhe trashëgimia socialiste

Për të shpjeguar situatën aktuale, shumica e studimeve mbi kapitalin social në Europën Qëndrore dhe Lindore fillon me një përshkrim të kapitalit social gjatë socializmit. Rose (1999) nënvizon ekzistencën e rrjeteve të kapitalit social gjatë socializmit. Në të njëjtën

kohë, ai argumenton se ishte ekonomia paramoderne në të cilën mallrat dhe shërbimet prodhoheshin në familje, si edhe rrjetet joformale dhe familjet që kërkonin t'i izolonin ata nga shteti. Autori beson se kjo mund të jetë një karakteristikë e rrallë në Perëndim, por shumë e arsyeshme dhe e zakonshme në BRSS. Ai përshkruan një teori shoqërizimi sipas së cilës të gjithë individët që u rritën gjatë periudhës së socializmit, sot janë pajisur me një kapital shoqëror antimodern. Problemi nuk është se nuk ka pasur kapital shoqëror, por se ka pasur një lloj të veçantë të kapitalit social. Mishler dhe Rose (1995) shqyrtojnë se si trashëgimitë socialiste veprojnë në lidhje me besimin, mosbesimin dhe skepticizmin dhe mbrojnë tezën se trashëgimia e socializmit ka pak ose aspak ndikim të drejtpërdrejtë tek besimi në institucionet bashkëkohore, por megjithatë, ka ndikim të drejtpërdrejtë përmes perceptimeve individuale të lirisë sot në krahasim me të kaluarën.

Antropologjia e shoqërive socialiste jep një përshkrim të detajuar se si socializmi ka vepruar në praktikën e përditshme. Buckowski (1996) për shembull, argumenton se ka pasur shoqata qytetare gjatë socializmit (shih gjithashtu Hann 1990; Hann dhe Dunn 1996; Burawoy dhe Verdery 1999). Një grup tjetër autorësh e përkufizojnë kapitalin social lidhur me pjesëmarrjen qytetare, normat apo besimin në përgjithësi (në krahasim me besimin mes individëve). Ata përshkruajnë një tabllë të socializmit si një sistem që praktikisht e shkatërroi këtë lloj kapitali social duke i lënë shoqëritë në tranzicion për t'u përballur me ndryshimet praktikisht pa kapital social të mbetur. Në këto kushte, detyrimisht një nga qëllimet kryesore të tranzicionit është fillimi i ndërtimit të kapitalit social. Nichols (1996) argumenton se tek socializmi mund të gjenden shkaqet që shpjegojnë procesin e ndalur të demokratizimit në shoqëritë e sotme post-komuniste (Nichols, 1996: 631). Ai beson se sistemi sovjetik e ka shkatërruar kapitalin social dhe rrjetin e gjerë vullnetar të angazhimit social që ushqen besimin, reciprocitetin dhe "të

qenët i shoqërueshëm në mënyrë spontane", të gjitha elemente që të çojnë tek shoqatat publike dhe, nga ana tjetër, demokracia. Për Nichols është "e qartë "se rrjetet qytetare u shkatërruan dhe ndërveprimi spontan mes qytetarëve u zëvendësua nga shoqatat e detyruara''. Seligman (1992) gjithashtu thekson rolin e rëndësishëm të socializmit në krijimin e mosbesimit dhe cinizmit. Kideckel (1998), Raiser (1999) dhe Lovell (2001) janë mbrojtës të tezës se socializmi la pas një trashëgimi mosbesimi, e cila shpjegon gjendjen e sotme të këtyre shoqërive.

Angazhimi

Theksi mbi angazhimin qytetar të aktorëve ka dominuar studimet mbi kapitalin social, pjesërisht për shkak se zhvillimi i një treguesi për matjen e tij empirike, siç ishte teza e Putnam (Putnam, 1993) dhe pranimi se angazhimi qytetar është thelbësor për sjellje bashkëpunuese. Një komunitet civil shënjohej nga 1) pjesëmarrja aktive në çështjet publike; 2) barazia politike; 3) solidariteti, besimi dhe toleranca; dhe 4) anëtarësimi i përhapur në shoqata vullnetare (Kunioka & Woller, 1999). Brenda EQL-së, aftësia për të marrë pjesë në çështjet publike dhe barazia politike është njohur vetëm gjatë 15 viteve të fundit. Gjatë kohës së socializmit, politika autoritare dominoi aktivitetin ekonomik dhe u përpoq të kontrollonte aktivitetet në sferën sociale. Megjithatë, do të ishte mire të merrej në shqyrtim shkalla e pjesëmarrjes efektive dhe kapitali kuptimplotë demokratik në çdo vend, përveç pjesëmarrjes në qendrat e votimit gjatë zgjedhjeve. Bazuar në studimet e fundit në EQL, është provuar se qytetarët mbështesin regjimet e reja demokratike, dhe në përgjithësi preferojnë ato që zëvendësuan regjimet komuniste (Mishler & Rose, 1997).

Megjithatë, kjo nuk garanton pjesëmarrjen e menjëhershme aktive në çështjet qytetare nga ana e qytetarëve. Nga një studim mbi besimin në Europën post-komuniste të

ndërmarrë nga Miller (1998), u konstatua se niveli i ulët i besimit mbizotëronte në institucionet e reja politike të demokracisë. Në mënyrë të veçantë ka pasur mosbesim dhe cinizëm për politikanët. Përkundrazi, besimi "tek njerëzit e zakonshëm ishte i lartë dhe uniform në të gjithë shumicën e vendeve në kuadër të anketës, por sërish dhe kjo e dhënë, nuk do të siguronte nivele të larta të angazhimit qytetar në mënyrë sistematike.

Nga të gjithë komponentët në tezën e Putnam-it mbi kapitalin social, vëmendje e veçantë është treguar për matjen e pjesëmarrjes në organizata vullnetare në EQL. Kjo nuk mohon faktin se përmes këtij procesi janë mësuar normat dhe të përbashkëtat mes aktorëve dhe komuniteteve. Këto përfshijnë solidaritetin, besimin dhe tolerancën, të cilat forcohen përmes përvojave të përsëritura të ndërveprimit social. Megjithatë, me nivele më të ulëta të të ardhurave në EQL, kostoja oportune e kohës mund të jetë shumë e madhe për ta shpenzuar në aktivitete të komunitetit, ose aktivitete shoqërore, ose njerëzit thjesht mund të mos kenë mundësi që të angazhohen në aktivitete të caktuara shoqërore që konsiderohen si 'të favorshme' për kapitalin social, për shembull ata mund të përfshihen në organizata bamirësie apo klube sportive. Prandaj nga pikëpamja metodologjike, duhet të bëhen përpjekje për të sqaruar treguesit më të dallueshëm ku rrjetet joformale të komuniteteve rrisin altruizmin dhe besimin, i cili është tërheqja kryesore e qasjes mbi rrjetet për kapitalin social.

Besimi

Besimi, si sinonim i kapitalit shoqëror, është bërë një nga temat qendrore të studimeve në ndryshimet institucionale dhe veçanërisht ndërveprimi ndërmjet institucioneve formale dhe informale në Europën Qendrore dhe Lindore. Një nga pikat fillestare është se besimi në institucione në EQL është i ulët. Shumë autorë argumentojnë (edhe pse

disa shpesh nuk paraqesin prova specifike) se socializmi shkatërroi shumicën e llojeve të besimit: qoftë atë ndërpersonal, ose atë të zgjeruar, ose të dy, dhe se kurset e mëparshme të historisë (që i dhanë formë kulturës) në rajonin e EQL kontribuan në nivelet e ulëta të besimit bashkëkohor (Holland, 1998). Disa autorë kundërshtojnë me pretendimin se nuk është mosbesimi, por skepticizmi ai që dominon tranzicionin (Mishler dhe Rose, 1995). Kolankiewicz argumenton se nivelet e besimit në shoqëritë në tranzicionin postsocialist janë në të vërtetë të lartë. Sipas tij ato ofrojnë një element parashikueshmërie, i cili nuk ofrohej në sistemin ku shpesh mungonte racionaliteti formal (1996: 447). Mateju (2002: 7) nuk pajtohet dhe argumenton se tranzicioni postsocialist karakterizohet nga besimi i ulët. Në tërësi, shumica e autorëve tentojnë të bien dakord se ka një mungesë të besueshmërisë tek shteti dhe një besim të kufizuar tek institucionet. Kjo situatë konsiderohet si një nga problemet më të spikatura në Europën Qëndrore dhe Lindore. Disa nga debatet përqëndrohen kryesisht në prodhimin e besimit dhe marrin në shqyrtim nëse ndryshimi institucional prodhon besimin, apo ai vetë është produkt i besimit. Sic është trajtuar edhe në kapitujt e mëparshëm, një nga përfitimet ekonomike të besimit ul kostot e transaksionit. Në politikë ai shihet si një burim legjitimiteti dhe veprimi kolektiv (Stulhofer, 2001: 27). Edhe pse ka një marrëveshje të përhapur se besimi është i rëndësishëm, ka më pak konsensus për llojin e besimit (besimi ndërpersonal, besimi te institucionet, apo besimi i përgjithshëm) që është vendimtar në krijimin e institucioneve demokratike dhe të ekonomisë së tregut. Shpesh, përkufizimet e besimit kombinojnë ide të ndryshme, koncepte ose praktika sociale si "motivet", "besimet", "dispozitat", "rrethanat", "interesat," dhe "pushteti" (cf. Dasgupta, 1988; Gambetta, 1988; Harris, 2003; Harriss dhe Mihajlova 2003; cituar në Mihajlova, 2004).

Shumë studiues argumentojnë se nivelet e pjesëmarrjes qytetare në Europën Qëndrore dhe Lindore janë dukshëm më të ulëta se në demokracitë perëndimore. Për këtë fajësohet zakonisht e kaluara socialiste ose një kombinim i saj dhe i mjedisit bashkëkohor socio-ekonomik dhe politik. Disa studiues ofrojnë analiza më komplekse të ndikimit që e kaluara ka në të tashmen (Buckowski, 1996; Spulbeck, 1996; Anderson, 1996). Megjithatë, një grup tjetër autorësh merr në konsideratë edhe mungesën e efektshmërisë shtetërore bashkëkohore si shpjegim kryesor për nivel të ulët të pjesëmarrjes qytetare (Alapuro, 2001). Ky përqëndrim tek pjesëmarrja qytetare ka çuar në një shqyrtim të shoqatave vullnetare (ose formave të angazhimit qytetar) si forma të kapitalit social. Marrëdhëniet mes OJQ-ve dhe qeverive lokale dhe qendrore kanë qenë një çështje e rëndësishme në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, mund të thuhet se ka një mungesë të dallueshme përpjekjesh (me disa përjashtime) në të kuptuarit se pse organizatat vullnetare mund të jenë më të pakta në numër në Europën Qëndrore dhe Lindore se në demokracitë perëndimore. Në kundërshtim me Putnam apo sugjerimet e Nichols, anëtarësimi në organizata vullnetare nuk funksionon si treguesi kryesor i një sistemi të vërtetë demokratik. Autori argumenton se, për shkak se anëtarësimi në shoqata dhe rezervat e kapitalit social nuk ishin të lidhur me njëra-tjetrën para vitit 1989, nuk kanë ushtruar shumë ndikim gjatë procesit të tranzicionit (Alapuro, 2001:11). Edhe pse rezervat e kapitalit social kanë qenë me rëndësi të madhe për suksesin e reformave politike dhe ekonomike, nivelet aktuale të angazhimit qytetar nuk reflektojnë tamam rezultatet e tyre. Çdo kuptim i demokratizimit në Europën Qëndrore dhe Lindore duhet të marrë në konsideratë rrethanat specifike të rajonit ose vendit. Në këtë mënyrë, qasja e Putnamit mbi kapitalin social dhe lidhjen e tij me legjitimitetin demokratik nuk

mund të përdoret në Europën Qëndrore dhe Lindore në të njëjtën formë sic u përdor në Itali.

Kjo shumëllojshmëri e kuptimeve të kapitalit social është kryesisht rezultat i qasjeve të ndryshme disiplinore. Është e habitshme se sa pak komunikim ndërdisiplinor ka dhe si rezultat shumë mundësi për keqkonceptime, për shembull, mbi mënyrën sesi socializmi shihet në aspektin e trashëgimisë së tij. Në mënyrë të ngjashme, është e një rëndësie jetike edhe të marrim në konsideratë aplikimet praktike të hulumtimit të kapitalit social. Shpesh, hulumtimi shërben për të legjitimuar një linjë politikash në kurriz të të tjerave: për shembull, hulumtimet mbi rrjetet sociale dhe shëndetësore (Rose, 2001) tentojnë të argumentojnë se si politikat neoliberale mund të jenë më pak problematike për popullsinë në jetën e tyre të përditshme.

Ndryshimet institucionale

Ndryshimi institucional në EQL është studiuar kryesisht nga një perspektivë makro-sociale dhe strukturore. Ai ka mbetur një shqetësim kryesisht i ekonomistëve dhe sociologëve dhe është vendosur në funksion të dy sferave kryesore: së pari, ekonomisë së tregut dhe transformimeve të institucioneve ekonomike dhe, së dyti, ndërtimit të demokracisë dhe transformimit të institucioneve politike. Hulumtimi i marrëdhënieve midis institucioneve formale dhe informale në shoqëritë në tranzicion përshkon këto dy fusha. Me rëndësi gjithashtu është edhe roli i shumëfishtë që institucionet jozyrtare kanë në shoqëritë postkomuniste për sa i përket demokracisë dhe ndërtimit të ekonomisë së tregut, për të cilin kapitali social shndërrohet në një mjet të rëndësishëm hetimi.

Hulumtimi sociologjik në lidhje me teorinë e kapitalit ndahet kryesisht në dy kategori: procesin e shpërndarjes ("kush merr çfarë") dhe mekanizmat institucionale ("si ndryshojnë rregullat") (Rona-Tas, 1998: 108). Këto kategori përfshijnë studime mbi rezultatet e ndryshimeve institucionale dhe ndryshimet e vetë institucioneve. E para ka të bëjë me grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të individëve (përmes anketave), ndërsa e dyta heton institucionet në nivel të mesëm dhe makro zakonisht me anë të studimeve të thella të rasteve (Rona-Tas, 1998: 109). Dialogu mes dy qasjeve bëhet i mundur nga koncepti i kapitalit, që është bërë një koncept qëndror në studimet e shtresëzimit. Institucionet përcaktojnë dobinë e kapitalit dhe vendosin rregulla për zbatimin e tij. Kështu, ato influencojnë vlerën e tij dhe vendosin se si mund të përdoret gjerësisht.

Teoritë sociologjike shpesh kanë dalluar kufizime (qoftë materiale, qoftë simbolike) në veprimin shoqëror që kanë evoluar nga e kaluara, kurse hulumtimi ekonomik, nga ana tjetër e konsideron veprimin social, si një seri zgjedhjesh të bëra nga individë racionalë, bazuar në pritjet e tyre në lidhje me shpërblimet dhe ndëshkimet (Rona-Tas, 1998: 130). Ndërkohë që sociologët rekomandojnë politika të buta liberale dhe nganjëherë theksojnë rëndësinë e shtetit, ekonomistët zakonisht argumentojnë për tregjet vetë-rregulluese dhe ndërhyrjen sa më të pakët të shtetit (Rona-Tas, 1998: 130). Antropologët theksojnë rëndësinë e institucioneve dhe kulturës informale në proceset ekonomike dhe politike të Europës Qendrore dhe Lindore. Ata shpesh argumentojnë për zbatimin e politikave të zhvillimit nisur nga specifikat e kontekstit, të cilat mund edhe të qëndrojnë kundër modeleve perëndimore të marrëdhënieve mes shtetit, tregut dhe shoqërisë (Hann, 2002; cituar në Mihaylova 2004). Mungesa relative e dialogut mes këtyre tri disiplinave mund të tejkalohet përmes debateve mbi kapitalin social dhe procesin e ndryshimeve

institucionale. Pavarësisht nga pretendimet se ndryshimet institucionale ka qenë të dokumentuara mirë (Rona-Tas, 1998: 117) shumë pyetje mbeten të pazgjidhura, në veçanti ato në lidhje me mekanizmat e bashkëveprimit mes kapitalit politik, ekonomik dhe social. Që të dyja, sociologjia dhe ekonomia kanë prodhuar argumente kundërshtuese për këtë temë, ndërsa antropologjia, përveç disa rezultateve premtuese në zona të kufizuara tematike dhe gjeografike, ka dhënë një kontribut më modest (Hann, 2002). Sandu (1999) trajton problemet e institucioneve dhe konvertimet midis kapitalit social, kulturor, politik, njerëzor dhe ekonomik. Ai sugjeron se kapitali social i referohet aksesit në strukturat e jetës shoqërore. Ai argumenton se, duke qenë një kapital që buron nga marrëdhëniet, kapitali social ka potencialin të kthehet në material, njerëzor, simbolik ose lloje të tjera kapitali. Megjithatë nuk mund të parashikojë vlerat e sakta që mund të sjellë, dhe arsyeja për këtë mungesë të parashikueshmërisë qëndron në strukturën multifunksionale të kapitalit social. Kapitali social nganjëherë mund të bëhet material, ose ndonjëherë simbolik ose të marrë forma të tjera (Sandu, 1999: 4-5).

Elementet e kapitalit social gjithashtu zhvillohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, besimi nuk shndërrohet gjithmonë në sjellje bashkëpunuese dhe reciprociteti i përgjithësuar nuk sjell gjithmonë besueshmërinë ose bashkëpunim. Bashkëpunimi mund të forcohet ose të jetë i lidhur me interesat ose mund të shoqërohet me besim shumë të ulët (Sandu, 1999: 5). Megjithatë, Sandu (1999: 5) e përkufizon kapitalin social vetëm si atë lloj të caktuar të shoqërizimit produktiv që ka pasoja për rritjen e rezervave të kapitalit, si materiale, njerëzore apo edhe kapitalit social. Një sërë problemesh të rëndësishme në hulumtimin e transformimit të institucioneve rrjedh nga krahasimi mes institucioneve perëndimore dhe institucioneve pas-komuniste. Shumë studiues që punojnë në Europën Qendrore dhe Lindore kanë qenë kritikë ndaj transferimit të

drejtpërdrejtë të institucioneve të tipit perëndimor që kanë anashkaluar "temat e forta të vazhdimësisë që shënojnë edhe krisjet më dramatike sociale" (Hann et al., 2002: 5). Disa shembuj nga studimet antropologjike kanë të bëjnë me problemet me futjen e "parimit të tregut," futjen e modeleve perëndimore të konsumit, apo programeve të zhvillimit të agjensive të zhvillimit perëndimor (Sampson, 2002; Wedel dhe Creed, 1997). Një temë tjetër që ka shkaktuar shumë komente dhe polemika është pikëpamja se një ndryshim i thjeshtë në institucione është i mjaftueshëm për të transformuar ekonominë dhe për të hequr pengesat për tregtinë ndërkombëtare (shih Hann, 2002; Verdery, 1998; Burawoy dhe Verdery 1999; dhe Lampland, 2002). Lampland e bën të qartë se institucionet janë të banuara nga aktorët lokalë që jetojnë në marrëdhënie të ndërlikuara shoqërore (2002: 32). Rrjete profesionale dhe personale ndihmojnë në strukturimin e këtyre institucioneve të reja. Ndryshimi institucional mund të nxitet ose ndikohet nga ndryshimet kulturore, politike dhe socio-ekonomike.

Rrjetet

Koncepti i rrjeteve është qendror në shqyrtimin e kapitalit social dhe ndryshimeve institucionale. Fokusi i studimeve është rëndësia e rrjeteve informale dhe nëse ato janë transformuar ose kanë mbetur të ngurtë pas socializmit. Debati kryesor ka në qendër ndërveprimin midis rrjeteve informale dhe institucioneve formale dhe mënyrat me anë të të cilave rrjetet informale mund të jenë të favorshme për zhvillimin e tregut dhe demokratizimit. Disa autorë argumentojnë se socializmi i rrënoi rrjetet vullnetare sociale dhe ka krijuar një mjedis shoqëror steril. Nichols për shembull, pretendon se ka një mungesë të rrjeteve sociale vullnetare (dhe kështu të kapitalit social), që duhet të krijohet nga e para, pas socializmit (Nichols, 1996: 637). Nga ana tjetër, autorë të tjerë

argumentojnë se rrjetet joformale, kishin dhe, pavarësisht transformimeve, ende kanë një rol domethënës (për shembull, studimi mbi lidhjet e "favoreve" nga Ledeneva, 1998) dhe kështu mund të konsiderohet si kapital social në dispozicion (Marsh, 2000). Megjithatë, sipas Rose, rrjetet që "rishpërndajnë (ose keqshpërndajnë) mallrat dhe shërbimet nuk e rrisin produktin kombëtar në tërësi." Rrjetet paramoderne përkufizohen si "kryesisht joformale, shoqata "ballë për ballë", shoqatat e njerëzve në fshatra apo nëpër lagje urbane të vogla". Duke respektuar paradigmen e modernizimit në mënyrë rigorozë, Rose argumenton se shoqëria moderne dominohet nga institucione formale dhe sunduese të ligjit. Në mënyrë të ngjashme me Rose (1999), Raiser vë re se institucionet formale janë zëvendësuar pjesërisht nga institucionet më formale në rrjedhën e zhvillimit ekonomik. Zëvendësimi i tillë nuk konsiderohet i plotë edhe në ekonominë e zhvilluar të tregut (në kontrast me Rose, 1999, i cili është më afër paradigmës së modernizimit).

Ai gjithashtu i përshkruan rrjetet informale si një pengesë për zhvillimin e ekonomisë së tregut dhe beson se mbështetja në rrjetet e mbyllura informale zvogëlon disponueshmërinë e mundësive ekonomike (:8). Mbi këtë bazë, autori argumenton se ekonomia informale nuk mund të jetë bazë për ekonominë e tregut, pasi rrjetet e saj janë të mbyllura për të huajt (:7). Megjithatë, nëse është e mundur, ose në qoftë se krijohen kushtet e përshtatshme, zgjerimi dhe hapja e rrjeteve ekzistuese mund të rrisë nivelet e besimit. Ky proces mund të çojë në transformimin e rrjeteve që mund të lejojnë anëtarët të kërkojnë jashtë institucioneve. Kapaciteti i shtetit është pa dyshim një përcaktues i rëndësishëm në procesin e formalizimit të institucioneve joformale. Këto argumente janë hulumtuar në tri studime të rasteve të ndryshmeve institucionale në tranzicion: Kinë, Gjermani dhe ish-Bashkimin Sovjetik. Përfundimet forcojnë qëndrimet në lidhje

me rolin e rëndësishëm që mund të luajnë qeveritë në ndërtimin e besimit të zgjeruar (ose të përgjithshëm), ku besimi i "përgjithshëm" është sinonim i kapitalit shoqëror dhe kontribuon në ndryshimet e suksesshme institucionale.

Komunizmi shkatërroi atë që autorët e quajnë "kapital normal social" dhe kur regjime të tilla rrëzohen, kapitali social në dispozicion duhet të transformohet nga një formë negative që mund të parandalojë zhvillimin ekonomik. Frika e përhapur dhe mosbesimi që shkaktoi sistemi socialist, bashkë me shkatërrimin e organizatave vullnetare, mund të jetë një shpjegim për nivelin e ulët të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në EQL krahasuar me nivelet e kapitalit fizik dhe njerëzor. Në përfundim, autorët supozojnë se disa dekada mund të jenë të mjaftueshme për ndërtimin e kapitalit social pozitiv dhe se ndërhyrjet aktive në proces duhet të shmangen. Në vend të kësaj, qeveritë duhet të ofrojnë mbështetje pasive, që mund të krijojnë një "ambient të përshtatshëm për prodhimin e kapitalit social dhe luftimin e kapitalit social negativ".

Disa autorë argumentojnë se për të kuptuar procesin e ndryshimeve institucionale në EQL, duhet studiuar edhe natyra dhe roli i elitave, pasi ofron njohuri të rëndësishme (Gill, 1998; Petro, 2001; Adami dhe Tomsic, 2002). Studime të tilla tentojnë të përqëndrohen në debatin në lidhje me qarkullimin ose riprodhimin e elitave dhe kështu, edhe të kapitalit social. Szelenyi (1995) siguron një përmbledhje të dobishme të debatit akademik mbi rolin e elitave në vendet paskomuniste. Teoria e "riprodhimit të elitës" pretendon se pavarësisht transformimit të tyre, pushteti i vjetër i elitave mbetet. Nga ana tjetër, teoria e "qarkullimit të elitës" pranon pushtetin e qëndrueshëm të elitave të vjetra, por identifikon një rol të rëndësishëm edhe në zhvillim për elitat e reja antikomuniste. Këto elitat e reja mund të kenë më pak kapital politik, por ndoshta më

shumë kapital njerëzor kulturor (me arsim më të mirë dhe përvojë teknokratike). Mbetet e diskutueshme nëse ata do të fitojnë fuqi politike ose ekonomike (Szelenyi dhe Szelenyi 1995).

Në mënyrë të ngjashme, Adam dhe Tomcisz (2002) argumentojnë se shkalla e qarkullimit, në kuptimin e rotacionit dhe konkurrencës në mes fraksioneve të elitës politike, si dhe hyrja e aktorëve të rinj është një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Autorët pohojnë se në sistemet e vogla sociale, si në Slloveni për shembull, formimi i elitave nuk duhet të trajtohet në një kuptim të politizuar, por me anë të argumentave që kanë të bëjnë me cilësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Çështja duhet të trajtohet si një çështje racionale e diskursit publik në lidhje me prioritetet kombëtare. Roli i elitave të vjetra nuk është vendimtar, siç është formimi i elitave të reja dhe krijimi i një ndërveprimi dinamik midis segmenteve të ndryshme të elitave. Masat praktike sugjerojnë një përfshirje indirekte në formimin e elitave nëpërmjet stimulave për të rritur shtresën arsimore dhe nëpërmjet insistimit për zbatimin e parimeve të meritokracisë, si një mënyrë për promovim shoqëror.

Shumica e autorëve pajtohen se ka një mungesë besueshmërie tek shteti dhe një besim të kufizuar tek institucionet. Kjo lloj situatë konsiderohet si një nga problemet më të spikatura në EQL: "Besimi ndërmjet qytetarit dhe shtetit kufizohet vetëm në ato situata në të cilat qytetari është i sigurt se ka për të arritur përfitime personale", (Tilly, 1985: 170). Për sa i përket dallimit mes besimit dhe mbrojtjes, duket e pamohueshme se shumë qytetarë post-socialistë e konsiderojnë si më të besueshme, më efektive dhe për këtë arsye më të arsyeshme të jenë pjesë e një rrjeti me lidhje të personalizuar, në bazë

të parimit të mbrojtjes, se sa të mbështeten tek shteti (Gambetta, 1992). Kjo nuk duhet interpretuar nga pikëpamja kulturaliste e "mungesës së socializimit të Ballkanit ", ky është një sistem me përfaqësime dhe strategji racionale që ndjekin aktorët kur shteti në mënyrë të përsëritur nuk i kryen detyrat e veta themelore"(Giordano dhe Kostova: 75). Në të njëjtën kohë, njerëzit vazhdojnë të kërkojnë që shteti të zgjidhë problemet e veprimit të tyre kolektiv. Në këtë drejtim, mbingarkimi i politikave që fuqizojnë të drejtat e pronës private mund jo vetëm të jetë i pavend, por edhe potencialisht i dëmshëm (Hann et al., 2002: 5; Verdery, 1998).

Miller (1997) e përkufizon besimin si shpresë për një trajtim të drejtë. Ky lloj besimi, sipas tyre, ka një lidhje të dobët me besimin tek njerëzit por lidhet ngushtë me besimin tek institucionet shtetërore siç janë të qeveria apo policia (Miller et al., 1997: 600-601). Autorët tregojnë se besimi tek qeveria ndryshon nga vendi në vend, edhe pse nuk shpjegojnë pse. Njerëzit në Republikën Çeke apo Sllovaki, që kanë pritshmëri të larta për trajtim të drejtë, priren të besojnë më pak te qeveritë e tyre, ndërsa njerëzit në Rusi dhe Ukrainë kanë besim te qeveria, por pritshmëri më të ulëta për trajtim të drejtë. Përfundimi është se pritshmëritë për trajtim të drejtë reflektojnë më shumë se sa nivelin e kënaqësisë apo pakënaqësisë së përgjithshme politike (600-601). Pas një sërë studimesh me fokus grupe në Mali të Zi dhe intervistash individuale në Ukrainë dhe në Republikën Çeke, autorët kanë analizuar ndërveprimet ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve dhe kulturën e ankimit dhe thashethemeve në lidhje me korrupsionin. Sipas rezultateve, kultura e ankimit dhe thashethemeve si dhe vëmendja tek raportet e shtypit në lidhje me nivelin e lartë të korrupsionit mund të errësojë përvojat e menjëhershme personale me korrupsionin. Megjithatë, rezultatet tregojnë që korrupsioni i nivelit të ulët, ose korrupsioni në sektorin publik, ndikon në mënyrë domethënëse mbi besimin

tek institucionet shtetërore. Ndryshimet ndërmjet shteteve reflektojnë ndryshimet në përvojën socialiste si dhe në kontekstin postsocialist.

Giordano dhe Kostova (2002) kanë realizuar një punim shumë të dobishëm në lidhje me çështjen e besimit. Ata shqyrtojnë prodhimin shoqëror të mosbesimit në Bullgari, duke përshkruar sesi procesi i privatizimit ndryshe nga ajo që pritej, në vend që të prodhonte ndërmarrje të drejtuara nga familjet në bazë të pronave të vogla, ka krijuar në fakt një mori agjentësh të rinj social që përfaqësojnë interesa specifike dhe strategji ekonomike.

Mospërputhja ndërmjet praktikës sociale dhe kuadrit ligjor ka theksuar hendekun mes ligjshmërisë dhe legjitimitetit. Institucionet publike shihen nga aktorët lokalë si organe të huaja dhe si pengesa që duhen shmangur (Giordano dhe Kostova, 2002: 88-89). Prodhimi social i mosbesimit lulëzoi për shkak të keqinterpretimit, tensioneve dhe konflikteve midis shtetit dhe qytetarëve. Qytetarët mbrojnë strategjitë e tyre të përshtatjes si "armët e të dobtëve ", edhe nëse nuk janë ligjore. Marrëdhëniet e dyshimit të ndërsjelltë mes shtetit dhe shoqërisë që datojnë qysh nga Perandoria Osmane, vetëm e përkeqësojnë këtë situatë. Periudha para-socialiste dhe periudha socialiste e zgjeruan hendekun mes ligjshmërisë dhe legjitimitetit përmes strategjive klienteliste të elitave dhe ndarjes së tyre fizike nga qytetarët. Autorët kanë arritur në përfundimin se prodhimi shoqëror i mosbesimit, i vënë në provë edhe nga performancat në të kaluarën, funksionon si përgjigje ndaj efekteve të dëmshme të institucioneve të reja publike" (90) dhe se "bazohet në praktikat specifike që rrjedhin domosdoshmërisht nga përvojat negative të së kaluarës, të cilat janë të riaktivizuara në të tashmen nëpërmjet kujtesës kolektive të grupit (75).

Korrupsioni

Paldam dhe Svendsen (2000) sugjerojnë idenë se besimi, apo kapitali social, përcaktohet nga niveli i decentralizimit në shoqëri. Ndonëse vendet e ish-Bllokut Lindor kanë nisur zbatimin e reformave të bazuara tek tregu i lirë që nga viti 1989, niveli i besimit me sa duket nuk ka ndryshuar ende dhe ndoshta mund të duhen shekuj për ta ndërtuar. Në një hulumtim paraprak, Paldam dhe Svendsen (2001) argumentojnë se mungesa e besimit ka shkaktuar ngadalësinë e procesit të tranzicionit të vendeve të vjetra komuniste të Europës Lindore dhe Qendrore. Kështu, koncepti duhet të jetë veçanërisht i rëndësishëm për krahasimin e performancës ekonomike në Europën Perëndimore dhe Lindore. Në studimin e tyre të mëvonshëm, Paldam dhe Svendsen (2004), zbatuan matjet e besimit në një numër vendesh si në Europën Perëndimore ashtu dhe Lindore, ku të dhënat u mbledhën duke përdorur një pyetësor për intervista familjare.

Në përgjithësi, është e rëndësishme të përcaktohet nëse besimi është një opsion i ri që kontribuon në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimin social në çdo vend, dhe të shpjegohet se si mund të akumulohet dhe të mirëmbahet. Dimensionin lindje-perëndim është i rëndësishëm pasi nënkupton zgjerimin Europian dhe potencialin e rritjes ekonomike në këto ekonomi të reja të tregut.

Besimi është i lidhur ngushtë me korrupsionin. Niveli i korrupsionit ka shumë gjasa të ndikojë në nivelin e besimit 'pozitiv'. Në qoftë se dikush kryen një akt të paligjshëm kundër dikujt tjetër, duke injoruar rregullat formale të një kontrate, atëherë personi që kreu veprimin do të dënohet, në rast se sistemi policor dhe gjyqësor nuk janë të korruptuar. Nuk është e mundur që shkelësi të përdorë fitimet nga krimi dhe t'i ndajë ato me policinë dhe gjykatësit. Pra, në qoftë se të dy palët e dinë se nuk paguhet për të thyer rregullat, sjelljet e tyre do të përshtaten dhe nga takimet e përsëritura, do të

ndërtohet besimi. Përfundimisht, niveli i lartë i besimit dhe niveli i ulët i kostove të transaksionit në treg do të çojë në grumbullimin e përfitimeve të rëndësishme dhe agjentët nuk do të kenë më nevojë për kontrata formale (Putnam, 1993; Bjørnskov 2003b; Fisman dhe Gatti, 2002).

Nga ana tjetër, niveli i lartë i korrupsionit mund të çojë në besim negativ, në krijimin e rrjeteve sociale të cilat janë të dëmshme për rritjen ekonomike. Kjo ndodh për shkak se korrupsioni, në kuptimin e cilësisë së ulët të institucioneve, pengon zbatimin e rregullave. Në qoftë se paguhet për të thyer rregullat, atëherë është e vështirë të ndërtohet besimin, dhe niveli i lartë i kostove të transaksionit në treg nuk do të çojë në grumbullimin e përfitimeve të rëndësishme, dhe agjentët do të kenë nevojë për më shumë kontrata formale. Kur qytetarët nuk mund t'u besojnë institucioneve në shoqëri dhe kur nuk janë të gjithë të barabartë para ligjit, ndërtimi i besimit është shumë i vështirë. Kjo ide na çon në hipotezën se besimi i një agjenti tek cilësia e institucioneve formale (dmth shkalla e korrupsionit) do të ndikojë në nivelin e besimit të dobishëm për rritjen ekonomike, sepse një nivel i lartë i korrupsionit nënkupton moszbatimin e kontratave, dhe parandalon ndërtimin e besimit mes palëve tregtare.

Dikush mund të argumentojë se ekonomitë e planifikuara dhe ndërhyrjet masive të shtetit rrisin shanset për korrupsion. Shpesh, siç ishte rasti në Europën Lindore ish-komuniste, burokratët kanë kompetencat për të vendosur rezultatin e një çështjeje të caktuar. Ky monopol fuqie është burim i korrupsionit dhe ryshfetit, dhe mund të fshihet lehtë në mënyrë që një favor sot nga një burokrat, të kthehet në të ardhmen. Një sistem politik i cili centralizon pushtetin, do të thotë pra më shumë korrupsion, dhe më pak besim. Në total, këto dy faktorë shtrembërojnë rezultatet e politikave që ndikojnë në klimën e biznesit në përgjithësi dhe rënien ekonomike. Kështu, sistemet politike me

centralizim të fortë të pushtetit, si ato të Europës Lindore deri para vitit 1989, kanë më shumë gjasa për të shkatërruar praninë e besimit në shoqëri, ndërsa sistemet politike të decentralizuara, si ato të Europës Perëndimore, kanë më pak gjasa për të shkatërruar besimin, gjë që nënkupton norma relativisht të larta të rritjes ekonomike.

Sistemi komunist e centralizoi pushtetin në një mënyrë të tillë që krijoi kushtet për lulëzimin e korrupsionit, ndërkohë që shtetet e veçanta të Europës Perëndimore presupozohet të kenë centralizim më të ulët të pushtetit dhe rrjedhimisht përjetojnë një nivel më të ulët të korrupsionit. Një studim i kryer në lidhje me këtë çështje është edhe Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI), i cili është përdorur për matjen e nivelit të korrupsionit në nivel kombëtar në vitin 2000 (Transparency International, 2001). Rezultati i këtij indeksi varion nga 10 (shumë i pastër) dhe 0 (shumë i korruptuara)]. Pra, rezultat i lartë do të thotë korrupsion i ulët dhe rezultat i ulët do të thotë korrupsion të lartë. Në lidhje me perceptimet e tyre për shkallën e korrupsionit janë intervistuar njerëzit e biznesit, analistë të rrezikut dhe publiku i gjerë në 89 vende të ndryshme. Indeksi sigurisht është i bazuar në perceptimet subjektive (si njerëzit mendojnë se është), të cilat jo domosdoshmërisht tregojnë situatën reale. Mesataret e ponderuara në raport me popullsinë treguan se niveli i korrupsionit është relativisht i ulët në 15 shtetet anëtare të BE-së me një rezultat 7.1, krahasuar me nivelin mesatar 2.5 në Europën Lindore; që do të thotë se niveli i korrupsionit në Europën Lindore është pothuajse tre herë më i lartë se ai i BE-së. Vendet e Europës Lindore si Ukraina, Rusia dhe Rumania u radhitën në fund të listës me rezultate shumë të ulëta (1.5, 2.1 dhe 2.9) (Transparency International, 2001).

Për sa i përket kapitalit social dhe besimit, mënyra e parë e drejtpërdrejtë për të matur nivelin e përgjithshëm të besimit në shoqëri është thjesht të pyesësh njerëzit direkt, gjë

që është realizuar nga sondazhet e World Values Survey (Inglehart et al., 1998). Njerëzve u është kërkuar t'i përgjigjen pyetjes: "Në përgjithësi, do të thonit se shumicës së njerëzve mund t'u besohet, apo se kujdesi me njerëzit nuk është i tepërt?". Këtu, dallimet mes Europës Lindore dhe BE-së për sa i përket besimit të përgjithshëm janë më të pakta në krahasim me dallimet në nivelin e korrupsionit. Sipas mesatares së ponderuar, rezultatet e BE-së rezultojnë 36.97 në krahasim me 32.84 në Europën Lindore.

Qasjet mbi Integrimin - Bashkëpunimin dhe Kapitali Social

Bashkëpunimi mes individëve është i dukshëm kur ka veprim të dukshëm në nivel kolektiv (të shumë aktorëve) për një qëllim të paracaktuar (zgjidhjen e problemeve). Brehm dhe Rahn (1997) argumentojnë se të gjitha bashkësitë njerëzore përballen me probleme të veprimit kolektiv. Kolektivisht, shoqëritë janë Kapital Social dhe në Europën Qendrore dhe Lindore ndërveprojnë më mirë, kur anëtarët e tyre bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të arritur qëllimet e përbashkëta. Bowles dhe Gintis (2002) sugjerojnë përdorimin e termit "komunitete të qeverisjes", për zgjidhjen e problemeve kolektive të veprimit, dhe e shohin atë si një mekanizëm efikas për urdhërimin e marrëdhënieve shoqërore, kryesisht për shkak se tregu apo shteti nuk ka informacion të plotë privat ose lokal. Një komunitet efektiv monitoron sjelljen e individëve brenda grupit, duke i bërë ata përgjegjës për veprimet e tyre dhe duke ndëshkuar ata individë të cilët devijojnë nga normat shoqërore. Individët, megjithatë, përballen me stimuj dhe sillen me egoizëm, duke kërkuar të mirat e bashkëpunimit, pa kontribuar në këtë proces. Siç u tha më parë, sociologë, ekonomistë dhe shkencëtarë politikë përdorin konceptin e kapitalit social për të shpjeguar se pse disa grupe të

caktuara dhe komunitete janë në gjendje të zgjidhin problemet e veprimit kolektiv e të bashkëpunojnë, ndërsa të tjerët nuk janë në gjendje.

Annen (2002: 450) pretendon se rrjetet e marrëdhënieve të personalizuar karakterizohen nga kosto të ulëta të zbatimit, për shkak të reputacionit, i cili çon në sjellje bashkëpunuese. Brenda teorisë së zgjedhjes racionale, mekanizmi që lidh besimin ndërpersonal, ndërveprimet e përsëritura me të tjerët, dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm i ka rrënjët e tij në kërkimet për “*dilemën e të burgosurve*”. Në lojën e dilemës së të burgosurve, individët besojnë se bashkëpunojnë më lehtë. Dilema sociale i referohet situatave në të cilat individët bëjnë zgjedhje të pavarura në një situatë të ndërvarur dhe që analizohet në aspektin e zgjedhjes racionale, ku çdo individ ka një zgjedhje për të kontribuar apo jo në një përfitim të përbashkët. Ostrom (2000) thekson se besimi dhe reputacioni çon gjithashtu në bashkëpunim ose inkuadrim të strukturës së qeverisjes në mënyrë të tillë që të përfitohet në kolektivitet. Ata që thyejnë rregullat sanksionohen nga komuniteti apo grupi (Bowles & Gintis, 2002). Si pasojë, shkëmbimi, angazhimi i përbashkët, rritja e besimit, duke krijuar dhe përforcuar normat dhe zhvillimi i një identiteti grupi duket të jenë proceset më të rëndësishme që e bëjnë komunikimin efektiv. (Ostrom, 2000). Korniza e Ostrom-it është e rëndësishme, pasi ajo thekson rëndësinë e komunikimit mes individëve, që është gjithashtu në qendër të problemeve të veprimit kolektiv. Në dilemën sociale, individët e vetë-interesuar pritet të përdorin komunikimin në përpjekje për të bindur të tjerët për të bashkëpunuar dhe premtojnë veprime bashkëpunuese.

Nga eksperimentet në komunikimin ballë për ballë nuk kishte prova të rritjes së konsiderueshme të niveleve të bashkëpunimit (Ostrom, 2000: 483). Mund të arrijmë në përfundimin se komunikimi rrit normën e bashkëpunimit, dhe gjatë procesit të

komunikimit, kapitali social ose rritet ose ulet. Komunikimi nuk rezulton në mënyrë spontane në një strukturë të qeverisjes, por është i nevojshëm për të përvetësuar një set rregullash për çdo individ - për të përvetësuar strukturën e qeverisjes. Annen (2002: 451) thekson rëndësinë e reputacionit të një personi për të qenë bashkëpunues. Çdo lojtar jo vetëm që duhet të ketë sjellje bashkëpunuese, por të gjithë aktorët duhet të dinë besueshmërinë e secilit lojtar. Ai argumenton se funksioni i kapitalit social është të mbështesë bashkëpunimin mes lojtarëve në rrjet, dhe se kapitali social në këtë mënyrë mund të shihet si një strukturë qeverisëse. Reciprociteti është gjithashtu i rëndësishëm, dhe mundëson aplikimin e modeleve në situata komplekse të jetës reale.

Edhe pse thelbi i kapitalit social është si një koncept i përgjithshëm, ai e ka bazën e tij në sjelljen individuale. Grumbullimi është në një grup, komunitet apo në nivel rrjeti të caktuar që jep ndërveprimet e individëve. Me pjesëmarrjen me komunitetin e tyre në zgjidhjen e problemeve apo dilemave sociale, individi krijon një reputacion. Teoritë njohin racionalitetin e kufizuar të njerëzve, ndikimin e institucioneve informale (normat dhe vlerat) dhe efektin e të mësuarit social në procesin e bashkëpunimit.

IV. Shqipëria dhe qeverisja “e hapur”

Shqipëria dëshiron të jetë anëtare me të drejta të plota në Bashkimin Europian dhe prej vitesh po punon për zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë sociale. Për të arritur këtë synim, që gëzon mbështetjen e shumicës së shqiptarëve, i duhet të përmbushë, ndër të tjera, edhe standardet minimale të BE-së, të ashtuquajturin Modelin Social Europian (MSE). Këto standarde mund të arrihen vetëm nëse të gjitha grupet në shoqëri si edhe politika dhe administrata veprojnë bashkarisht, që do të thotë se ato ndërtojnë mes tyre një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi” (Dhembo, 2014: 3).

Kërkesat për një qeverisje të mirë dhe të hapur përkojnë gjithnjë e më tepër me një qeverisje ku parimet si “përgjegjshmëria, transparenca, reagimi, barazia, përfshirja, mbrojtja e të drejtave dhe ndjekja e rregullit të drejtësisë” (Brody, 2009, cituar në Dhembo, 2014: 11) të jenë themelet e shoqërive. Që prej vitit 2011, Shqipëria është angazhuar zyrtarisht tek Partneriteti për Qeverisje të Hapur, për të promovuar demokracinë e mirë dhe përfshirëse dhe për të mbështetur zhvillimin social dhe ekonomik (Qeveria shqiptare, 2011, cituar në Dhembo, 2014: 11). Koncepti ‘i hapur’ përfshin qeveri të hapur, të dhëna të hapura, informacion të hapur dhe inovacion të hapur, që detyrimisht kushtëzojnë ndryshimin e marrëdhënies mes qytetarëve dhe autoriteteve (Maier-Rabler dhe Huber, 2011, cituar në Dhembo, 2014: 11). Në raportin e 2011-ës mbi qeverinë e hapur dhe innovative, sekretari i përgjithshëm i OECD nënvizoi se “qytetarët dhe shoqëria civile do të fuqizohen për të marrë përgjegjësi më të mëdha dhe për të nisur partneritete të reja me sektorin publik. Si pasojë, bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqërinë civile do të bëhet një gur themeli për reformat e ardhshme në sektorin publik”(OECD, 2011: 13, cituar në Dhembo, 2014: 11). Në këtë kontekst, qeveritë dhe shërbimi civil duhet të ruajnë dhe kur është e mundur promovojnë parimet

e qeverisjes së mirë dhe të hapur (UNDP, 2013, cituar në Dhembo, 2014: 11). Me qëllim që të realizohet ky vizion, duhet që qeveritë dhe shërbimi civil nga njëra anë si edhe për qytetarët dhe shoqëria civile nga ana tjetër të përmbushin rolet dhe përgjegjësitë e pritura.

4.1 Kapitali social në Shqipëri

Kalimi nga diktatura komuniste dhe ekonomia e centralizuar drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut, për Shqipërinë ka qenë një kalim i vështirë, i zgjatur në kohë, ndoshta më shumë sesa parashikohej dhe është shoqëruar me dukuri të ndërlikuara në jetën publike. Në kuadër të përpjekjeve për sistemimin e perceptimeve shoqërore për rolin e besimit social, janë ndërmarrë shumë studime, ndër të cilët është i një rëndësie të veçantë studimi i IDN-së “Besimi social dhe autoriteti institucional në demokracinë shqiptare” për periudhën 2010-2011. Studimi mbështetet mbi të dhënat e Sondazhit Botëror mbi Vlerat (World Values Survey) në valët 3 dhe 4 të tij, ku Shqipëria figuron në vitet 1998-2002, mbështetet në një sërë studimesh europiane rreth besimit social, si edhe mbi rezultatet e dy fokusgrupeve dhe intervistave me një audiencë të zgjedhur dhe aktorë të njohur të jetës shoqërore, realizuar nga autorët e studimit (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011). Vënia bashkë e këtyre burimeve merr në studim shumë variabla, si për shembull besimin në përgjithësi, besimin ndaj institucioneve të veçanta, nivelin e pjesëmarrjes shoqërore, qëndrimin ndaj familjes, për këtë arsye ofron të dhëna për sistemin e vlerave të shoqërisë shqiptare si edhe rolin e tyre në krijimin e besimit dhe institucioneve.

Duke konsideruar faktin që tek besimi social ndikojnë trashëgimia shoqërore, mentaliteti klanor, kujtesa e realizimeve të mëparshme, performanca aktuale e institucioneve publike, korrupsioni i madh dhe i vogël (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011), është e rëndësishme të merret parasysh edhe ideologia komuniste dhe çështja e besimit social gjatë kësaj periudhe, për të kuptuar trashëgiminë që la pas. Regjimi komunist ndërtoi një fasadë indoktrinimi total në çdo fushë, dhe ua imponoi njerëzve besimin te ideologia, udhëheqja dhe institucionet e asaj kohe. Ky imponim i dhunshëm synonte t'i shtypte njerëzit, duke i shndërruar në qytetarë të nënshtruar, që kishin frikë nga institucionet, derisa besimi tek ato, apo tek Partia, u kthye në një gjë të natyrshme. Ndërkohë që u kërkonte besimin tek Partia, nga ana tjetër, zhvillonte mosbesimin e brendshëm (Vasilache, 2010; cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011), duke i porositur të ruheshin nga njëri-tjetri.

Studiuesja Kaminska ka vënë në dukje se “ në Poloni dhe në vende të tjera komuniste, logjika centraliste dhe jodemokratike e sistemit gjeneronte ndjesinë se vendimet që ndikonin mbi realitetin merreshin nga politikanë të panjohur të nivelit të lartë dhe se këto vendime nuk ndikoheshin dhe nuk kuptoheshin nga individë dhe mikrostruktura e tij”. Kjo çonte në tërheqjen e individëve në një hapësirë të kufizuar sociale dhe në një kohë të kufizuar sociale brenda së cilës mund të ruhej një kontroll i caktuar i zhvillimeve në jetën e dikujt. Nga ana tjetër kjo çoi në dominimin e interesit imediat dhe egoist të mikrostrukturës së dikujt përmbi interesat e komunitetit më të gjerë (Tarkowski & Tarkowska, 1994, cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011).

Këto kushte favorizuan gjithashtu mentalitetin merr-ç'të-marrësh dhe një përqëndrim të vëmendjes në arritjet afatshkurtra” (Kaminska: 679; cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011). Në përgjithësi, komunizmi kultivoi mentalitetin e pritjes nga shteti dhe besimin se shteti di të merret me gjërat me të cilat është caktuar të merret, dhe shembja e këtij regjimi, i la njerëzit në ankth, në shok, pa një shtet-baba (paternalist) që t'i mbronte. Shumë autorë besojnë se ky ndryshim detyrimisht u shoqërua edhe me shfaqjen e mosbesimit ndaj të tjerëve apo institucioneve të reja, duke e parë si faktor ndikimi përmbi besimin social në përgjithësi.


4.1.1 Familja në kuadër të besimit social

Studiuesit argumentojnë se familja përbën një tipar të rëndësishëm të besimit social dhe se ajo ka ndikuar gjerësisht në kompleksitetin e marrëdhënieve ndërmjet besimit social dhe atij institucional (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011). Duke qenë se mundëson të paturit e vlerave prioritare të përbashkëta dhe burimet morale për vetë-realizimin, familja shpesh zëvendëson rolin e institucioneve (Pehlivanova, 2009; cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011). Kjo teori, gjen terren në Shqipëri ku zakonisht gjaku yt, kushëriri, miku dhe i njohuri prevalojnë mbi një institucion.

Besimi ndërpersonal përbën një element kryesor në studimin dhe matjen e besimit social dhe autoritetit institucional. Përsa i përket besimit ndërpersonal, dy valët e SBV-së, tregojnë një ulje progresive të tij nga vala në valë. Për sa i përket besimit, perceptimi i shqiptarëve për të tjerët është kryesisht negativ, studimi i IDN-së tregoi se 72% e njerëzve që besojnë se “*duhet pasur kujdes*” në marrëdhëniet me njerëzit, për vitin 2002, gjë që dëshmon një mungesë të theksuar besimi ndërmjet shqiptarëve. Interesante janë të dhënat nga dy valët e analizuara të SBV-së që theksojnë se sa më i ulët të jetë

besimi ndërpersonal aq më i ulët është besimi tek qeverisja dhe institucionet qeverisëse (Grafiku 1). Pra, marrëdhënia ndërmjet besimit ndërpersonal dhe besimit tek qeveria është e drejtpërdrejtë edhe për rastin e Shqipërisë. Nëse vijojmë të flasim për marrëdhënien ndërmjet besimit dhe institucioneve, duhet pasur parasysh se besimi lidhet ngushtë me strukturën e institucionit. Imazhi i një zyrtari të lartë të një institucioni në Shqipëri është ai që përfaqëson të gjithë institucionin në fjalë. Pra, besimi tek drejtuesit e institucionit pasqyron besimin tek vetë institucioni. Të dhënat tregojnë se shqiptarët priren të identifikojnë institucionet me ata të cilët i drejtojnë këto të fundit dhe jo me strukturën dhe punën e tyre në vazhdimësi gjatë një periudhe kohore të caktuar. Si rrjedhojë, mungesa e besimit në elitat e pandryshueshme dhe vazhdimisht në riciklim të shoqërisë shqiptare gjatë 20 vjetëve të fundit të demokracisë çon në mungesën e besimit në institucione (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN, 2011: 37).


Grafiku 1: Besimi ndërpersonal dhe besimi tek qeveria 1998 dhe 2002 në



Burimi: SVB, vala e 3-të dhe e 4-t, Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN, 2011: 36.

Në vijim të diskutimit të mësipërm, të dhënat e SBV-së tregojnë se edhe besimi tek shtypi në Shqipëri, është në nivele relativisht të ulta, ku shumica përbëhet nga ata që nuk besojnë shumë dhe ata që nuk besojnë fare, siç tregohet dhe nga Grafiku 2.

Grafiku 2: Besimi tek shtypi 2002 në përqindje




Burimi: SVB, vala e 3-të dhe e 4-t, Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN, 2011: 38.

Gjatë analizimit të të dhënave për të dy valët e SBV-së, autorët e raportit të IDN-së kanë vënë re që nivelet e ulëta të besimit ndërpersonal shoqërohen me besim të ulët në institucionet lokale. Besimi i madh ndaj institucioneve ndërkombëtare, dëshmon ekzistencën e dy tendencave gjatë tranzicionit post-komunist shqiptar. Së pari, egziston një tendencë në rënie e besimit ndërpersonal që shoqërohet nga një rënie e besimit ndaj institucioneve kombëtare, dhe së dyti, boshllëku i lënë nga kjo mungesë besimi mbushet me besimin tek institucionet ndërkombëtare (Grafiku 3), të cilat shpesh konsiderohen si struktura të distancuara e të drejta që punojnë e vlerësojnë më mirë sesa institucionet tona (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 39). Përveç faktit që besimi në qeveri është rritur lehtësisht, studimi vë në dukje se besimi në institucione paraqet tendencë rënieje. Një

tregues i rëndësishëm që tregon rënien e besimit tek institucionet është dhe rënia e besimit tek policia nga njëra valë tek tjetra e SBV-së.


Grafiku 3: Besimi në institucionet ndërkombëtare 1998 dhe 2002 në %



Burimi: SBV, Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së, Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN: 39.


Policia së bashku me institucionet ligjore ka një funksion të veçantë, që është gjetja dhe ndëshkimi i atyre që shkelin ligjin duke përdorur strategji abuzuese ose duke kryer sjellje të rrezikshme. Drejtësia, nga ana tjetër, si mbrojtës i të gjithë ligjeve të vendosura në një shoqëri ka një rol kryesor në vendosjen dhe ruajtjen e shtetit të së drejtës. Në një shtet të së drejtës çdo ushtrim i kompetencave publike duhet mbështetur nga legjislacioni i qëndrueshëm i bërë publik dhe i zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët. Në këtë kuadër, sistemi i drejtësisë dhe policia (Grafiku 4 dhe 5) janë të përfshira në mbrojtjen e qytetarit dhe ky fakt ushtron ndikim të madh kundrejt tipareve shoqërore të besimit (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 40). Prandaj, nivelet e besimit drejtuar secilës prej tyre janë të rëndësishme.

Grafiku 4: Besimi te Policia



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së, Tamo, Baka dhe Gjokutaj IDN, 2011: 40.


Grafiku 5: Besimi te Drejtësia



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së, Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN, 2011: 41.

Ullman Margalit (2004: 65, cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011:41) shpjegon se në shoqëritë moderne, shteti vepron si një zëvendësues për besimin, sepse mungesa e zbatimit nga ana e tij e kontratave të detyrueshme me ligj, jo vetëm që nuk gjeneron besim, por në fakt i heq shoqërisë nevojën për të. Pra, studiuesit që argumentojnë në këtë mënyrë, mbrojnë ekzistencën e një lloj marrëdhënieje tregtie ndërmjet rolit të shtetit si një palë e tretë zbatuese e marrëveshjeve kontraktuale private dhe zhvillimit të besimit social (Herreros, 2008, cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011:42). Një tjetër tendencë që karakterizon zhvillimin e besimit social në Shqipëri, është se besimi i ulët tek qeveria mund të vijë si rrjedhojë edhe e perceptimeve që individët kanë mbi pritshmëritë ndaj institucioneve. Duke pasur pritshmëri të ulta nga institucionet, njerëzit priren të ushtrojnë veprimtari individuale ose në grup për të arritur qëllime të tyre, në vend që të presin që këtë gjë ta bëjë qeveria. Sipas të dhënave të SBV-së, shqiptarët duket se vazhdojnë të konsiderojë familjen e tyre si institucionin më të rëndësishëm (Grafiku 6). Kjo detyrimsht do të ndikojë mbi sjelljen e qytetarëve shqiptarë kundrejt institucioneve. Raporti i IDN-së vë në dukje se lidhjet e forta familjare, tradita e të jetuarit me prindërit dhe pesha që i vendoset çështjeve që lidhen me familjen në jetën e njerëzve, mbeten çështjet kryesore të cilat kanë influencuar edhe zhvillimin e besimit social dhe autoritetit institucional gjatë viteve.

Grafiku 6: Respekti dhe dashuria për prindërit




Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së, Tamo, Baka dhe Gjokutaj, IDN, 2011: 43 .

Institucionet informale mund të jenë të forta sepse ato veprojnë atje ku institucionet formale dështojnë (Ledeneva, 2001; cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 43). Megjithatë, pavarësisht rolit të institucioneve informale si familja, nuk do të thotë se ato pengojnë transformimin e shoqërisë, por mund të bashkë-ekzistojnë paralelisht me institucionet formale. Kështu, shqiptarët që respektojnë dhe duan gjerësisht familjet e tyre, harxhojnë një sasi të madhe kohe me familjarët e tyre dhe shumica e tyre jeton me prindërit.

Sa i përket lidhjes ndërmjet familjes dhe aktivizimit politik, studimi vëren se ajo është e drejtpërdrejtë. Sipas rezultateve, ata të cilët jetojnë me prindërit e tyre (Grafiku 7), janë më pak të përfshirë me aktivitetet sociale/politike dhe të komunitetit sesa ata që jetojnë vetëm. Një arsye për këtë mund të jetë kultura e tyre për ta konsideruar familjen si një institucion të rëndësishëm në të gjitha drejtimet, si dhe me faktin se shqetësimet e tyre kryesore lidhen me sigurimin e kushteve të mira të jetesës dhe me sigurinë brenda familjes dhe jo me shoqërinë në tërësi. (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011:44).

Grafiku 7: Ata që jetojnë me prindërit dhe ata që jetojnë vetëm 1998 dhe 2002



Burimi: Vala e 3-të dhe e 4-t e SBV-së, Tamo, Baka dhe Gjokutaj IDN, 2011: 44.


Besimi në përgjithësi është një koncept, matjet e të cilit realizohen nga përgjigjet e pyetjes së SBV-së: “Në përgjithësi a mendoni se shumica e njerëzve mund të besohen apo mendoni se duhet pasur kujdes?” (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 54). Grafiku më poshtë (Grafiku 8), tregon nivelin e besimit në përgjithësi në Shqipëri gjatë viteve 1998 dhe 2002, ku vetëm 24.3% e të anketuarve theksojnë se shumicës së njerëzve mund t’u besohet në 1998 dhe vetëm 23.2% në 2002. Një tjetër sondazh, i mëvonshëm, i vitit 2009, tregoi se trendi i besimit në përgjithësi është edhe më i ulët, duke qenë se 92.5% e të anketuarve u përgjigjën se duhet pasur kujdes dhe vetëm 7.5% se njerëzve mund t’u besohet (IDN&CIVICUS, 2010, cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 54).

Sipas studiuesve, rëndësia e madhe që shqiptarët i atribuojnë familjes dhe rrethit të ngushtë të miqve, mund të merret edhe si formë përfaqësuese e rrjeteve informale të besimit ndërpersonal. Për ta bërë jetesën e tyre më të përballueshme, njerëzit që jetojnë në shoqëri të korruptuara, ose në shoqëri që perceptohen si të tilla, duhet që të zhvillojnë

shumë kontrata sociale me njerëz të cilëve mund t'u besojnë. Mungesa e normave detyruese duket se zhvillojnë mosbesim, zili, pesimizëm kundrejt njerëzve në përgjithësi (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2001: 57). Këto rrethana janë më të favorshme për të zhvilluar atë lloj besimi që mund të zhvillohet tek persona të afërt të cilëve ata mund t'ju besojnë. Nga ana tjetër, këto kushte kanë zhvilluar një mosbesim, zili dhe pesimizëm kundrejt "njerëzve në përgjithësi". Ky lloj besimi kontribuon për krijimin e asaj që Ahn dhe Esseray e quajnë si "besimi ndërpersonal", çka do të thotë që njerëzit besojnë vetëm shokët dhe kushërinjtë por nuk besojnë njerëzit jashtë rrethit të tyre të ngushtë (Ahn dhe Esseray, 2008, cituar në Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 57).

Gjatë të dyja valëve të SVB-së, sipas të dhënave, popullsia ka mbetur skeptike përsa i përket sistemit politik qeverisës. Duket se shqiptarët kanë perceptime negative në rritje sa i përket sistemit qeverisës, i cili vlerësohet negativisht nga popullsia përgjatë viteve. Nivelet e ulëta të besimit në përgjithësi dhe atij institucional në veçanti, janë në kontrast me nivelet e larta të besimit në familje dhe në rrethin e afërt miqësor (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 59). Kjo tregon sipas autorëve të studimit, se shoqëria shqiptare mbetet tradicionale, shumë e lidhur me familjen dhe lidhjet e gjakut dhe me një nivel të konsiderueshëm mosbesimi kundrejt institucioneve. Sigurisht që nevojiten studime të mëtejshme në këtë fushë, megjithatë, nisur nga të dhënat e paraqitura deri më tani, mund të thuhet se besimi i madh në familje dhe në rrethet shoqërore të ngushta mund të jetë një lloj tipari i krijuar si pasojë e zhvillimit të vonuar dhe të ngadaltë si dhe mungesës së një performance institucionale të mirë para, gjatë dhe pas komunizmit. (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 60).

Grafiku 8: Besimi ndërpersonal dhe istitucional në përqindje gjatë 2012-2013



Burimi: Ashiku M., Journal of Economics and Development Studies, Vol. 2(2), Qershor 2014:


476.

Shqipëria, në vija të përgjithshme, mund të kuptohet si një rajon me nivel të ulët besimi dhe pjesë të performancës së saj ekonomike, rritjes dhe kushteve të zhvillimit mund të jenë të lidhura apo të shpjegohen lidhur me këtë fakt (Ashiku, 2014). Një studim i mëvonshëm, bazuar në intervista rreth konceptit të besimit, kapitalit social, demokracisë, si edhe në ripërpunimin e të dhënave të Sondazhit Botëror të Vlerave, ku Shqipëria figuron në vitet 2004-2008, konfirmon tendencat e përshkruara deri më tani.

Rezultatet e anketës tregojnë nivel të ulët të besimit ndërpersonal dhe institucional, duke përfshirë mungesën e besimit në drejtësi, polici, parti të politike, qeveri etj (Grafiku 9). Nëse kapitali social konceptohet si një "sakrificë individuale për të bërë një përpjekje për të nxitur bashkëpunimin me të tjerët", me shumë lehtësi mund të mbërrijmë në përfundimin se Shqiptarët nuk janë të gatshëm të braktisin interesat e tyre të ngushta personale, sepse sipas tyre kjo lloj "sakrifice" është e kotë, duke qenë se ekziston një

dysim i madh në lidhje me të ardhmen, nëse do të gjejnë apo jo të njëjtën sjellje altruiste në mënyrë reciproke. Ekzistenca e nivelit të ulët të besimit mund të lidhet me kushtet historike. Strukturat burokratike të qeverisjes që kanë ekzistuar në Shqipëri mund të përmblihen me marrëdhëniet personale politike dhe ekonomike, rregullimin shtetëror, dhe të drejtat e pronësisë të përcaktuara dobët.

Grafiku 9: Niveli i Besimit te qeveria, policia dhe drejtësia në përqindje gjatë 2012-2013



Burimi: Ashiku M., Journal of Economics and Development Studies, Vol. 2(2), Qershor 2014:

476.

Sipas të dhënave të ofruara nga SBV, shqiptarët vazhdojnë të konsiderojnë familjen si institucionin më të rëndësishëm. Si pasojë, një qasje e tillë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. Lidhjet e forta familjare, tradita që karakterizon pjesën më të madhe të rinisë shqiptare për të jetuar me prindërit dhe pesha që çështje familjare kanë në jetën e njerëzve mbeten elementet kryesore që kushtëzojnë zhvillimin e besimit social dhe autoritetit institucional përmes viteve. Siç mund të vërehet nga rezultatet e SBV-së, respekti dhe dashuria e shqiptarëve

për familjen është e jashtëzakonshme, ndërkohë që kalojnë shumë kohë me familjarët e tyre dhe shumica vazhdon të jetojë me prindërit. Kjo është ideja që qëndron pas konceptit të "familjarizimit amoral": personi ndjehet i detyruar moralisht vetëm për sa i përket familjes së tij / saj, duke përjashtuar çdo mundësi të bashkëpunimit që rrjedh nga ndërveprimet sociale. Në këtë mënyrë, marrëdhëniet shoqërore vihen "në rrezik" dhe si pasojë, edhe mundësitë e vendosjes së marrëdhënieve ekonomike, duke qenë se institucionet rezultojnë "më pak të afta" (ose kanë më pak fuqi) se "familjet dhe miqtë".

4.1.2 Kapitali social dhe emigrimi

Rënia e regjimit komunist, shkaktoi përveç të tjerave edhe një valë masive emigrimi, e cila shënoi një ndër fenomenet sociale, politike dhe ekonomike më domethënëse që ka përjetuar vendi ynë ndonjëherë. Me përfundimin e kontrollit të migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, si edhe nisur nga mungesa e stabilitetit politik dhe rënia ekonomike, shumë shqiptarë ju drejtuan shteteve fqinje në kërkim të një jete më të mirë. Duke parë shkallën e lartë të emigrimit, si edhe duke marrë në konsideratë kushtet e përshtatshme për krijimin e kapitalit social, Shqipëria përbën një rast studimi për të parë lidhjen që egziston midis këtyre dy fenomeneve (Cattaneo, 2008: 4).

Vendimi për të emigruar ngjason me vendimin për të bërë një investim (Sjaastad, 1962, cituar në Cattaneo, 2008: 6), pasi që të dy kanë për qëllim rritjen e produktivitetit të burimeve personale. Ky vendim mund të merret individualisht, ose mund të merret brenda familjes. Rrjetet sociale ndikojnë tek kostot dhe përfitimet e emigrimit, si për shembull ata që kanë lidhje me një emigrant më të madh, ose kanë të afërm me eksperiencë emigrimi, kanë më shumë mundësi për të emigruar edhe vetë (Palloni et

al.,2001). McKenzie dhe Rapoport (2006) argumentojnë se eksperiencia emigruese e komunitetit influencon në ndikimin që ka pasuria dhe mirëqenia në nxitjen e migrimit. Familjet më të varfra kanë më shumë gjasa të emigrojnë. Një studim i vitit 2005 i Bankës Botërore dhe Institutit të Statistikave të Shqipërisë intervistoi një kampion prej 3.840 familjesh shqiptare (Albania Living Standard Measurement Survey), dhe mbledhi të dhëna mbi migrimin, pjellorinë dhe kapitalin social. 9% e familjeve të përfshira në studim kishin të paktën një anëtar të familjes në emigrim, të përkohshëm ose të përhershëm (Cattaneo, 2008: 10). Sipas literaturës tradicionale, emigrantët supozohen të jenë individë me nivel të lartë arsimor, pasi shkollimi redukton kostot dhe rreziqet e migrimit, por në Shqipëri, shumë nga emigrantët (të cilët kishin zgjedhur destinazione të afërta si Italia dhe Greqia), nuk kishin as vitet mesatare të shkollimit. Njerëzit me edukim më të lartë, zakonisht kanë më shumë besim se mund të ndikojnë në procesin e vendim-marrjes politike dhe kanë më shumë gjasa të përfshihen në ndërveprime sociale. Gjithashtu, për sa i përket lidhjes me kapitalin social, u mor në shqyrtim pjesëmarrja nëpër shoqata të ndryshme, të lidhura me punën, kulturën, besimin fetar, rininë, sportet dhe lloje të tjera shoqatash. Norma e pjesëmarrjes mes anëtarëve të familjeve të intervistuar rezultonte të ishte shumë e ulët. Pjesëmarrjen më të madhe e gëzonin sindikatat e punëtorëve (36%), shoqatat politike (15%), grupet e fshatit (11%) dhe ato fetare (8%) (Cattaneo, 2008 : 12). Shkalla e ulët e pjesëmarrjes shpjegohet kryesisht me shpërbërjen e shumë grupeve dhe shoqatave që ishin aktive gjatë periudhës së komunizmit. Në një lloj mënyre, kjo mund të shërbejë si provë që pjesëmarrja në grupe sociale zëvendëson emigrimin e përkohshëm, duke qenë se kapitali social përmbush të njëjtat objektiva si ato që motivojnë emigrimin. Nga ana tjetër, nuk ndodh e njëjta gjë me emigrimin e përhershëm. Familjet që janë aktive me pjesëmarrjen e tyre në

organizata sociale, kanë më shumë gjasa t'i dergojnë anëtarët e tyre jashtë vendit në mënyrë të përhershme, pasi këto familje sigurojnë falë rrjeteve sociale informacione me rëndësi të madhe për emigrimin. Pra, kapitali social shërben si zëvendësues për emigrimin e përkohshëm (ata që qëndrojnë jashtë vendit për të paktën një muaj dhe pastaj kthehen), por jo për atë të përhershëm. Gjithësesi, marrëdhënia mes kapitalit social dhe emigrimit është e dyanshme, pasi edhe ky i fundit ndikon tek kapitali social. Me largimin e njerëzve nga vendi, natyrisht kapitali social zvogëlohet (Cattaneo, 2008: 26).

4.2 Marrëdhënia mes administratës publike shqiptare me qytetarët

Tranzicioni qysh prej rënies së komunizmit ka qenë një proces i stërzgatur në shumë fusha. Një projekt dinamik, që mbështetet në tezën se një shoqëri demokratike dhe e suksesshme në aspektin ekonomik dhe social mund të zhvillohet vetëm nëse aktorët e saj veprojnë mbi bazën e besimit, orientimit demokratik dhe vullnetit për të bashkëvepruar në mënyrë aktive, është edhe studimi afatgjatë i Fondacionit Friedrich-Ebert në bashkëpunim me disa Think-Tanks , që në 2014-tën realizuan një anketë e cila përfshiu një kampion prej 1352 nëpunësish civilë në nivelet vendore dhe qendrore të agjensive dhe institucioneve në vend, me qëllim ravijëzimin e profilit të administratës publike në Shqipëri, dhe perceptimet e saj mbi rolin, përgjegjësitë dhe marrëdhënien me qytetarët (Dhembo, 2014).

Pjesëmarrësve në studim iu kërkua të ndajnë mendimet e tyre mbi perceptimet që kishin për qëndrimet e përgjithshme të administratës publike. Sipas rezultateve të mbledhura, 57% e të anketuarve besojnë se qytetarët që shërbehen nga administrata publike në ditët

e sotme perceptohen ose si “klientë që u duhet ofruar një shërbim miqësor dhe eficient” dhe 24.2% i perceptojnë si “njerëz vulnerabël që u duhet shërbyer në mënyrë empatike”. Në nivel individual, 71% e të anketuarve besojnë te trajtimi i qytetarëve si klientë. Sipas të dhënave, 15 % e të intervistuarve besojnë se në përgjithësi qytetarët që shërbehen nga administrata publike janë “njerëz grindavecë” me një qëndrim “e dua tani e sipas mënyrës time shërbimin” ose si njerëz që përpiqen të “anashkalojnë sistemin”. Tabela 1 ilustron më shumë detaje në lidhje me këto qëndrime.

Tabela 1. Si perceptohen qytetarët nga administrata publike?

	Të tjerët	Vetja
Klientë që u duhet dhënë një shërbim miqësor dhe eficient.	57.1	71.4
Njerëz grindavecë me një qëndrim “e dua tani e sipas mënyrës time shërbimin”	6.7	3.1
Njerëz që kërkojnë gjithmonë të gjejnë hapësira për të shfrytëzuar sistemin.	7.9	3.3
Njerëz vulnerabël të cilëve u duhet shërbyer me empati (duke ia kuptuar hallin!).	24.2	17.6
Tjetër/Pa përgjigje	4.1	4.6
Total	100.0	100.0

Burimi: Dhembo, 2014: 42

Pyetjeve mbi përvojat e tyre në shërbimin e qytetarëve, mbi feedback-un e marrë në kthim si edhe pritshmërive, më shumë se gjysma e të intervistuarve iu përgjigjën pozitivisht, 52% thanë se kanë marrë dhe 55% thanë se presin kryesisht vlerësim dhe mirënjohje. Megjithatë, rreth 2% pohojnë se kanë marrë një shpërblim/pagesë ndërsa 5.3% kanë patur pritshmëri të tilla por mesa duket kanë qenë zhgënjyer. Nga ana tjetër, 36% e të anketuarve mbështesin parimin mbi rolin aktiv të qytetarëve dhe përfshirjen në proceset demokratike të vendim-marrjes. Siç rezulton nga anketa, brenda administratës publike mbizotëron një mendësi se parimi i pjesëmarrjes së qytetarëve mund të zbatohet më mirë në praktikë vetëm me njerëzit “e duhur”. Në nivelin individual, 15% e pjesëmarrësve besojnë se pjesëmarrja e qytetarëve është thjesht një humbje kohe (2.5%) ose thjesht jo relevante në kontekstin e tyre (12.1%), ndërkohë që për 75% të anketuesve përfshirja dhe pjesëmarrja e grupeve të interesit është vlerësuar si ndihmuese dhe produktive (Dhembo, 2014: 44). Pavarësisht ndryshimeve në opinionet dhe qëndrimeve bazuar në përvojat individuale ose perceptimeve lidhur me përfshirjen e qytetarëve (Dhembo, 2014: 44) në parim, pjesa më e madhe e të anketuarve e vlerësojnë agjensinë e qytetarëve në demokraci, me rreth 38% të tyre që besojnë se agjencia e qytetarëve në shoqëritë demokratike është thelbësore dhe 49% tjetër që beson se është e një rëndësie të madhe. Gjetja e fundit e mbyll pjesën e rezultateve me një shënim pozitiv. Gjithashtu, autori nënvizon nevojën për kërkime të mëtejshme mbi mënyrat që mund të përmirësojnë këto procese duke i bërë më efektive dhe të vlefshme si për administratën publike, ashtu edhe për qytetarët.

Tabela 2. Vlerësimi i agjensisë së qytetarëve në demokraci

	Frekuenca	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje Cumulative
Mungojnë	23	1.7	1.7	1.7
E rëndësishme, por jo gjithmonë				
e	127	9.4	9.4	11.1
Nevojshme				
Mjaft e rëndësishme	662	49.0	49.0	60.1
Jo e rëndësishme	18	1.3	1.3	61.4
Shumë, është thelbësore	522	38.6	38.6	100.0
Total	1352	100.0	100.0	

Burimi: Dhembo, 2014: 44

4.3 Besimi tek autoritetet institucionale

Dokumente të rëndësishme europiane si edhe misione vlerësuese që merren me vlerësimin e procesit të përparimit të vendit dhe rekomandime në drejtim të plotësimit të kërkesave që kërkon procesi i integritetit, kritikojnë çështje të rëndësishme, si për shembull vështirësitë e mëdha në ndërtimin e institucioneve ligjore. Shpesh ngrihen pyetjet se përse nuk po arrihet të krijohen në Shqipëri institucionet e pritura, me

performancën e dëshiruar, e pse niveli i besimit tek to është kaq i ulët. Besimi social është i pandashëm nga kapitali social, dhe ky i fundit, sic është shpjeguar deri më tani, është faktor themelor për shumë procese shoqërore, përfshirë edhe proceset e ndërtimit të shtetit/institucioneve ligjore (Putnam). Ajo çfarë është menjëherë e dallueshme në nivelin e besimit të shqiptarëve ndaj institucioneve është niveli i lartë i mosbesimit (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 7) Ndërkohë që mosbesimi në institucionet publike ka qenë një simptomë e përhapur e tranzicionit post-komunist, ndonëse kanë kaluar më shumë se dy dekada tranzicioni vazhdon të mbetet një fenomen i qëndrueshëm.


Janë zhvilluar disa studime mbi besimin social, te cilët kanë marrë shkas edhe nga të dhënat e sondazheve botërore/europiane mbi vlerat (World Values Survey). Shumë studime janë përpjekur të ekspozojnë çështjen e marrëdhënies mes besimit social dhe autoriteteve dhe institucioneve ligjore. Një ndër to është edhe studimi i Rothstein (Tamo, Baka dhe Gjokutaj, 2011: 8), i cili i kategorizon shoqëritë europiane e botërore bazuar në indeksin e besimit, kryesisht në shoqëri besuese dhe shoqëri mosbesuese. Për shembull, shoqëritë e vendeve të veriut të Europës konsiderohen si shoqëri ku besimi ndërpersonal është relativisht i lartë, ndërsa shoqëritë e jugut të Europës si shoqëri ku besimi mbetet relativisht i ulët. Pra banorët e veriut të Europës janë më besues te njëri-tjetri, ndërsa banorët e jugut, ku bëjmë pjesë edhe ne, janë më pak besues. Duket se niveli relativisht i lartë i mosbesimit tek njëri-tjetri që na karakterizon përkon me këtë kategori, jo vetëm sepse Shqipëria bën pjesë në jugun e Europës, por edhe sepse historikisht është konsideruar kryqëzim civilizimsh, besimesh, gjeografish politike.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Prill–Maj 2013, me një normë përgjigjesh prej 1200 të anketuarish në nivel kombëtar, zhvilloi një anketë që synonte të shqyrtonte qëndrimet e qytetarëve ndaj performancës së institucioneve publike dhe

ofrimit të shërbimeve. Të njëjtin studim e përsëriti edhe vitin pasardhës, me qëllim krahasimin e rezultateve, sic e paraqet edhe Grafiku 10.

Institucionet më të besuara në opinionin publik Shqiptar rezultojnë NATO (71% e popullsisë) dhe Bashkimi European (68%). Ndër institucionet e administratës publike më të besuara janë Forcat e Armatosura (44%), Policia e Shtetit (41%), Ekzekutivi (37%) dhe Institucionet e Sistemit Arsimor (37%). Institucionet më pak të besuara janë Gjyqësori (18%) dhe Partitë Politike (19%). Organizatat e Shoqërisë Civile kanë besimin e 34% të popullsisë, ndërkohë që 9% e të intervistuarve nuk kanë një perceptim të qartë mbi këtë.

Grafiku 10: Besimi në përqindje 2013-2014




Burimi: Sondazh Opinionesh “Besimi tek Qeveria”, IDM, 2014

Në krahasim me vitin 2013, vëmë re se në top-listën e institucioneve më të besuara qëndrojnë NATO (2013: 74%) dhe BE (2013: 70%), edhe pse me një ulje 3 dhe 2 pikë respektivisht. Në krahasim me të dhënat e vitit 2013, vihet re se Institucionet që shënojnë rritje në besimin e qytetarëve janë: Ekzekutivi (nga 30%-37%); Policia e Shtetit (nga 37-41%) dhe Parlamenti (nga 24%-29%). Organizatat e Shoqërisë Civile shënojnë një ulje të besimit nga qytetarët (nga 39%-34%) dhe Forcat e Armatosura një ulje të besimit prej 7% (nga 2013: 51% - 2014: 44%).

Të anketuarit janë pyetur të vlerësojnë në një shkallë nga 1 (shumë i dobët) deri 5 (shkëlqyshëm) kryerjen e funksioneve thelbësore të disa institucioneve. Rezultatet tregojnë se nota më e lartë për të gjitha institucionet është “punë e mirë”. Me vlerësimin “mirë – ose 3” janë vlerësuar, Ekzekutivi (nga 50% e popullsisë), Ushtria (nga 47% e popullsisë) dhe Institucionet e Sistemit Arsimor (nga 46% e popullsisë); Me vlerësimin e kombinuar “punë shumë e mirë – punë e shkëlqyer – ose 4-5 ” janë vlerësuar Institucionet Fetare nga 34 % e popullsisë; Me vlerësimin “punë e dobët – ose 2) është vlerësuar sistemi Gjyqësor nga 44% e popullsisë.

Kurse për sa i përket kënaqësisë me ofrimin e shërbimeve (Grafiku 11), Opinioni Publik rezulton i kënaqur me shërbimet në Sistemin arsimor (42%), në sistemin shëndetësor (35%) dhe në shërbimet që ofrohen nga universitetet publike (35%); dhe i pakënaqur nga ofrimi i shërbimeve të punësimit (51%) dhe nga shërbimet e gjyqësorit (47%).


Grafiku 11



Burimi: Sondazh Opinionesh “Besimi tek Qeveria”, IDM, 2014

Politikat e Qeverisjes së Hapur kërkojnë që qeveritë të kenë një qasje pro-aktive ndaj transparencës së informacionit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, gjë që rrit besimin e qytetarëve ndaj qeverisë. Rezultatet e Sondazhit të IDM-së (Tetor 2014) tregojnë se opinionit publik Shqiptar pret nga qeveria të jetë transparente, e hapur ndaj qytetarëve dhe të zbatojë politikat e anti-korrupsionit. Ndër gjetjet kryesore, rezulton që 76% e opinionit publik kërkon që “Të gjitha informacionet financiare dhe teknike të kontratave të punëve publike që financohen nga buxheti i shtetit, të bëhen publike”; 75% e opinionit publik kërkon që “Deputetët dhe të zgjedhurit vendorë duhet të bëjnë transparente pasuritë dhe të ardhurat personale”; 63% e opinionit publik beson se “Dëgjuesat dhe këshillimet me publikun janë procese formale dhe nuk kanë ndikim në vendimet që merr njësia e qeverisjes vendore”, edhe pse 59% e opinionit publik beson se qytetarët kanë informacionin dhe aftësinë e nevojshme për të gjykuar nëse një politikë e propozuar ndikon pozitivisht apo negativisht në jetën e tyre.

Grafiku 12




Burimi: Sondazh Opinionesh “Besimi tek Qeveria”, IDM, 2014

Grafiku 13, ilustron përgjigjet e sondazhit të kryer nga Fondacioni Friedrich Ebert në bashkëpunim me disa think-tanks, në fillim të 2014-tës, me qëllim gjallërimin dhe nxitjen e diskutimit politik dhe shoqëror në Shqipëri mbi temën e integritimit në BE (Lleshaj dhe Cela, 2014). Të anketuarit janë pyetur të përcaktojnë shkallën e besimit tek disa nga insitucionet më të rëndësishme të renditura më poshtë. Pavarësisht se pyetjet kishin për qëllim të masnin besimin, sikurse mund të shihet në grafik, insitucionet janë renditur duke marrë parasysh *nivelin e mosbesimit* si vlerë renditëse parësore. Duke parë vetëm nivelin e mosbesimit tek Grafiku 13 , pra ata që kanë zgjedhur alternativën ‘aspak’ për një insitucion specifik , insitucionet që rezultojnë më mirë në shkallën e mosbesimit janë insitucionet e arsimit publik , me vetëm 10 përqind të të anketuarve që kanë zgjedhur ‘aspak’ si përgjigje, ndjekur nga spitalet private me 12 përqind dhe

policia, media dhe qeveria me 13 përqind secili. Në ekstremin tjetër, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ), opozita dhe gjykatat rezultojnë secili me nivele të larta mosbesimi (30 përqind, 34 përqind dhe 35 përqind përkatësisht), ndërkohë që partitë politike janë më të mosbesuarat me 45 përqind të të anketuarve që nuk kanë aspak besim në to (Lleshaj dhe Cela, 2014: 47).

Grafiku 13: Sa Besim keni te institucionet e mëposhtme?



Burimi: Lleshaj dhe Cela, 2014: 48.

Duke bashkuar rezultatet e përgjigjeve ‘aspak’ me përgjigjet ‘pak’ dhe duke i konsideruar si tregues të niveleve të ulëta të besimit, atëherë institucioneve që u përmendën më sipër, me nivele të larta mosbesimi, u shtohet edhe një tjetër: spitalet publike. Ndaj, në shkallën e mosbesimit ‘pak-aspek’, sipas analizës së autorëve, partitë

politike mbeten sërish vlere të veçuara me 80 përqind të të anketuarve që tregojnë pak ose aspak besim në to dhe gjykatat, opozita, KQZ dhe spitalet publike që shënojnë ndërmjet 69 përqind dhe 59 përqind mosbesim.

Nëse i kthehemi grafikut për të parë nivelet e besimit dhe shohim përqindjen e besimit të përcaktuar nga përgjigja ‘shumë’, spitalet private shënojnë vlere të larta me 23 përqind të të anketuarve që kanë ‘shumë’ besim tek këto institucione. Në terma të besimit, spitalet private ndiqen nga kryeministri me 20 përqind të të anketuarve që kanë shumë besim, media me 16 përqind dhe ushtria me 15 përqind. Institucionet më të besuara janë spitalet private me 65 përqind dhe institucionet e arsimit publik me 63 përqind të të anketuarve që kanë ‘disi’ ose ‘shumë’ besim në to, duke kombinuar bashkë përgjigjet ‘shumë’ dhe ‘disi’(Lleshaj dhe Cela, 2014: 48).

I njëjti studim është kryer edhe vitin paraardhës, dhe nëse niveli i (mos)besimit krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, duket se njerëzit kanë shprehur frustrim dhe mosbesim kundrejt institucioneve publike në periudhën parazgjedhore . Autorët theksojnë se në vitin 2013, gjykatat dhe kryeministri patën nivele të ulëta besimi – ndaj edhe nivele të larta mosbesimi – me 45 përqind të të anketuarve që zgjedhën përgjigjen ‘aspak’, ndërkohë që media ishte institucioni më i besuar me 17 përqind të anketuarve që tregonin ‘shumë’ besim (Lleshaj dhe Cela, 2014: 48).

4.4 Shoqëria Civile si themel i demokracisë

Një nga aspektet më të rëndësishme të një qeverie demokratike është pa diskutim shoqëria civile. Mes tyre egziston një marrëdhënie e dyanshme, nga njëra anë shoqëria civile shërben si një mekanizëm mbikqyrës mbi veprimet e qeverisë për të promovuar

qeverisjen e mirë, nga ana tjetër, qeverisja e mirë në vetvete lejon zhvillimin e shoqërisë civile. Demokracia ka nevojë për qenie njerëzore të lira dhe aktive, si dhe për njerëz të përgjegjshëm. Berthold Brecht ka sygjerruar njëherë në mënyrë ironike se “në qoftë se qeveria është e pakënaqur me popullin, duhet ta shpërndajë popullin dhe të zgjedhë një të ri. Vetëm qytetari i lirë dhe aktiv mund ta sfidojë qeverinë dhe t’i mbajë të përgjegjshëm për premtimet paraelektorale”(Demokracia dhe Pjesëmarrja).

4.4.1 Shoqëria civile në Shqipëri

Demonstratat studentore të viteve 1990, të cilat sollën rrëzimin e regjimit komunist, vazhdojnë të konsiderohen edhe sot kësaj dite si një nga shembujt më të njohur se si shoqëria civile mund të ndikojë në ndryshimin e qeverisjes dhe njëkohësisht mund të kërkojë një qeverisje më të mirë (Gjinari, 2012: 13). Pavarësisht kësaj, me kalimin e kohës, duket se ndikimi i shoqërisë civile shqiptare ka pësuar një rënie në mënyrë të konsiderueshme, pavarësisht rritjes së numrit të aktorëve që veprojnë në këtë fushë. Një nga mangësitë kryesore të shoqërisë civile shqiptare, sipas autores Gjinari, është “mungesa e think-tanke-ve apo mekanizmave të tjera të ngjashme, të cilat mundësojnë që elitat intelektuale dhe profesionistët të kontribuojnë në debatet e politikës dhe në ndryshimin e pritur”, dhe kjo mangësi e bën shoqërinë civile shqiptare të pazhvilluar. Organizatat “think tanks” janë kanali kryesor i ndikimit të elitave intelektuale dhe ekspertëve në pjesën më të madhe të shoqërive demokratike. Këto organizma zhvillojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me autoritetet qeveritare dhe institucionet përkatëse dhe nëpërmjet këtij aksesit të afërt me organet vendimmarrëse, shërbejnë edhe si një mekanizëm për të legjitimuar vullnetin dhe opinionin publik. Sigurisht që ky rol i

rëndësishëm u mundëson të shërbejnë edhe si një filtër kontrolli për nismat që vetë institucionet publike i transmetojnë publikut të gjerë (Gjinari, 2012: 14).

Është e vërtetë se shoqëria civile shqiptare duhet të përballë me vështirësi të shumta, por të paktën, ka edhe një avantazh historik në krahun e saj. Egziston një presion i vazhdueshëm për qeverisje të mirë, që vjen si rezultat i aspiratave aktuale të Shqipërisë për t'u bërë anëtare e Bashkimit Europian.

Nevoja për qeverisje të mirë shoqërohet me nevojën për një mbështetje të vazhdueshme të shoqërisë civile. Në këtë mënyrë qeveria shqiptare do të jetë vazhdimisht nën mbikëqyrjen dhe presionin e institucioneve ndërkombëtare për të përmbushur kriteret e kërkuara dhe si rrjedhojë zëri i shoqërisë civile do të jetë më i fuqishëm. Duke patur parasysh këto kushte, shoqëria civile duhet të dijë të shfrytëzojë më mirë këtë avantazh të krijuar dhe të kërkojë mbështetje të bashkëpunojë me këto organizata për të rritur presionin ndaj qeverisë, për të kanalizuar më mirë shqetësimet e opinionit publik (Gjinari, 2012: 14).

4.4.2 Organizatat Jo-fitimprurëse dhe baza ligjore për shoqërinë civile

Organizatat jofitimprurëse janë një nga subjektet që u mundësojnë shtetasve të vënë në zbatim dhe të bëjnë realitet të drejtën e tyre kushtetuese për organizim kolektiv . Kështu, këto organizata kanë, përveç të tjerave dhe rolin e ndërmjetësit, që vepron në “hapësirën” midis qytetarit dhe shtetit. Për të përmbushur qëllimet e tyre organizatat jofitimprurëse veprojnë në të dyja kahet. Ato ndërhyjnë në komunitet, duke ofruar mbështetje dhe shërbime të ndryshme, ose ndërmjetësojnë pranë strukturave të shtetit për të mbështetur dhe/ose kundërshtuar mënyrën e zgjidhjes së çështjeve, që i përkasin

interesit komunitar në përgjithësi ose grupeve të veçanta të tij, sipas formës organizative, qëllimeve dhe objektivave që kanë përcaktuar e marrë përsipër. Legjislacioni shqiptar ka sanksionuar standarte të larta ligjore, në lidhje me këtë qëllim, të cilat ofrojnë jo vetëm premisën e përfshirjes së organizatave jofitimprurëse dhe shoqërisë civile në përgjithësi në procesin politikëbërës dhe marrjen e vendimeve, por edhe mbështetjen e nevojshme financiare për këto qëllime. Ky bashkëveprim nuk mund të kryhet veçse në mbështetje e në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të garantohen të drejtat e secilës palë gjatë bashkëveprimit. Për këtë arsye njohja dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi nga ana e OJF-ve është përgjegjësi dhe domosdoshmëri, sikundër për gjithë subjektët e tjerë që veprojnë në Republikën e Shqipërisë (AMSHC).

Legjislacioni përbën një nga pikat e referimit mbi bazën e të cilit bëhet vlerësimi i veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse dhe sigurisht mjeti me anë të të cilit do të mund të kundërshtoheshin në mënyrë gjyqësore ose administrative veprimet e OJF-ve që mund të çënojnë të drejtat e subjekteve që bashkëveprojnë me to. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon se e drejta e organizimit kolektiv mund të ushtrohet vetëm për *qëllime të ligjshme*, duke evidentuar qartë përgjegjësinë e çdo organizimi kolektiv për të njohur e zbatuar drejt legjislacionin në fuqi. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut sanksionon të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, mbledhjes dhe bashkimit paqësor, si edhe të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike apo Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë dy dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare që sanksionojnë lirinë e shprehjes e të opinionit dhe të mbledhjes paqësore, lirinë e tubimit dhe organizimit me

të tjerët, si edhe parashikon rastet e kufizimeve të këtyre të drejtave. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i përkufizon shoqatat si persona juridik që krijohen me vullnet të lirë “ të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj, dhe rregullon qëllimet, financimet dhe themelimin e degëve të tyre. Ligji nr.8788 “Për organizatat jofitimprurëse, Kodi përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e tyre. Gjithashtu, si pjesë të kuadrit ligjor që rregullon disa aspekte në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë civile, mund të rendisim edhe Kodin e Procedurave Administrative, i cili përcakton parimet e bashkëpunimit të administratës me personat privatë, pjesëmarrjen në procesin administrativ si edhe parimin e administratës së hapur (AMSHC).

4.4.3 Indeksi i Shoqërisë Civile

Indeksi i Shoqërisë civile (IShC) është një instrument vlerësimi dhe veprimi i zbatuar në nivel global nga organizatat e shoqërisë civile (OShC) me mbështetjen dhe nën udhëheqjen e CIVICUS, i cili ofron vlerësimin më gjithëpërfshirës deri më tani të shoqërisë civile shqiptare duke analizuar pesë dimensionet themelore: Angazhimin qytetar, Nivelin e organizimit, Ndikimin, Vlerat dhe Mjedisin socio-politik e ekonomik (IDN, 2010). Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) në Shqipëri, në periudhën Qershor 2009 – Qershor 2010, udhëhoqi një projekt që përfshiu mbi 200 OShC në nivel kombëtar, rreth 150 aktorë të sektorit publik e privat (institucione shtetërore, donatorë, media, biznes, shoqëria akademike etj.) si edhe rreth 1.150

qytetarë, si pjesë e një kuadri kompleks aktivitetesh kërkimore, vlerësimesh dhe konsultimesh, me qëllim matjen e këtij indeksi.

Ky raport analitik identifikoi disa probleme serioze në lidhje me marrëdhënien e shoqërisë civile me mjedisin socio-politik ku operon, vlerat e mirëqeverisjes dhe përgjegjshmërisë, pavarësisht se vuri në dukje burimet njerëzore dhe ekspertizën e kualifikuar. Kështu, sipas autorëve, “ shoqëria civile shqiptare manifeston karakteristikat e një sektori mesatarisht të zhvilluar, që mbetet i përkushtuar ndaj vlerave e principeve demokratike, por që mbetet i shkëputur prej kontekstit lokal, prioriteteve të qytetarëve dhe ka ndikim të ulët, jo vetëm prej indiferencës së përhapur të qytetarëve kundrejt shoqërisë civile apo përqasjes formale të aktorëve shtetërorë për të përfshirë sektorin e tretë”(IDN, 2010: 1). Përqasja dhe qëndrimet e aktorëve të ndryshëm, përfshirë OShC, të cilët kanë zbehur rolin dhe potencialin e shoqërisë civile, konsiderohen si faktorë ndikues. Sipas gjetjeve të studimit, egziston një gjendje e përgjithshme indiferentizmi ndaj iniciativave dhe organizatave të shoqërisë civile.

Ndërkohë që në fillim të viteve '90 aktivizmi dhe përfshirja qytetare nëpër lëvizje studentore, sindikaliste, etj motivohej nga një idealizëm i theksuar, sot duket se motivi mbizotërues është përfitimi personal apo interesi. Apatia e përhapur ndaj partive politike dhe mungesa e besimit tek institucionet shtetërore apo tek ndryshimi pozitiv që mund të sjellë angazhimi janë disa prej arsyeve përse edhe vetë aktivizmi politik mbetet një opsion vetëm për rreth 30% të qytetarëve (shih figurën 1). Rreth 34% e qytetarëve shprehen se nuk i besojnë shoqërisë civile, ndërkohë që 56% e aktorëve të jashtëm besojnë se shumica e Organizatave të Shoqërisë civile nuk janë transparente. Qytetarët dhe sidomos aktorët e jashtëm, përfaqësues të rretheve vendim-marrëse e politikë-bërëse, media, donatorë dhe shoqëri akademike, shfaqen skeptikë ndaj disa vlerave dhe

principeve themelore të mirëqeverisjes tek shoqëria civile, madje një numër i konsiderueshëm i Oshc-ve janë kritikë ndaj vetes (IDN, 2010: 4).

Raporti identifikon probleme të tjera edhe për sa i përket transparencës, përgjegjshmërisë, niveleve të tolerancës tek qytetarët anëtarë dhe jo-anëtarë të shoqërisë civile ndaj grupeve të caktuara si homoseksualët, Romët, të prekurit nga HIV / AIDS. Shoqëria civile, e cila duhet t'i promovojë këto vlera, në të vërtetë ende nuk i praktikon së brendshmi. Raporti vëren se mbizotërimi i organizatave që nuk bazohen në anëtarësi duket se e ka dobësuar disi praktikimin e vendimmarrjes përfshirëse tek shoqëria civile ndërsa bordet mbikqyrëse shfaqen si struktura formale, pa ndonjë rol në kërkesën për përgjegjshmëri dhe transparencë të sektorit të tretë. Gjithashtu, përjasja dhe qëndrimi i Shtetit ndaj sektorit të tretë kushtëzon marrëdhënien me aktorët e tjerë në shoqëri, dhe më gjerë, me mjedisin.

Sipas organizatave dhe aktorëve të jashtëm, dialogu dhe shkëmbimet mes dy aktorëve mbeten në nivele të ulëta. Nisur nga rezultatet, autorët konkludojnë se të gjithë aktorët bien dakord mbi faktin se nevojiten përmirësime të legjislacionit aktual madje edhe akte ligjore shtesë për të rregulluar marrëdhënien shtet-shoqëri civile në mënyrë që kontributi i iniciativave civile të jetë më efektiv (IDN, 2010: 5).

Figura 2: Fakte dhe Shifra

18.4% e qytetarëve janë anëtarë aktivë të org. Sociale
18.1% kryejnë punë vullnetare për org. sociale
27.3% e qytetarëve janë anëtarë aktivë të org. politike
29.9% kryejnë punë vullnetare për org. politike
28.2% kanë marrë pjesë në aksione politike (peticion, bojkot, demonstrate etj.)
66% e qytetarëve i besojnë ShC & 34% JO
56% e aktorëve të jashtëm besojnë se shumica e OShC nuk janë transparente
81.3% e aktorëve të jashtëm besojnë se OShC janë të afta të punojnë për interesa publike

Burimi: IDN, 2010: 3

Siç theksojnë edhe mjaft drejtues të OShC (Konferencë Kombëtare, Korrik 2010, cituar në IDN, 2010: 6) “shqetësimi kryesor për shumë organizata në fund të zbatimit të projektit nuk është gjithmonë vlerësimi i impaktit por financimi për projekte të tjera. Për më tepër duke qenë plotësisht të varur prej financimit të projekteve, kohëzgjatja mesatare e të cilave është më pak se një vit, është vështirë të drejtosh OShC drejt një përqasje të orientuar prej ndikimit dhe rezultatit”.

Nga ana tjetër, studimi i Indeksit të Shoqërisë Civile konfirmon shqetësimin e përsëritur se shoqëria civile mbetet një sektor i udhëhequr nga donatorët, dhe detyrimisht veprimtaria e tij mbetet e kushtëzuar nga projektet. Një përqasje e tillë (nga OShC) nuk mund të bëjë tjetër veçse ta fragmentarizojë sektorin nga pikpamja e tematikave dhe shtrirjes gjeografike që mbulon.

Figura 3: Fakte dhe Shifra

Vetëm 16.1% e OShC kanë bazë solide burimesh njerëzore

Dy komunitetet më të izoluara e nën-përfaqësuar janë ato rurale dhe grupet e marginalizuara sipas, respektivisht 70% dhe 47%e OShC

Financuesët kryesorë në 5 vitet e ardhshme sipas OShC: donatorë të huaj jo-BE (57%), Qeveria (17.8%), biznesi (10%), BE(7.8%). Nën 7% të OShC listojnë burime alternative si – kuota e anëtarësisë, shërbimet & donacione individuale.

75.3% e OShC i konsiderojnë mjaft të rëndësishme për axhendën e tyre prioritetet e donatorëve. Më pak se gjysma i konsiderojnë të tilla prioritetet e “grupeve të interesit” (48.8%) ose “grupeve të marginalizuara” (41.2%)

Për 72% të OshC, ShC ka qenë “disi e suksesshme” në influencimin e prioriteteve të donatorëve të huaj

Burimi: IDN, 2010: 6

Përveç dallimeve të theksuara mes OShC në Tiranë dhe atyre jashtë kryeqytetit, raporti vë në dukje edhe një tjetër fakt interesant, sektori civil është thujse inekzistent në zonat rurale, dhe kryesisht aksionet e shoqërisë civile shfaqen të përqëndruara në ato tematika / zona për të cilat ka financime. Për më tepër, dyshime mbi ndikimin dhe burimet njerëzore të shoqërisë civile lindin për shkak të kulturës filantropike të pazhvilluar në vend, mungesës së vëmendjes për diversifikimin e financimeve dhe mbizotërimit të financimeve afatshkurtra (IDN, 2010: 9).

4.5 Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe zbatimin e politikave

Në kuadër të projektit “Shoqëria civile dhe vetëqeverisja lokale në Përforsimin e kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe Mal të Zi”, Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO) në partneritet me Qendrën për ndryshime dhe zgjidhjen e konflikteve nga Shqipëria (PARTNERS) ndërmorën një studim me qëllim analizimin e shkallës së lartë të integritit, zhvillimit dhe bashkëpunimit të shoqërisë civile në fushën e përforsimit të kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe ky përbën një parim të rregullimit demokratik të shtetit dhe parakushtin kryesor për punën transparente dhe përgjegjëse të vetëqeverisjeve lokale (CRNVO, 2013: 9). Sipas studimit të sipërpërmendur, disa nga aktivitetet më të zakonshme me anë të të cilave merr formë pjesëmarrja përfshijnë: paraqitjen e kërkesave për akses të lirë në informacion, nënshkrimin e peticioneve, mbledhjen e grupeve të qytetarëve nëpër bashkësi lokale, hartimin e iniciativave për zgjidhjen e problemeve që prekin popullsinë lokale, format e ndryshme të protestave përmes të cilave njerëzit ankohen dhe kërkojnë llogari për punën e parregullt të organeve të vetëqeverisjes lokale, etj. E drejta e qytetarëve për pjesëmarrjen në qeverisje në nivelin lokal nuk garantohet në Kushtetutën tonë, por kjo e drejtë rrjedh nga parimet e përgjithshme të renditjes demokratike politike dhe nga të gjitha të drejtat e tjera të garantuara me Kushtetutë, siç janë e drejta mbi vetëqeverisjen lokale, e drejta e qasjes së lirë në informacion, liria e shtypit dhe formave të tjera të informimit publik, liria e organizimit, etj (CRNVO, 2013: 21). Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e miratimit dhe zbatimit të politikave publike (qofshin ato lokale apo kombëtare) është pjesë përbërëse e demokracisë pjesëmarrëse që

së bashku me demokracinë përfaqësuese përbën një themel të shoqërisë demokratike bashkëkohore.

Pjesëmarrja qytetare në proceset e vendimmarrjes ka një rëndësi të vecantë për qeverisjen në nivelin lokal, si për komunën, ashtu edhe për qytetin. Vetëqeverisja lokale është adresa e parë për çdo qytetar, pasi janë ata që e përjetojnë komunitetin lokal në mënyrë më të drejtpërdrejtë. Marrëdhënia mes qytetarëve dhe pushtetit është dukshëm më e afërt në këtë nivel të pushtetit. Qytetarët kanë mundësinë që nëpërmjet vetëqeverisjes lokale të ndikojnë tek ndryshimi dhe zbatimi i vendimeve të miratuara më shumë se me çdo lloj instrumenti tjetër. Duke konsideruar faktin që qytetarët janë më familjarë dhe njohin me detaje problemet nëpër komunitetet e veta përkatëse, ata janë pika kryesore e referimit për kërkimin dhe propozimin e zgjidhjeve që do të mund të eliminojnë këto probleme (CRNVO, 2013: 10).

Qytetarët mund të marrin pjesë në vendimmarrje në komunitete të veta lokale në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve. Për shembull, kur qytetarët diskutojnë dhe japin propozimet e tyre mbi çështjet nga kompetencat që i përkasin një organi komunal, atëherë kemi të bëjmë me demokracinë e drejtpërdrejtë. Por, kur janë këshilltarët në kuvendin lokal ata që në emër të qytetarëve që i kanë zgjedhur votojnë për një vendim, atëherë kemi të bëjmë me demokracinë përfaqësuese. Përfitimet që pushtetet lokale marrin nga pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin dhe implementimin e politikave publike janë të shumta. Si fillim, vendimet e pushteteve lokale që miratohen me pjesëmarrje të qytetarëve në mënyrë të përshtatshme, janë më legjitime dhe sigurisht më të qëndrueshme. Me rritjen e pjesëmarrjes qytetare në kryerjen e punëve njëkohësisht rritet edhe besimi tek institucionet dhe forcohet marrëdhënia mes qytetarëve dhe pushtetit. Me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë në miratimin dhe

zbatimin e vendimeve, qytetarët janë në pozitë që të japin kontributin e vetë të rëndësishëm për rritjen e transparencës së punës së vetëqeverisjeve lokale në mënyrë të padiskutueshme. Në këtë mënyrë krijohen kushte për zhvillimin e një shoqërie civile aktive e njëkohësisht qytetarët bëhen më të përgjegjshëm dhe të angazhuar në komunitete të veta. Duke marrë pjesë në krijimin dhe implementimin e vendimeve, qytetarët shndërrohen nga votues joaktiv dhe jo shumë të interesuar në subjekt politik aktiv. Në këtë mënyrë qytetarët marrin përsipër përgjegjësinë për marrjen e vendimeve politike, vendosin mbi cilësinë e shërbimeve publike, zgjidhin problemet e përcaktuara në komunitetet e veta dhe ndihmojnë vetëqeverisjet lokale për identifikimin e këtyre problemeve (CRNVO, 2013: 10-11).

4.5.1 Pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë në qeverisje dhe kuadri ligjor mbështetës

E drejta e qytetarëve për të marre pjesë në proceset vendimmarrëse dhe instrumente të tjera të politikave publike nuk është një e drejtë që specifikohet saktësisht dhe shprehimisht nga Kushtetuta e Shqipërisë, siç u përmend edhe më sipër. Kjo e drejtë rrjedh nga një sërë parimesh që karakterizojnë sistemin politik demokratik, të cilat garantohen nga Kushtetuta si e drejta e lirisë së aksesit në informacionin publik apo me rëndësi për publikun, e drejta e peticioneve ndaj autoriteteve, e drejta e një ambienti të shëndetshëm, e drejta për te propozuar ligje, e drejta e referendumit, e drejta e lirisë së fjalës dhe grumbullimit dhe organizimit etj. Ushtrimi i këtyre të drejtave rregullohet me ligje dhe akte normative të tjera në mënyrë të detajuar (CRNVO, 2013: 22).

Sipas përmbledhjes së publikuar nga CRNVO (2012), baza ligjore kryesore për Pushtetin Vendor në Shqipëri mbështetet në tre shtylla kryesore:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila hyri në fuqi në 1998.
2. Karta Europiane e Vetëqeverisjes Vendore, ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me datë 21 Tetor 1998.
3. Ligji Nr.8652, i datës 31.07.2000: “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, *I ndryshuar me*: Ligjin Nr. 9208, datë 18.03.2004: “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000; “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe Ligji nr.8653 dt. 31.07.2000 “ Për ndarjen administrativo-territoriale e njësive te qeverisjes vendore në RSH”.

Ndërkohë që disa nga format e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal që qytetarët shfrytëzojnë në Shqipëri në emër të interesit të përbashkët renditen:

- Grupet Këshillimore Qytetare
- Planifikimi Strategjik i Qytetit
- Ndërtimi i Koalicionit
- Organizimi Komunitar
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Dëgjuesat publike
- Kartat Raportuese

Kuadri ligjor për garantimin e Lirisë së Shprehjes

Elementet që mundësojnë përfshirjen qytetare janë shoqatat, burimet, informacioni dhe negocimi. Të gjitha këto, nuk mund të konceptohen dot pa lirinë liria e shprehjes. Pa lirinë e shprehjes, njerëzit nuk do të ishin në gjendje të artikulonin mendimet dhe interesat e tyre, të formonin shoqata, nuk do mund të mobilizonin burimet në mënyrë efektive, nuk do të ishin në gjendje të kërkonin dhënien e informacionit zyrtar, apo të merrnin pjesë nëpër debate me qeverinë dhe institucione të tjera qeveritare. Kushtetuta e Shqipërisë mbron të drejtën e lirisë së fjalës dhe lirinë e shtypit. Ajo gjithashtu mbron të drejtat e minoriteteve për t'u "bashkuar në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe identitetit të tyre"(CRNVO, 2013: 23).

Ligji shqiptar për median elektronike, ka hyrë në fuqi në 1998 dhe është ndryshuar në vitin 2000 dhe 2003. Ai rregullon aktivitetet e medias dhe radiotelevizioneve publike e private. Parimi thelbësor i tij është që Autoriteti i transmetimit "mbikëqyr në mënyrë të paanshme, të drejtën e informimit, opinionet politike dhe besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, privatësinë e qenieve njerëzore si edhe liritë e të drejtat e tyre themelore". Ligji gjithashtu garanton pavarësinë editoriale (CRNVO, 2013: 23-27).

Ligjet shqiptare lidhur me shpifjen, parashikojnë sanksione penale dhe, nisur nga kjo, këto ligje kufizojnë shprehjen e lirë. Ligjet penale të Shqipërisë përdoren për të ngacmuar mediat dhe aktivistët politikë. Përveç kësaj, një padi për shpifje civile, qoftë edhe kërcënim për një padi të tillë, dhe mundësia e pësimit të një dëmi të konsiderueshëm material por edhe moral, mund të përdoren (dhe ka raste të tilla) për të bërë presion mbi gazetarët apo persona të tjerë kritikë ndaj personave të veshur me autoritet shtetëror. Ligjet dhe rregulloret në lidhje me të drejtën e fjalës dhe të autorit,

konkurrencën e lirë dhe reklamat e qeveritare, ndikojnë në përdorimin efektiv të medias nga shoqëria civile (CRNVO, 2013: 23-27).

Kuadri ligjor për të drejtën e informimit

Shqipëria ofron garanci kushtetuese dhe ligjore të së drejtës për informim. Kushtetuta aktuale, e garanton këtë të drejtë në nenin 23, i cili citon se:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Shtatë muaj më vonë, u miratua edhe ligji “Për aksesin në Informim, nr 8503 – E drejta e informimit për Dokumentet Zyrtare”, duke e bërë kështu Shqipërinë të parin vend në rajon që adoptoi legjislacionin për t’i siguruar qytetarëve të drejtën e informimit. Neni 23 i Ligjit 8503 thekson se “çdokush ka të drejtën, në përputhje me ligjin, të marrë informacion mbi aktivitetin e organeve shtetërore, si dhe të personave që kanë funksione shtetërore” (CRNVO, 2013: 23-27).

Vetëm duke pasur informacionin e duhur dhe të saktë, qytetarët mund të diskutojnë dhe të kërkojnë llogari mbi aktivitetin e qeverisë së tyre, qendrore apo lokale, dhe shoqëria civile të mund të jetë mjaftueshëm e informuar për atë që bëjnë qeveritë dhe zyrtarët e tyre, të monitorojnë dhe vlerësojnë performancën e tyre. Nëse liria e shprehjes është oksigjeni për angazhimin qytetar, e drejta e aksesit në informacion është një ushqyes thelbësor i këtij angazhimi të suksesshëm. Ligji shqiptar mbi të drejtën e informimit hyri në fuqi në Qershor të vitit 1999. Sipas këtij ligji, të gjithë personat mund të

kërkojnë informacion nga dokumentet zyrtare pa pasur nevojë të shpjegojnë arsyet e nevojës për këtë informacion; dokumentet dhe informacioni mund të mos jepen vetëm në rastet kur një ligj tjetër e pengon këtë; në raste të tilla, autoritetet publike duhet t'i bëjnë me dijeni me shkrim kërkuesit të informacionit arsyet e refuzimit të dhënies së këtij informacioni. Individët që besojnë se të drejtat e tyre të garantuara me ligj janë shkelur, mund të drejtojnë një ankesë në gjykatën administrative apo ligjore dhe nëse shkelja e këtyre të drejtave ka shkaktuar dëme, individit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim në forma të ndryshme. Zyra e avokatit të popullit është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve e garantimin e paprekshmërisë dhe mirëaplikimit të demokracisë tek të gjithë qytetarët (CRNVO, 2013: 23).

Gjithashtu, Ligji 8485 (5 dhjetor 1999, “Kodi i Procedurave Administrative”) siguron të drejtën e informatave që përmbajnë dokumentet zyrtare, edhe në rastet kur kërkuesi nuk ka interes legjitim personal në këtë çështje. Për më tepër, Kodi nënvizon një të drejtë informimi që vlen vetëm për pjesëmarrësit në “procedurat administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe vetëm për dokumentet e përdorura në procedurën në fjalë (CRNVO, 2013: 23-27).

Ligjet që ndikojnë tek Negociatat

Ligji shqiptar parashikon mekanizmat e mëposhtme institucionale përkatëse për “Negocimin”, që është vendi dhe rregullat sipas të cilave qytetarët mund të negociojnë dhe debatojnë çështje të shqetësimit publik me zyrtarë të Qeverisë. Zyra e Avokatit të Popullit, e themeluar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe nga një ligj i 1999, është një zyrë avokatie e ngarkuar me përgjegjësinë e përgjigjes së kërkesave të individëve, grupeve të individëve apo organizatave joqeveritare që besojnë se të drejtat, liritë apo interesat e

tyre të ligjshme janë dhunuar nga veprime qeveritare të paligjshme apo të papërshtatshme apo nga dështimi i një veprimi.

Rregullat parlamentare i lejojnë publikut dhe medias të marrë pjesë në seancat plenare të Parlamentit, dhe radio e televizioni t'i transmetojnë këto seanca; ligjet parashikojnë gjithashtu për publikun dëgjimin e komisioneve parlamentare, pjesëmarrjen publike në mbledhjet e komisionit dhe aksesin publik në projektligje dhe raporte parlamentare. Dhjetë ligjet kryesore në lidhje me decentralizimin, përfshirë edhe *Ligjin mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Lokale (ligji OFQL)*, janë ligjet bazë për krijimin e autonomisë lokale dhe decentralizimin e përgjegjësisë nga qeverisja qendrore drejt autoriteteve lokale. Kuadri ligjor lidhur me decentralizimin është veçanërisht progresiv në sigurimin e pikave specifike të përfshirjes së komunitetit në procesin vendimmarrës të qeverisë (CRNVO, 2013: 26-27).

4.5.2 Tradita Komunitare dhe angazhimi publik i qytetarëve

Është folur kaq shumë për angazhimin e qytetarëve në komunitet dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre, por është e rëndësishme të kuptohet edhe nëse ka një bazë të mirëfilltë të ndjenjës komunitare në Shqipëri (IDN, 2008: 12). Alexis de Tocqueville në veprën e tij “Demokracia në Amerikë”, thekson se emëruesi i përbashkët i çdo organizimi komunitar është gadishmëria për t'u organizuar vullnetarisht dhe për të zgjidhur probleme me interes publik. Për sa i përket kontekstit shqiptar, duket se komunitarizmi si një rrymë teorike, qoftë sociale qoftë e lidhur me filozofinë politike nuk ka një traditë të trashëguar në Shqipëri. Gjithsesi, sipas orientimeve të IDN-së, organizimi komunitar nuk mund të përmbledhet vetëm në përcaktime teorike, sepse

është njëkohësisht i lidhur si me organizimin lokal dhe vetëqeverisjen vendore, ashtu edhe me aspekte të tjera të jetës sociale si virtyti dhe morali, roli i familjes, i farefisnisë, fqinjësisë, vullnetarizmit, respektimin e tjetrit e të pasurisë së tij. Nisur nga ky këndvështrim, në Shqipëri ka patur një traditë të organizimit komunitar, por gjithnjë ka mbetur e kufizuar në nivel vendor dhe në një fazë fillestare (IDN, 2008: 12).

Gjithashtu, mënyra sesi format e ndryshme të organizimit komunitar janë aplikuar në Shqipëri, sidomos në periudhën e sistemit komunist por dhe më pas gjatë periudhës së tranzicionit e zhveshën atë nga vlerat e mirëfillta të komunitarizmit. Së pari, në periudhën e regjimit komunist format e organizimit komunitar u ekstremizuan duke e imponuar me forcë vullnetarizmin dhe idenë e kolektivizmit në masivizim të skajshëm. Ndërsa në periudhën që pasoi rënien e komunizmit, çdo vlerë të ngritur gjatë rendit të mëparshëm iu desh të përballej me antagonizmin gjithpërfshirës të tranzicionit, duke zëvendësuar kështu kolektivizmin ekstrem me individualizmin po aq ekstrem (IDN, 2008: 12).

Në ditët e sotme, mund të thuhet se Shqipëria po kalon një fazë të një ri-organizimi komunitar, ku mbizotërojnë karakteristika si migrimi i brendshëm e në masë dhe fitojnë rëndësi elementë të tjerë specifikë siç janë fqinjësia, njësitë prodhuese apo të shërbimit, grupet e interesit, shoqata, grupimet e ndryshme tematike dhe gjeografike të shoqërisë civile, etj. Në këtë mënyrë, tashmë në Shqipëri është krijuar infrastruktura e nevojshme për formimin e kushteve për mobilizim komunitar. Megjithatë, qëndron sfida e ndryshimit të mendësisë lidhur ngushtë me individualizmin si një kundërveprim ndaj çdo akti vullnetar apo gadishmërie për angazhim të përbashkët qytetar në dobi të së mirës së përgjithshme (IDN, 2008: 13).

Angazhimi qytetar

Zgjedhjet e fundit parlamentare që u mbajtën në Shqipëri ishin ato të qershorit 2013, të cilat sollën ndryshimin e drejtimit politik të vendit pas tetë vitesh. Koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane” i drejtuar nga Partia Socialiste (PS), fitoi një shumicë të qartë qeverisëse ndaj Partisë Demokratike (PD) në pushtet. I konsideruar si një moment kritik për tranzicionin demokratik të Shqipërisë, populli pret që përfaqësuesit e tij t’i përfshijnë ata në adresimin e shqetësimeve të vjetra të reflektuara në studim, si papunësia, shëndetësia, arsimi dhe korrupsioni. Për të dhënë një shtysë drejt këtij lloj dialogu dhe ofruar informacion objektiv mbi opinionin e publikut për hartimin dhe miratimin e politikave për këto çështje, NDI ndërmori një studim cilësor të opinionit publik në pesë qytete të vendit gjatë periudhës 9 deri 15 dhjetor, 2013. Ky raund grupesh të fokusuara u mbajt gjashtë muaj pas zgjedhjeve parlamentare dhe tre muaj pas fillimit të punës së qeverisë së re (NDI, 2014).

NDI i përzgjodhi qytetet bazuar në numrin e popullsisë, madhësinë si edhe vendndodhjen e tyre gjeografike. Karakteristika të tilla si gjinia, mosha, niveli i të ardhurave, punësimi dhe përkatësia politike u morën parasysh dhe u reflektuan në rekrutimin (e drejtuar) e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit, me qëllim mbledhjen e përfytyrimeve nga një shumëllojshmëri qytetarësh (NDI, 2014: 4-5).

Shoqëria civile dhe aktivizmi qytetar

Sipas gjetjeve të studimit, pjesëmarrësit në përgjithësi pranojnë se nuk janë shumë aktivë në komunitetet e tyre. Ata pohojnë se ndjenja e komunitetit në Shqipëri, veçanërisht brenda lagjeve të tyre, është e dobët, dhe se ndërgjegjësimi mbi aktivizmin qytetar është shumë i ulët. Pjesëmarrësit përmendin kufizimet kohore, standardet e ulëta

të jetesës, sensin e pakët të vullnetarizmit në të mirë të komunitetit dhe mungesën e lidhshmërisë si arsye parësore të mungesës së angazhimit të tyre qytetar në nivel personal. Nevoja për hapësira të përshtatshme për t'u mbledhur si dhe nevoja për udhëheqje dhe vullnet i qartë për të organizuar qytetarët ishin përgjigjet që dhanë kur u pyetën se çfarë do ta nxiste rritjen e angazhimit qytetar. Në përgjithësi, pjesëmarrësit shprehin mosbesim te organizatat jo-qeveritare (OJF-të) dhe/ose pohojnë se shoqëria civile nuk është e mirë-organizuar dhe se rezultatet e saj nuk janë mjaftueshëm të dukshme. I njëjti studim ishte realizuar edhe një vit më parë me fokus disa grupe, dhe në ndryshim nga ky studim i mëparshëm, disa pjesëmarrës pohojnë se aktivizimi në komunitet është rritur. Një numër i vogël pjesëmarrësish – të rinj e të moshuar- shprehin se ata vetë janë përfshirë në nisma komunitare dhe të tjerë përmendin projekte ku do të donin të angazhoheshin, projekte të cilat kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën e lagjeve apo çështjet e pastërtisë së mjedisit (NDI, 2014: 9). Në përgjithësi, pjesëmarrësit shprehin mosbesim te organizatat e shoqërisë civile dhe shumica e tyre pohojnë se njohin shumë pak, në mos asnjë, grupe të shoqërisë civile aktive në komunitetet e tyre. Ndër ata që kanë njohuri për praninë e këtyre organizatave, disa dyshojnë në pavarësinë e këtyre grupeve. Shoqëria civile nuk është e mirë-organizuar dhe rezultatet e tyre nuk janë mjaftueshëm të dukshme për shumicën e pjesëmarrësve. Një numër i vogël pjesëmarrësish, kryesisht në Fier dhe Korçë më shumë se në vendet e tjera, mund të përmendnin shembuj të organizatave të shoqërisë civile të pranishme në komunitetet e tyre. Ndër to, disa nga pjesëmarrësit përmendin organizata që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; çështjet e varfërisë, sidomos ato që kanë të bëjnë me komunitetin Rom, mjedisin dhe dhunën në familje, disa të tjerë përmendën grupe fetare që janë aktive në vend (NDI, 2014: 9).


4.5.3 Qëndrimet publike të shqiptarëve ndaj proceseve politike

Duke pasur parasysh se angazhimi i qytetarëve në proceset demokratike është një tregues i shëndetit të demokracisë, në periudhën 8-26 shkurt 2016, Instituti për Drejtësi dhe Ndërmjetësim zhvilloi një studim në lidhje me angazhimin politik të qytetarëve, i cili “mat pulsën e angazhimit politik të pjesëmarrësve në studim dhe ofron një bazë të dhënash unike në Shqipëri në lidhje me politikën dhe angazhimin e qytetarëve në procese politike”. Sondazhi synonte të eksplorojë qëndrimet publike ndaj një sërë treguesish të angazhimit politik që vënë në dukje njohuritë dhe interesin e pjesëmarrësve për sistemin politik; nivelin e veprimit publik dhe të pjesëmarrjes në procese politike; kuptimin e efikasitetit dhe kënaqësisë nga institucionet dhe proceset politike (Duci dhe Dhembo, 2016: 7).

Njohuritë

Përveç ‘testimit’ të njohurive reale pjesëmarrësit në studim u ftuan të raportonin se sa besonin se dinin rreth çështjeve specifike, ndër të cilat: rolin e deputetëve, rolin e Presidentit, qeverisë, parlamentit, politikës dhe qeverisjes vendore (Grafiku 14). Për sa i përket politikës dhe qeverisjes vendore pjesëmarrësit u ndanë barabar mes atyre që raportonin se kishin “shumë” ose “mjaftueshëm” njohuri dhe atyre që kishin “pak” ose “aspak”. Sipas përgjigjeve të pjesëmarrësve në studim, 1 në 2 pjesëmarrës deklaronte se kishin “pak” ose “aspak” njohuri për Parlamentin, 2 nga 3 pjesëmarrës raportojnë se kanë “pak” apo “aspak” njohuri për rolin e deputetëve dhe rolin e Presidentit (Grafiku 2). Burrat, pjesëmarrësit më të moshuar dhe ata me arsim të lartë besonin se dinin më shumë krahasuar me të tjerët (Duci dhe Dhembo, 2016: 15).

Grafiku 14: Njohuritë mbi çështje të ndryshme




Burimi: Duci dhe Dhembo, IDM, 2016: 16

Pjesëmarrja

Studiuesit pohojnë se shumica e pjesëmarrësve të sondazhit nuk ishin as anëtarë të ndonjë partie politike (75.4%) as të OJF/shoqatave (89.4%) (Grafiku 15). Pjesëmarrësit që vinin nga zonat rurale kishin më pak mundësi për të qenë anëtarë të një OJF/shoqate (33.6%) sesa ata të zonave urbane (66.4%). Megjithatë, kur ishte fjala për anëtarësimin në parti politike raporti ishte më i vogël (48% rurale përkundrejt 52% në zona urbane). Duket se organizatat e shoqërisë civile janë më të pranishme në zonat urbane, por prania e tyre në zonat rurale është po aq e rëndësishme. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh faktin se ligji për OJF lejon shoqatat që të kenë anëtarësi dhe të funksionojnë vetëm me të, përqindja e pjesëmarrësve që raportuan të jenë anëtarë të një OJF/shoqate mund të

konsiderohet e lartë. Studimet tregojnë se niveli vendor dhe rajonal kanë një tërheqje më të madhe për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, krahasuar me nivele më të larta (Duci dhe Dhembo, 2016: 19).

Grafiku 15: Anëtarësimi në një parti politike ose OJF/shoqatë




Burimi: Duci dhe Dhembo, IDM, 2016: 19.

Disa nga arsyet për këtë janë afërsia, marrëdhëniet më të lehta për t'u kuptuar dhe ndikimi potencialisht më i madh i qytetarëve në vendimmarrje. 51.6% e pjesëmarrësive të këtij studimi ishin më të gatshëm për t'u angazhuar në nivel vendor dhe më pak në nivel kombëtar 33% (Grafiku 16). Sipas të dhënave të anketimit, pjesëmarrësit e rinj me arsim të lartë kishin më pak mundësi të përfshiheshin në nivel vendor. Anëtarët e OJF/shoqatave kishin më shumë dëshirë të përfshiheshin në nivel vendor sesa pjesëmarrësit e tjerë të studimit. Ata me më pak mundësi për t' u përfshirë në nivel kombëtar vinin nga zonat rurale, me arsim të ulët dhe jo të punësuar në sektorin publik.

Dëshira dhe vullneti për t'u përfshirë në çështje publike dhe në vendimmarrje është një hap i parë i rëndësishëm drejt angazhimit politik. Pjesëmarrësit në studim në përgjithësi hezitojnë të marrin pjesë në vendimmarrje, ndihen sikur ata nuk kanë zërin e tyre në këtë proces, sikurse u tha gjatë diskutimeve në fokus grupe (Duci dhe Dhembo, 2016: 21).

Gjithashtu, autorët theksojnë se në studim u morën në shqyrtim edhe prirjet në mënyrat formale dhe informale të pjesëmarrjes si dhe ndryshimi mes nismave që pjesëmarrësit kanë ndërmarrë dhe atyre që do ishin të gatshëm të ndërmerrnin, nëse atyre u interesonte shumë një çështje. Veprimi më i shpeshtë i pjesëmarrësve gjatë 12 muajve të fundit rezulton të jetë diskutimi për politikën ose për një çështje specifike me njerëz të tjerë, 74.5% të përgjigjeve që e pohojnë. Kontaktimi i një anëtarit të këshillit bashkiak ose punonjësit të zyrave vendore ishte veprimi i dytë më i shpeshtë, me 35.7% të anketuesve, pas tij vinte vullnetarizmi për një aktivitet në komunitetin vendor me 32%. Në përgjithësi, burrat prireshin të ndërmerrnin më shumë nisma se gratë së bashku me pjesëmarrësit e zonave urbane. Grafiku tregon qartë se 10.9% të pjesëmarrësve raportuan se nuk kanë ndërmarrë asnjë nismë; edhe pse kjo është një përqindje e ulët, në fakt duke marrë parasysh se ka shumë nisma të renditura në pyetje (p.sh. shumë njerëz mundën që thjesht të diskutojnë për politikën ose një çështje që i intereson me njerëz të tjerë) mund të mendohet si e lartë (Duci dhe Dhembo, 2016: 20).

Grafiku 16: Sa e përshkruajnë qëndrimin tuaj pohimet më poshtë?




Burimi: Duci dhe Dhembo, IDM, 2016: 21.

Efikasiteti dhe kënaqësia

Pjesa e fundit e këtij studimi të IDM-së lidhej me treguesit që synojnë të masin kënaqësinë e pjesëmarrësve me punën e qeverisë, Parlamentit dhe opozitës aktuale. Autorët raportojnë se më shumë se 1 nga 2 pjesëmarrësit janë të pakënaqur nga puna e parlamentit aktual (57.5%) dhe të qeverisë (56.8%); 2 nga 3 pjesëmarrësit nuk janë të kënaqur nga puna e opozitës aktuale (69.3%) (Grafiku 17). Të dhënat tregojnë se pjesëmarrësit ndjejnë se si qeveria ashtu dhe parlamenti nuk përfaqësojnë ose u shërbejnë mirë qytetarëve, ndërsa është akoma më evident në rastin e vlerësimit të rolit të opozitës. Sipas autorëve, diskutimet në fokus grupe shtojnë vlerë në shpjegimin e këtyre përqindjeve, pasi shpeshherë në to thuhej se qeveria nuk punon ndërsa opozita është pasive, kurse kryqëzimet e të dhënave tregojnë se pjesëmarrësit më të kënaqur

kishin edhe më shumë njohuri dhe më shumë interes për politikën (Duci dhe Dhembo, 2016: 30).

Grafiku 17: Sa të kënaqur jeni me punën aktuale të..




Burimi: IDM, 2016: 21.

Perceptimet mbi Parlamentin

Në fund të studimit, një seksion i rezervohet perceptimeve në lidhje me Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur (Grafiku 18). Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (53.2%) mendonin se Parlamenti është i rëndësishëm për demokracinë tonë, duke shënuar kështu një tregues pozitiv. Pjesëmarrësit kryesisht nuk ishin dakord (në mënyrë të moderuar ose fuqishëm) me disa prej pohimeve për funksionet kyçe të Parlamentit, për shembull 42% e përgjigje-dhënësve nuk ishin dakord kur u pyetën nëse Parlamenti shqiptar e vendos qeverinë para përgjegjësisë; po kështu, 45% e tyre, në të njëjtën linjë, nuk ishin

dakord me faktin se Parlamenti shqiptar inkurajon pjesëmarrjen e publikut ose që debaton dhe merr vendime për çështje të rëndësishme për ta (47.5% kjo e fundit). Po ashtu, 1 në 2 pjesëmarrës, pra 50% e të intervistuarve të sondazhit nuk ishin dakord me pohimin se Parlamenti është i hapur ndaj qytetarëve për të marrë pjesë në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare. Autorët theksojnë se pjesëmarrësit bënin një dallim të qartë mes pohimeve të mësipërme duke evidentuar funksionet e Parlamentit dhe ato që lidhen me përbërjen e tij. Pyetjes nëse Parlamenti shqiptar përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të shoqërisë që punojnë në një mënyrë etike, 2 nga 3 pjesëmarrësit (65.4%) nuk ju përgjigjën pozitivisht. Në të njëjtën mënyrë, thuajse 60% e tyre nuk ishin dakord me pohimin se Parlamenti përfaqëson në mënyrë të drejtë të gjitha grupet e shoqërisë (duke përfshirë gratë, minoritetet dhe grupe të tjera vulnerable). Gratë pak më shumë se burrat nuk ishin dakord me këtë pohim (Duci dhe Dhembo, 2016: 32-33). Rritja e nivelit të transparencës është e një rëndësie thelbësore jo vetëm për të ruajtur integritetin në parlament, por edhe për përmirësimin e qeverisjes. Parlamenti i hapur dhe transparent mund të përmirësojë shërbimet publike dhe të ulë rrezikun e mashtrimit, korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike (OECD, 2015, cituar në Duci dhe Dhembo, 2016: 32). Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (56%) deklarojnë se Parlamenti nuk është transparent në mënyrën se si është i organizuar dhe se si funksionon. Egziston një lidhje mes perceptimeve për Parlamentin dhe kënaqësisë me punën e tij, perceptimet pozitive lidhen me një kënaqësi më të madhe dhe ato negative me kënaqësi më të madhe nga puna e opozitës (Duci dhe Dhembo, 2016: 33).

Grafiku 18. Perceptimi për funksionet dhe përbërjen e parlamentit shqiptar



Burimi: IDM, 2016: 33

4.6 Partitë politike dhe shoqëria civile

Partitë politike janë shfaqur si rezultat i nevojës për të shprehur në mënyrë të organizuar konfliktet shoqërore dhe politike. Ato kanë pasur gjithmonë natyrën e një organizate shoqërore, qysh nga origjina e tyre në shekullin e XIX-të, kur organizatat liberale, konservative, rurale dhe sociale demokrate u përpoqën që të riafirmojnë pozitat e tyre

dhe përmes organizimit të partive. Nisur nga origjina e tyre por edhe nga orientimi i tyre parlamentar dhe dëshira për të arritur në zyrat publike, partitë politike pozicionohen mes shoqërisë civile, parlamentit dhe qeverisë (Hofmeister dhe Grabow: 67).

Partitë dhe organizatat e shoqërisë civile

Sipas Hofmeister dhe Grabow, partitë politike mund të konsiderohen si organizata politike të shoqërisë civile të cilat mbrojnë interesin e një grupi të veçantë (apo disa grupeve), i artikulojnë dhe përfaqësojnë ata. Ato e kryejnë këtë funksion duke i paraqitur këto interesa tek përfaqësuesit dhe institucionet formale të politikës përmes pjesëmarrjes në zgjedhje demokratike. Partitë zakonisht themelohen në dy mënyra, së pari, nga elita shoqërore që mbledhin për rreth tyre një grup të përkrahësve me ndikim që të mbrojnë pozitat e tyre; së dyti me qytetarë që kërkojnë mbështetjen e personave me mendim të njëjtë në mënyrë që të arrijnë një ndryshim politik apo shoqëror (Hofmeister dhe Grabow: 68).

Këto organizime e këto mënyra të krijimit të partive politike nuk u shfaqën vetëm në Europën Perëndimore, por edhe në atë Lindore në fund të shekullit XIX-të. Autorët përmendin lëvizjet reformuese në ish-vendet komuniste të Europës Lindore, si “Karta 77” në Çekosllovakë, “Solidarnosc”; lëvizjet për sindikatën dhe reformat shoqërore në Poloni, apo lëvizja demokratike e qytetarëve në ish-Gjermaninë Lindore, të tilla si “Iniciativa për paqe dhe të drejta të njeriut”, “Forumi i ri” dhe “Nisma demokratike”, të cilat kanë dalë nga shoqëritë civile dhe më vonë janë kthyer në parti politike apo u janë bashkuar partive politike ekzistuese. Duke filluar nga viti 1990, kritikën e përgjithshme mbi partitë politike nga aktivistët socialistë por edhe nga shkencëtarët shoqërorë u rritën në mënyrë të ndjeshme, duke nisur kështu një debat intensiv ndërkombëtar mbi

konceptin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. Në kuadër të këtij debati, zgjerimi i pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë dukej një zgjidhje e domosdoshme për të gjitha masat për të zëvendësuar të gjitha parimet e papërcaktuara të përfaqësimit. Organizatat e shoqërisë civile si iniciativat qytetare apo “lëvizjet e reja shoqërore” (paqësore, të grave, mjedisore) u shndërruan në sfidë për partitë nisur nga vështirësitë dhe pamundësitë e tyre që të zgjidhnin problemet ekzistuese dhe për shkak të demobilizimit të anëtarëve të tyre (Hofmeister dhe Grabow: 68).

Shpesh këto lëvizje janë quajtur “lëvizje për një çështje të vetme” dhe numri i tyre është rritur ndjeshëm në dy dekadat e fundit. Në disa vende partitë e reja politike janë krijuar duke u përqëndruar vetëm në një apo disa çështje të caktuara (partitë kundër imigracionit, “partitë e internetit” etj). Në raste të tjera, partive politike tradicionale u është dashur të bëjnë pjesë të programeve të tyre e të integrojnë çështjet e reja, si mbrojtja e mjedisit, energjia alternative, zhvillimi i qëndrueshëm etj. Nga ana tjetër, disa nga lëvizjet e reja të shoqërisë kanë marrë përsipër funksionet që tradicionalisht u përkisnin partive, kryesisht funksione që kanë të bëjnë me artikullimin dhe përfaqësimin e interesave shoqërore. Sidoqoftë, vitet e fundit ka pasur shenja të zhgënjimit të organizatave të shoqërisë civile në lidhje me mundësitë dhe kapacitetet e tyre dhe rritjen e pëlqimit për nevojën e arritjes së një balance të arsyeshme në mes të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes. (Hofmeister dhe Grabow: 69). Demokracia masive ka treguar se mund të funksionojë vetëm nëse adaptohen forma të demokracisë përfaqësuese dhe partitë në fund të fundit janë të vetmet institucione që legjitimohen me pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e përgjithshme, duke qenë se organizatat e shoqërisë civile zakonisht nuk janë në gjendje të dëshmojnë përfaqësimin e tyre të drejtë. Kjo për disa arsye: përgjithësisht ju mungojnë strukturat, proceset, përvojat dhe gjithashtu

personeli i nevojshëm për të ushtruar funksionet klasike të partive politike, siç janë legjitimiteti, përzgjedhja e kandidatëve dhe sidomos qeverisja demokratike (Hofmeister dhe Grabow: 70).

Organizatave të shoqërisë civile japin një kontribut të çmuar për proceset politike dhe stabilizimin e demokracisë, por pavarësisht kësaj, ato sigurisht nuk mund të zëvendësojnë partitë politike dhe nuk mund të përmbushin funksionin kryesor të këtyre të fundit, pjesëmarrjen në zgjedhje. Rritja e numrit dhe e rëndësisë së tyre në të gjithë botën, dëshmon për dëshirën që kanë qytetarët për të marrë pjesë në politikëbërje apo vendimarrje, por edhe në fushën e organizatave të shoqërisë civile janë vënë re tendenca të ngjashme si ato të partive politike: janë dobësuar institucione tradicionalisht të fuqishme, siç janë; sindikatat e punës në ditët e sotme, numri i madh i organizatave nuk shoqërohet po ashtu me ndikim po aq të madh, por dëshmon për ndarjen së tyre. Pavarësisht fuqisë së tyre për të mobilizuar masa të mëdha popullore, përfaqësimi i organizatave të shoqërisë civile mbetet i paqartë dhe organizatat shoqërore mund të dëshmojnë mbështetjen e tyre të vërtetë brenda shoqërisë vetëm nëse transformohen në parti politike (Hofmeister dhe Grabow: 69).

Grupet e interesit

Grupet e interesit janë një formë e veçantë e organizimit të shoqërisë civile, që organizojnë dhe artikulojnë interesat shoqërore të qytetarëve, grupeve shoqërore apo organizatave të tjera shoqërore siç janë: shoqatat e bizneseve apo sindikatat (Hofmeister dhe Grabow: 70). Ato kryejnë funksione të ngjashme me partitë politike, por fokusi i tyre shtrihet në një sektor të veçantë, përkundër përfaqësimit të përgjithësuar politik dhe territorial të partive. Grupet e interesit kanë vetitë e tyre të veçanta organizative dhe funksionale si dhe modele të veçanta të marrëdhënieve me aktorët e tjerë të sferës

politike, institucioneve shtetërore, medias dhe partive politike. Grupet e interesit nuk janë homogjene. Ato ndryshojnë jo vetëm sipas fushës së interesit por gjithashtu edhe nga madhësia, struktura, baza e fuqisë, ndikimi i mundshëm, strategjitë e tyre etj. Njëkohësisht ato vetë sillen si aktorë në procesin e politikëbërjes të partive të tjera dhe duke ushtruar funksione të ndryshme, partitë dhe shoqatat, në një mënyrë të caktuar, i nënshtrohen kushteve të përbashkëta të veprimeve (Hofmeister dhe Grabow: 71-72). Roli që një parti ka në sistemin politik është i rëndësishëm për marrëdhëniet mes shoqatave dhe partive politike. Autorët theksojnë se mes partive dhe grupeve të interesit ekziston një marrëdhënie e varësisë reciproke. Nga njëra anë, grupet e interesit dhe shoqatat kanë nevojë të kenë akses tek partitë në mënyrë që të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë në procesin e politikëbërjes, ndërkohë që partitë përkrahen prej tyre gjatë zgjedhjeve. (Hofmeister dhe Grabow: 71-72).

Ndonëse grupet e interesit kryejnë disa nga funksionet e partive, Hofmeister dhe Grabow dallojnë tre karakteristikat kryesore të tyre që i bëjnë të ndryshme nga partitë politike (71).

- Ato nuk e përfshijnë veten në gara politike për ulëse në parlament.
- Misionet, objektivat, programet, aktivitetet dhe fushat e tyre të interesit janë zakonisht të kufizuara në çështje të veçanta apo brenga të grupeve të veçanta shoqërore, përderisa partitë në përgjithësi synojnë për një qëllim më të përgjithshëm dhe funksionet e përfaqësimit dhe integritit të grupeve të ndryshme shoqërore.
- Ato janë më të lidhura me ato grupe të cilave i`a përfaqësojnë interesat. Për shembull, organizatat afariste janë të udhëzuara nga interesat e korporatave anëtare si dhe përfaqësuesit e tyre; sindikatat përfaqësojnë interesat e punëtorëve përpara veprimeve të

tyre të cilat kryesisht kanë të bëjnë me fushat e negociatave për pagat dhe kushtet e punës; ndërsa organizatat e tjera fokusohen në çështjet shoqërore dhe kulturore apo në çështjet mjedisore, siç janë shoqatat për mirëqenie të cilat fokusohen në ofrimin e shërbimeve shoqërore.

V. PËRFUNDIME

Kapitali social mund të kontribuojë për një sërë benefitesh të dobishme ekonomike dhe sociale, duke filluar që nga nivelet e larta të rritjes në PBB; tregjet e punës më funksionale; arritjet më të larta arsimore; nivelet më të ulëta të krimit; shëndetësia më e mirë; dhe institucionet më efektive të qeverisë. Larmishmëria e kuptimeve dhe mungesa e një përkufizimi universal, siç ndodh rëndom me konceptet në shkencat sociale, e ka bërë më të vështirë matjen sasiore të tij si fenomen apo përpunimin e metodave të matjes, por duhet thënë se veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit, rëndësia që po i kushtohet kapitalit social si faktor shpjegues është rritur. Koncepti është debatuar për vite të tëra, dhe interesi akademik në lidhje me të ka ardhur duke u shtuar. Pavarësisht se secili autor e përkufizon sipas perceptimeve dhe objektivave të disiplinës së cilës i përket, konsensusi i përgjithshëm është ai që thekson rolin e besimit, rrjeteve sociale të angazhimit dhe normave të reciprocitetit. Ai e përmirëson performancën qeverisëse në disa aspekte.

Së pari, duke i bërë qytetarët konsumatorë të sofistikuar të politikës. Kjo supozon se politikanët dëshirojnë të kënaqin votuesit (pasi kjo rrit gjasat e tyre për rizgjedhje) dhe se votuesit dinë të njohin dhe të ndëshkojnë performancën e dobët. Teza bazohet në konstatimin që pjesëmarrja nëpër shoqata komunitare rrit vetëdijen politike, duke siguruar mundësinë për të diskutuar mbi çështjet, ndaj kapitali social është në gjendje të rrisë aftësinë e publikut për të monitoruar. Për më tepër, për shkak të rritjes së nivelit të besimit në shoqëritë me kapital të lartë social, “votuesit mund të kapërcejnë më lehtë problemin e veprimit kolektiv të monitorimit të zyrtarëve”. Të dy elementet kërkojnë që qytetarët të bëhen më aktive dhe efektive në kërkimin e një qeverisjeje të mirë. Kjo rrit përpjekjet e zyrtarëve dhe të çon në performancë më të mirë. Megjithatë, që kjo të

arrihet, popullsia duhet të ketë preferenca homogjene. Në rast të kundërt, kërkesat kontradiktore mund të ulin performancën.

Së dyti, kapitali social kontribuon në një shoqëri që karakterizohet nga shprehitë e bashkëpunimit, solidaritetit dhe gjallëria publike mes njerëzve. Kjo gjeneron një angazhim brenda individëve për ta bërë shoqërinë të funksionojë dhe rrit gadishmërinë e tyre për të bërë kompromiset e nevojshme. Këtu mund të dallohen tre aspekte:

1- Atëherë kur qytetarët presin që të tjerët të veprojnë në përputhje me rregullat, ulen shpenzimet e qeverisë për detyrimin e zbatimit të pajtueshmërisë. Këto burime që kursehen në këtë rast, mund të përdoren për qëllime më produktive, në mënyrë që performanca të zgjerohet.

2- Lehtësimi i bashkëpunimit midis politikanëve dhe burokratëve zvogëlon mundësinë e bllokimeve në vendimmarrje dhe për këtë arsye mund të ndikojë në rritjen e cilësisë së qeverisjes.

3- Së fundi, kapitali social mund të ndryshojë natyrën e preferencave të njerëzve nga egoiste në altruiste . Prandaj, qytetarët në shoqëritë me kapital të lartë social mund të jenë më të interesuar për "të mirën e përbashkët", për të ndihmuar avancimin e njëritjetrit në vend që të përfitojnë në kurriz të të tjerëve. Kjo duhet të rrisë cilësinë e performancës së qeverisë nga pikëpamja e shoqërisë si një e tërë.

Rëndësia e kapitalit social në jetën politike të një vendi tashmë është dokumentuar mirë, falë një sërë studimesh empirike. Kapitali social ka trgeuar se stimulon pjesëmarrjen politike, angazhimin qytetar dhe qeverisjen e komunitetit. Lidhjet me miqtë dhe kolegët dhe organizatat e ndërlidhura të shoqërisë civile janë blloqe të rëndësishme të ndërtimit të angazhimit demokratik. Të paktën po aq të rëndësishme si mjetet e komunikimit

masiv, që ofrojnë mekanizma për të artikuluar dhe për të diskutuar ankesat individuale, për të zhvilluar interesin e përbashkët, formuar opinionet politike dhe mobilizuar angazhimin politik kolektiv. Përveç kësaj, komunitetet me nivel më të lartë të kapitalit social janë të lidhur me nivele më të ulëta të krimit të dhunshëm dhe me një perceptim të zgjeruar të sigurisë personale.

Nga pikëpamja e projektimit të politikave, ofrimi i të mirave publike nga organizatat e komunitetit dhe jo nga mekanizmat private të tregut ose ndërhyrjet e politikës nga lart-poshtë, gjithashtu mund të shërbejë si një urë ideologjike për të mobilizuar mbështetjen. Kjo ndihmon për të kapërcyer atë që është paraqitur shpesh si një dikotomi e ngurtë e shtetit kundrejt tregut, si të vetmet mekanizma të mundshme për organizimin e çështjeve sociale dhe ekonomisë.

Epoka komuniste ka një rëndësi të konsiderueshme kur bëhet fjalë për modernizimin e vendeve të Europës Lindore. Ajo përfaqëson një prerje të thellë në zhvillimin social, ekonomik dhe politik dhe një ndërprerje të dinamikës së supozuar të modernizimit. Kapitali social është një term relativisht i panjohur në studimet dhe kërkimet e kryera në Evropën Qendrore dhe Lindore. Interesi për këtë temë ka lindur kryesisht nga aktivitetet e agjensive të zhvillimit, të tilla si Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara edhe programet e Bankës Botërore. Komunizmi shkatërroi atë që autorët e quajnë "kapital normal social" dhe kur regjime të tilla rrëzohen, kapitali social në dispozicion duhet të transformohet nga një formë negative që mund të parandalojë zhvillimin ekonomik në një formë pozitive që inkurajon zhvillimin dhe mirëqenien. Disa autorë argumentojnë se socializmi i rrënoi rrjetet vullnetare sociale dhe ka krijuar një mjedis shoqëror steril. Nga ana tjetër, autorë të tjerë argumentojnë se rrjetet joformale, kishin dhe, pavarësisht transformimeve, ende kanë një rol domethënës (për shembull, studimi mbi lidhjet e

"favoreve" nga Ledeneva, 1998) dhe kështu mund të konsiderohet si kapital social në dispozicion (Marsh, 2000). Megjithatë, sipas Rose, rrjetet që "rishpërndajnë (ose keqshpërndajnë) mallrat dhe shërbimet nuk e rrisin produktin kombëtar në tërësi." Në kushtet kur pjesëmarrja në jetën publike është diçka e detyruar dhe thjesht rituale si në komunizëm (Raiser et al., 2002), dhe kur çdo njeri mund të jetë një informator i mundshëm (Voicu, 2005), gjasat janë që niveli i besimit të jetë i ulët, pasi njerëzit natyrshëm preferojnë të jenë shumë të kujdesshëm e të mendohen mirë kur kanë të bëjnë me të tjerët. Frika e përhapur dhe mosbesimi që shkaktoi sistemi socialist, bashkë me shkatërrimin e organizatave vullnetare, mund të jetë një shpjegim për nivelin e ulët të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në Europën Qëndrore dhe Lindore krahasuar me nivelet e kapitalit fizik dhe njerëzor. Në përfundim, studiuesit supozojnë se disa dekada mund të jenë të mjaftueshme për ndërtimin e kapitalit social pozitiv dhe se ndërhyrjet aktive në proces duhet të shmangen. Në vend të kësaj, qeveritë duhet të ofrojnë mbështetje që mund të krijojë një "ambient të përshtatshëm për prodhimin e kapitalit social dhe luftimin e kapitalit social negativ". Niveli i pritshëm i kapitalit social që egziston brenda vendeve të Europës Qëndrore dhe Lindore është i ulët. Kapitali social shihet si një entitet dinamik, një formë e ndryshimeve institucionale që sjell risi në qeverisje. Kështu, kapitali social ofron një mjet të fuqishëm për shpjegimin e proceseve e ndryshimeve institucionale. Në Evropën Qëndrore dhe Lindore (EQL), proceset e ndryshimeve institucionale kanë ardhur si rezultat i goditjeve të jashtme, të imponuara nga regjimet politike dhe ndryshimet e papritura të regjimit gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit. Rrjetet sociale dhe përdorimi i këtyre rrjeteve (dhe i kapitalit social) po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme nën qëllimin e anëtarësimit në BE, veçanërisht kur mundësitë brenda vendit dhe aksesit tek programet e zhvillimit rural dhe rajonal janë të

varura nga rrjetet ekzistuese. Duke pasur parasysh se modelet e shoqërisë dhe rrjeteve ndërpersonale dhe sociale kanë qenë të ndikuar nga ndryshimi i regjimeve politike në EQL, roli i kapitalit social si një faktor shpjegues për sjelljen ekonomike dhe sociale është i ndryshëm nga vendet e tjera që nuk kanë përjetuar një fazë socialiste, me planifikimin e tij qendror dhe kontrollin mbi strukturat sociale. Në varësi të ngurtësisë së sistemit socialist, proceset e modernizimit, qoftë ai strukturor apo kulturor, kanë qenë pak a shumë të vonuara, gjë që për më tepër ende ndikon shanset bashkëkohore për demokratizim. Sa më pak i modernizuar të ketë qenë një vend para socializmit, aq më i ngurtë ka qenë regjimi socialist dhe aq më të mëdha janë bllokimet aktuale me të cilat përballlet demokratizimi i suksesshëm. Për t'ju përgjigjur pyetjes sesi mund të përshpejtohet procesi i transformimit drejt demokracive të konsoliduara, është e nevojshme të kuptohen shtigjet dhe parakushtet historike. Sado të sofistikuar të jenë strukturat institucionale, është shumë e vështirë që t'i përmbushin premtimet e tyre, nëse vetë institucionet e themeluara dhe vetë shteti nuk jep fillimisht prova për efikasitetin e tij.

Për një transformim të suksesshëm nuk është i nevojshëm vetëm efikasiteti i institucioneve. Është gjithashtu e nevojshme që shteti i ri dhe mbajtësi i pushtetit të ketë legjitimitetin e nevojshëm brenda shoqërisë. Në këtë mënyrë, legjitimiteti është përbërësi që ndërlidh elementet strukturore dhe kulturore dhe kapitali social mund të përdoret për të kuptuar këtë lidhje. Kapitali social mat normat e veprimit shoqëror. Këto norma dhe vlera mund të jenë mbështetëse të demokracisë në formën e kapitalit social lidhës ose penguese në formën e kapitalit social detyrues. Ideja qendrore është se struktura dhe kapitali social duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. Vetëm në këto kushte, rregullat formale të një sistemi demokratik nuk do të dëmtohen nga rregullat

kontradiktore informale, do të jetë më i lehtë zbatimi i procedurave demokratike dhe sistemi politik do të vazhdojnë të rezistojë edhe në situata krize.

Siç e konfirmojnë studimet e fundit të kryera në Shqipëri, politika dhe proceset politike janë një aktivitet për vetëm gjysmën e pjesëmarrësve, po kështu edhe interesi në përgjithësi për këto çështje. Ndërkohë që pjesëmarrësit kanë treguar se kanë mjaftueshëm njohuri për politikën në përgjithësi në Shqipëri, shpeshherë njohuritë e thelluara për institucionet dhe proceset politike perceptohen si të pamjaftueshme. Qytetarët qëndrojnë të interesuar dhe gati për t'u përfshirë dhe për të vepruar në lidhje me çështje që ndikojnë mbi ata vetë, familjet e tyre dhe komunitetet. Nisur nga niveli i besimit politik përgjithësisht i ulët, ata shprehen qartë se duan që t'i dëgjohet zëri për një përfshirje më kuptimplotë, veçanërisht në nivel vendor. Është inkurajues për shembull, fakti që rezultoi nga sondazhi i fundit i IDM-së, sipas të cilit gjysma e pjesëmarrësve do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në aktivitete të organizuara nga qytetarët ose grupe të shoqërisë civile, për të ushtruar presion. Megjithatë, shoqëria civile duhet të jetë më efektive në rolin e saj për të arritur deri tek qytetarët, për të kuptuar më mirë nevojat e tyre duke i ofruar platforma konkrete për diskutim. Perceptimet e efikasitetit dhe pushtetit variojnë sipas niveleve vendore dhe kombëtare. Qytetarët shqiptarë ndihen më të pashpresë në nivel kombëtar, gjë që dëshmon se institucionet qendrore perceptohen si më të distancuara nga populli. Megjithatë, nëse shohim pikturën e plotë, kuadri nuk është pozitiv, duke qenë se ata raportojnë se ndihen të pashpresë edhe në nivel vendor, gjë që na bën të kuptojmë se ka ardhur koha të merren masa serioze dhe të veprohet në mënyrë aktive.

BIBLIOGRAFIA

1. Adam, F., & Rončević, B. (2003). *Social Capital: Recent Debates and Research Trends*. *Social Science Information*, 42(2): 155-183, marrë nga 10.1177/0539018403042002001 (parë më 20/05/2016).
2. Adam, F., & Tomsic, M. (2000). Elite (re-)configuration and politico-economic performance in post-socialist countries. *Europe-Asia Studies* 54(3), 435–454.
3. Adler, P., & Kwon, S. (2000). Social capital: The good, the bad and the ugly. In E. Lesser (Ed.). *Knowledge and Social Capital: Foundations and Applications*, Butterworth-Heinemann.
4. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. *Baza ligjore për shoqërinë civile*, marrë nga http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/Baza_Ligjore_per_Shoqerine_Civile.pdf (parë më 20/05/2016).
5. Aguilera, M. (2002). The impact of social capital on labour force participation: evidence from the 2000 Social Capital Benchmark Survey. *Social Science Quarterly* 83(3), 853-74.
6. Alapuro, R. (2001). Reflections on social networks and collective action in Russia. In Stephen Webber and Ilkka Liikanen, *Education and Civic Culture in post-communist countries*, Basingstoke: Palgrave in Association with School of Slavonic and East European Studies, UCL, 13–27.
7. Almond, G. A., & Verba, S. (1980). *The Civic Culture Revisited*. Boston: Little, Brown.
8. Asheim, B. (1999). Interactive learning and localised knowledge in globalising learning economies. *GeoJournal* (49), 345–52.
9. Ashiku, M. (2014). Institutions, Economic Development and Social Capital in Albania. *Journal of Economics and Development Studies*, June 2014, 2 (2), 469-482.

10. Axelrod, R. (1984). *The Evolution of Cooperation*. New York: Basic Books.
11. Baby, A. (2005). *Pédagogie des poqués, Sainte-Foy*. Presses de l'Université du Québec.
12. Bădescu, G. (2003). *Încredere și democrație în țările în tranziție [Trust and Democracy in Transition Countries]*, Sociologie Românească, I (1-2), 109-128.
13. Bădescu, Gabriel, Paul Sum, and Eric M. Uslaner. 2004. "Civil Society Development and Democratic Values in Romania and Moldova," *Eastern European Politics and Society*, 18:316-341.
14. Banfield, Edward. 1958. *The Moral Basis of a Backward Society*. New York: Free Press. Barry, B. (1970). *Sociologists, Economists, & Democracy*. Chicago: University of Chicago Press.
15. Baylis, Th. A. (1989). *Governing By Committee: Collegial Leadership in Advanced Societies*. Albany: State University of New York Press.
16. Becker, G.S. (1964). *Human capital: a theoretical and empirical analysis, with special reference to education*. New York: NBER and Columbia University Press.
17. Beugelsdijk, S. , & Van Schaiik, T. (2005). Social capital and growth in European regions: an Empirical test. *European Journal of Political Economy* 21, 301-324.
18. Billiet, J., & Cambre', B. (1999). Social capital, active membership in voluntary associations and some aspects of political participation. An empirical case study. In J. W. Van Deth, M. Maraffi, K. Newton, & P. F. Whiteley (Eds.), *Social capital and European democracy*. London/New York: Routledge, 240–262.
19. Boix, C., & Posner, D. N. (1998). Social capital: Explaining its origins and effects on government performance. *British Journal of Political Science*, 28, 686–693.
20. Bourdieu, P. (1980). Le capital social. *Actes de la recherche en sciences sociales* 31(31), 2-3, marrë nga

http://www.persee.fr/web/revues/home/prescript/article/arss_03355322_1980_num_31_1_2069 (parë më 20.05.2016).

21. Bourdieu, P. (1986). The Forms of Capital. In Richardson, J. G. *Handbook of Theory and Research for the Sociology of Education*, New York: Greenwood Press, 241-258.
22. Bourdieu, P., Chamboredon, J. C., & Passeron, J. C. (1983). *Le Métier de sociologue*. Préalables épistémologique, Paris, Éditions Mouton.
23. BOURDIEU, P. (1992). *Les Règles de l'art*. Paris, Éditions du Seuil.
24. Brown, G., & Harris, T. (1998). *Social origins of depression*. Tavistock.
25. Buckowski, M. (1996). The shifting meaning of civil and civic society in Poland. In Hann, C., & Dunn, E., *Civil society. Challenging Western models*, London: Routledge, 79–98.
26. Burt, R. (1992). *Structural Holes: The Social Structure of Competition*. Cambridge, MA: Harvard University Press.
27. Burt, R.S. (2001). Structural holes versus network closure as social capital. In Lin, N., Cook, K., & Burt, R.S. *Social capital: theory and research*. New York: Aldine De Gruyter, 31-56.
28. Carpenter, J. P., Daniere, A. G., & Takahashi, L. M. (2004). Cooperation, Trust, and Social Capital in Southeast Asian Urban Slums. *Journal of Economic Behavior & Organization* 55(4), 533-551.
29. Casey, T. (2004). Social capital and regional economies in Britain. *Political Studies* 52, 96–117.
30. Cattaneo, C. (2008). *The Decision to Migrate and Social Capital: Evidence from Albania*. Fondazione Eni Enrico Mattei and University of Sussex.
31. Çela A., & Lleshaj, S. (2014). *Shqipëria dhe Modeli Social European. Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale*. Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung.
32. Çela, E., Ismaili, V., & Hafner-Ademi, T. (2008). *Praktikat e mira rajonale mbi pjesëmarrjen komunitare në qeverisjen vendore*. Tiranë: IDN.

33. Chen, X. (2001). Both glue and lubricant : transnational ethnic social capital as a source of Asia-Pacific subregionalism. *Policy Sciences*.
34. Citrin, J. (1974). The Political Relevance of Trust in Government. *American Political Science Review* 68, 973-988.
35. Coleman, J.S. (1988). Social capital in the creation of human capital. *American Journal of Sociology* 94, 95–120, marrë nga <http://www.jstor.org/stable/2780243> (parë më 06/05/2016).
36. Coleman, J.S. (1990). *The Foundations of Social Theory*. USA: Harvard University Press, Cambridge, MA.
37. Department for Environment, Food and Rural Affairs (DEFRA, 2013) ‘Sustainable Development Indicators (SDIs)’.
38. Dhembo, E. (2014). *Shqiptarët dhe Modeli Social European. Administrata publike në Shqipëri midis politikës dhe qytetarit*. Me mbështetjen e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung.
39. Duci, V., & Dhembo, E. (2016). *Analizë e Angazhimit Politik në Shqipëri*. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë: IDM.
40. Durkheim, É. (1997). *The Division of Labor in Society*. New York: Free Press.
41. ETC Graz. Demokracia, përfaqësimi dhe pjesëmarrja, marrë nga http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/democracy/demo.pdf (parë më 20/05/2016).
42. Farrell, H., & Knight, J. (2003). Trust, institutions, and institutional change: Industrial districts and the social capital hypothesis. *Politics & Society*, 31(4), 537-566.
43. Fernandez, R., Emilio, C., & Paul, M. (2000). Social Capital at Work: Networks and Employment at a Phone Center. *American Journal of Sociology*, 105(5), 1288-1356.
44. Field, J. (2003). *Social Capital*. NY: Routledge.

45. Flap, H. (1999b). *Creation and returns of social capital: a new research program*. La Revue Tocqueville, 20, 5-26.
46. Flap, H. (2002) No man is an island. In Lazega, E., & Favereau, O. *Conventions and Structures*, Oxford:University Press, 29-59.
47. Flap, H. (2004). Creation and returns of social capital. In Flap, H. & Volker, B. (eds.) *Creation and returns of Social Capital*, London: Routledge, 3-24.
48. Flap, H., & Volker, B. (2004). *Creation and returns of social capital*. London: Routledge.
49. Francois, P. (2003). *Social Capital and Economic Development*. London: Routledge.
50. Fukuyama, F. (1995). *Trust- The Social Virtues and the Creation of Prosperity*. Simon and Schuster, New York.
51. Fukuyama, F. (1999). *The Great Disruption*. Simon and Schuster, New York.
52. Gabre-Madhin, E.Z. (2001). *Market Institutions, Transaction Costs, and Social Capital in the Ethiopian Grain Market*. Research paper No. 124. International Food Policy Research Institute, Washington, DC.
53. Gambetta, D. (1988). *Trust: making and breaking cooperative relations*. Oxford: Blackwell.
54. Gabriel Badescu and Eric M. Uslaner, eds., *Social Capital and the Transition to Democracy*. London: Routledge. Giddens, A. (1990). *Consequences of modernity*. Cambridge: Polity Press.
55. Giordano, C., & Kostova, D. (2002). The social production of mistrust. In Hann, C., *Postsocialism. Ideals, ideologies and practices in Eurasia*, London: Routledge.
56. Gittel, R., & and Vidal, A. (1998). *Community Organizing: Building Social Capital as a Development Strategy*. Thousand Oaks, CA: Sage Publications.

57. Gjinari, J. (2012). Qeverisja e mirë dhe Shoqëria Civile. *Mirëqeverisja, Përmbledhjeve e eseve nga pjesëmarrës të Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike, 2011-2012*.
58. Goldberg, E. (1996). Thinking About How Democracy Works. *Politics and Society*, 24(1), 7-18.
59. Goldthorpe, J. H., Llewellyn, C., & Payne, C. (1987). *Social Mobility and Class Structure in Modern Britain*. Second edition, Clarendon Press: Oxford.
60. Granovetter, M. (1973). The Strength of Weak Ties. *American Journal of Sociology*, 78(6), 1360-1380, marrë nga <http://www.jstor.org/stable/2776392> (parë më 20/05/2016).
61. Granovetter, M., (1985). Economic Action and Social Structure: The Problem of Embeddedness. *American Journal of Sociology*, 91(2), 481–510.
62. Halpern, D. (2005). *Social Capital*. Cambridge: Polity Press.
63. Hanifan, L.J. (1920). *The community center*. Boston: Silver, Burdette & Co.
64. Howard, Marc.Morje. 2002 The Weakness of Civil Society in Post-Communist Europe. New York: Cambridge University Press
- Helliwell, J. F., & Putnam, R. (2004). The social context of well-being. *Philosophical transactions. Royal Society of London series B, Biological Sciences*, 1435-1446.
65. Helliwell, J.F. (2003). *How's life? Combining individual and national variables to explain subjective well-being*. *Economic Modelling*, 20 (2), 331-360.
66. Hennings, K.H. (1987). Capital as a factor of production. In Eatwell, J., Newman, P., & Ilgate, M. *The new Palgrave. A dictionary of economics*. London: MacMillan, 1, 327-333.
67. Hofmajster, W., & Grabow, K. *Partitë Politike*. Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë, Shkup: Instituti Pavel Shatev.
68. <http://www.worldbank.org/poverty/scapital/> (parë më 20/05/2016).

69. Ikeda, K., Yamada, Y., & Kohno, M. (2003). *Influence of Social Capital on Political Participation in Asian Cultural Context*. Taipei: Asian Barometer Project Office: National Taiwan University and Academia Sinica.
70. Inglehart, R. (1988). The Renaissance of Political Culture. *American Political Science Review*, 82(4), 1203-1230.
71. Inglehart, R. (1997). *Modernisation and postmodernisation: cultural, economic and political change in 43 societies*. Princeton: Princeton University Press.
72. Instituti Demokratik Amerikan. (2014). *Dialogu mes Qytetarëve dhe Politikanëve Kyç për Qeverisje të Mirë dhe Ekonomi më të Fortë. Gjetje nga hulumtimi përmes grupeve të fokusuara në Shqipëri*. Tiranë: NDI.
73. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2010). *Një axhendë veprimi për Shoqërinë Civile. Rruga drejt rritjes së ndikimit dhe angazhimit qytetar. Indeksi i Shoqërisë Civile*. Tiranë: IDN.
74. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. (2014). *Sondazh opinionesh ‘Besimi tek Qeveria’*. Tiranë: IDM.
75. Isham, J. (1999). *The Effect of Social Capital on Technology Adoption: Evidence from Rural Tanzania*. Middlebury College, Department of Economics, mimeo.
76. Kawachi I., Kennedy B.P., Lochner K., & Prothrow-Stith, D. (1997). Social capital, income inequality and mortality. *American Journal of Public Health*, 87(9).
77. Kawachi, I., & Berkman, L. (2000). Social Cohesion, Social Capital and Health. In Berkman, L., & Kawachi, I. *Social Epidemiology*, New York: Oxford University Press, 174-190.
78. Kawachi, I., Bruce, K., & Glass, R. (1999). Social Capital and Self-Rated Health: A Contextual Analysis. *American Journal of Public Health* 89, 1187-1193.

79. Kennedy S., Kiecolt-Glaser, J.K., & Glaser, R. (1990). Social support, stress, and the immune system. In Sarason, B.R., Sarason, I.G. & Pierce, G.R., *Social support: an interactional view*, Wiley.
80. Kent, W.R., & Rockman, B. (1993). *Do Institutions Matter: Government Capabilities in the United States and Abroad*. Washington, D.C.: Brookings.
81. Kluegel, James R. and David S. Mason. 2000. "Market Justice in Transition." In David S. Mason and James L. Kluegel, eds., *Marketing Democracy*. Knack, S. (2002). Social Capital and the Quality of Government: Evidence from the States. *American Journal of Political Science*, 46, 772-785.
82. Knack, S., & Keefer, P. (1995). Institutions and Economic Performance: Cross-Country Tests Using Alternative Institutional Measures. *Economics and Politics*, 7 (3), 202-27.
83. Knezheviq, L., Stefa, A., Guga, B., & Agolli, A. (2013). *Pjesëmarrja qytetarëve dhe bashkëpunimi mes sektorit civil dhe vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi dhe Shqipëri*. Podgoricë: CRNVO, Studio Mouse.
84. Kolankiewicz, G. (1996). Social capital and social change. *British Journal of Sociology*, 47(3), September, 427-441.
85. La Palombara, J. (1993). Review of Making Democracy Work. *Political Science Quarterly*, 108(3), 549-550.
86. La Porta R., Lopez-de-Silanes, F., Shleifer, A., & Vishny, R.W. (1997). Trust in large organisations. *American Economic Review*.
87. Laithin, D. (1995). The Civic Culture at 30. *American Political Science Review*, 89(1), 168-173.
88. Lampland, M. (2002). The advantages of being collectivized: cooperative farm managers in the postsocialist economy. In Hann, C. *Postsocialism. Ideals, ideologies and practices in Eurasia*, London: Routledge.
89. Lesser, E. (2000). Leveraging Social Capital in Organizations. In Lesser, E. *Knowledge and Social Capital: Foundations and Applications*. Boston: Butterworth-Heinemann, 3-16.

90. Levi, M. (1996). Social and Unsocial Capital. *Politics and Society*, 24(1), 45-56.
91. Levin, D., & Cross, R. (2004). The strength of weak ties you can trust: The mediating role of trust in effective knowledge transfer. *Management Science*, 50, 1477–1490.
92. Lijphart, A. (1984). *Democracies: Patterns of Majoritarian and Consensus Government in Twenty-One Countries*. New Haven: Yale University Press.
93. Lin, N. (1999). Social Networks and Status Attainment. *Annual Review of Sociology*, 25, 467-487.
94. Lin, N. (1999a). Building a network theory of social capital. *Connections* 22, 28-51.
95. Lin, N. (1999b). Social networks and status attainment. *Annual Review of Sociology*, 25, 467-487.
96. Lin, N. (2001a). *Social capital: a theory of social structure and action*. Cambridge: Cambridge University Press.
97. Lundvall, B. (1992). Introduction. In Lundvall, B. *National systems of innovation. Towards a theory of innovation and interactive learning*. London: Pinter Publishers.
98. MacGillivray, A. (2002). *The glue factory – social capital, business innovation and trust*. New Economics Foundation for the Association of Chartered Certified Accountants.
99. Maloney, W., Smith, G., & Stoker, G. (2000). Social capital and urban governance. *Political Studies*, May.
100. Mateju, P. (2002). *Social Capital: problems of its conceptualisation and measurement in transforming societies*. Conference Paper, OECD/NNS Conference on Social Capital Measurement, September 26–27, London.
101. Meyerson, E. (1994). Human Capital, Social Capital, and Compensation: The Relative Contribution of Social Contacts to Managers' Incomes. *Acta Sociologica*, 37, 383-399.

102. Mihaylova, D. (2004). Social Capital in Central and Eastern Europe. Center for Policy Studies, Central European University.
103. Miller, W. L., Koshechkina, T., & Grodeland, A. (1997). How citizens cope with the Postcommunist officials: evidence from focus group discussions in Ukraine and the Czech Republic. *Political Studies*, 45, 597–625.
104. Misztal, B. (1996). *Trust*. Cambridge: Polity Press.
105. Moser, C. (1996). *Confronting Crisis: A Comparative Study of Household Responses to Poverty and Vulnerability in Four Poor Urban Communities*. Washington, DC: The World Bank).
106. Nahapiet, J., & Ghoshal, S. (1998). Social capital, intellectual capital, and the organizational advantage. *The Academy of Management Review*, 23(2), 242-267.
107. Narayan, D. (1997). Voices of the Poor: Poverty and Social Capital in Tanzania. *ESSD Studies and Monographs Series* 20, Washington, DC: The World Bank.
108. Newton, K. (1999a). Social and Political Trust in Established Democracies. In Norris, P., *Critical citizens : global support for democratic government*. New York: Oxford University Press.
109. Newton, K., & Norris, P. (2000). Confidence in Public Institutions. In *Disaffected Democracies. What's Troubling the Trilateral Countries*, edited by Pharr, S.J., & Putnam, R. Princeton: Princeton University Press.
110. Nichols, T. (1996). Russian democracy and social capital. *Social Science Information*, 35(4), 631–64.
111. North, D. (1990). *Institutions, Institutional Change, and Economic Performance*. New York: Cambridge University Press.
112. OECD, Scrivens, K., & Smith, C. (2013a). *Four Interpretations of Social Capital: An Agenda for Measurement*. OECD Statistics Working Papers, 2013/06, OECD Publishing.

113. OECD, Scrivens, K., & Smith C. (2013a). *Four Interpretations of Social Capital: An Agenda for Measurement*. OECD Statistics Working Papers, 2013/06, OECD Publishing.
114. OECD. (2001). *The well-being of nations : the role of human and social capital*. OECD Publishing.
115. OECD. (2011). *How's Life?: Measuring well-being*. OECD Publishing.
116. OECD. (2013b). *How's Life? 2013: Measuring well-being*. OECD Publishing.
117. OECD. (2013b). *How's Life? 2013: Measuring well-being*. OECD Publishing.
118. Olson, M. (1982). *The Rise and Decline of Nations: Economic Growth, Stagflation, and Social Rigidities*. New Haven: Yale University Press.
119. Paldam, M., & Svendsen, G. T. (2000). Missing social capital and the transition in Eastern Europe. *Journal for Institutional Innovation, Development and Transition*, 5, 21–34.
120. Portes, A. (1998). Social Capital: Its Origins and Applications in Modern Sociology. *Annual Review of Sociology*, 24, 1-24, marrë nga 10.1146/annurev.soc.24.1.1 (parë më 20/05/2016).
121. Putnam, R. (1993). *Making Democracy Work*. Princeton, New York: Princeton University Press.
122. Putnam, R. (2000). *Bowling Alone: The Collapse and Revival of American Community*. Simon and Schuster: New York.
123. Putnam, R. D. (1993). *Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy*. Princeton: Princeton University Press.
124. Raiser, M., Haerpfer, C., Noworthy, T., & Wallace, C. (2001). *Social Capital in transition: a first look at the evidence*. European bank for Reconstruction and Development, Working Paper 61 WEB.
125. Rice, T.W. (2001). Social Capital and Government Performance in Iowa Communities. *Journal of Urban Affairs*, 23(3-4), 375-289.

126. Rodríguez-Pose, A., & Storper, M. (2006). Better rules or stronger communities? On the social foundations of institutional change and its economic effects. *Economic Geography*, 82(1), 1–25.
127. Rogers, E. M. (1995). *Diffusion of innovations* (4th ed.). New York: The Free Press.
128. Rona-Tas, A. (1998). Path dependence and capital theory: sociology of the post-communist economic transformation. *East European Politics and Societies*, 12(1), 107–131.
129. Rose, R. (1999). Another Great Transformation. Eastern Europe a Decade Later. *Journal of Democracy*, 10(1), 51-56.
130. Rothstein, B., & Teorell, J. (2005). *What is Quality of Government: A Theory of Impartial Political Institutions*. Washington D. C.: Annual Meeting of the American Political Science Association.
131. Rothstein, Bo. 2001. “Trust, Social Dilemmas, and Collective Memories: On the Rise and Decline of the Swedish Model,” *Journal of Theoretical Politics*, 12:477-499
- Ruef, M. (2002). Strong Ties, Weak Ties and Islands: Structural and Cultural Predictors of Organizational Innovation. *Industrial and Corporate Change*, 11, 427–49.
132. Saegert, S., & Winkel, G. (1998). *Social capital and the revitalization of New York City's distressed inner city housing*. Housing Policy Debate.
133. Sampson, R. (2012). *Great American City: Chicago and the Enduring Neighbourhood Effect*. Chicago and London: The University of Chicago Press.
134. Sampson, R., Morenoff, J., & Earls, F. (1999). Beyond Social Capital: Spatial Dynamics of Collective Efficacy for Chiederne. *American Sociological Review*, 64(5), 633-660.
135. Sampson, R., Raudenbush, S., & Earls, F. (1997). Neighbourhoods and Violent Crime: A Multilevel Study of Collective Efficacy. *Science*, 277(5328), 978-924.
136. Sandu, D. (1999a). *Structure of Social Capital in Europe*.

137. Schafft, K., & Brown, D. (2000). Social Capital and Grassroots Development: the Case of Roma Self-Governance in Hungary. *Social Problems* (forthcoming).
138. Scheufele, D.A., Nisbet, M.C., Brossard, D., & Nisbet, E. C. (2004). Social structure and citizenship: Examining the impacts of social setting, network heterogeneity, and informational variables on political participation. *Political Communication*, 21(3), 315–338.
139. Schmidt, M. G. (1995). *Demokratietheorie*. Opladen: Ein Einführung.
140. Schultz, T. (1961). Investment in human capital. *American Economic Review*, 51, 1-17.
141. Seligman, A. (1992). *The idea of civil society*. New York: The Free Press.
142. Shepsle, K.A. (1989). Studying Institutions: Some Lessons from the Rational Choice Approach. *Journal of Theoretical Politics*, 1(2), 131-147.
143. Stiglitz, J., Sen, A., & Fitoussi, J.P. (2009). *Report by the Commission on the Measurement of Economic Performance and Social Progress*.
144. Sun, Y. (1999). The contextual effects of community social capital on academic performance. *Social Science Research*.
145. Szelenyi, S., Szelenyi, I., & Kovach, I. (1995). The making of the Hungarian post communist elite: circulation in politics, reproduction in the economy. *Theory and Society*, 24(5), 697–722.
146. Taagepera, R. (1996). *Arend Lijphart and Dimensions of Democracy*. Paper presented at the Annual Meeting of the American Political Science Association, San Francisco.
147. Tamo, A., Baka, B., & Gjokutaj, E. (2011). *Besimi Social dhe Autoriteti Institucional në Demokracinë Shqiptare*. Raport Studimor. Tiranë: IDN.
148. Teachman, J.D., Paasch, K., & Carver, K. (1996). Social capital and dropping out of school early. *Journal of Marriage and the Family*, 58(3), 773-783.

149. Tocqueville, A. de. (1863). *Democracy in America*, Vol. II, 3rd edition. Translated by Henry Reeve, and edited by Francis Bowen. Cambridge: Sever and Francis.
150. Tsebelis, G. (1995). Decision Making in Political Systems: Veto Players in Presidentialism, Parliamentarism, Multicameralism and Multipartyism. *British Journal of Political Science*, 25, 289-325.
151. Tura, T., & Harmaakorpi, V. (2005). Social capital in building regional innovative capability. *Regional Studies*, 39, 1111–1125.
152. UNU-IHDP & UNEP. (2012). *Inclusive Wealth Report 2012. Measuring progress toward sustainability*. Cambridge: Cambridge University Press.
153. Veenstra, G. (2000). Social capital, SES and health: an individual level analysis. *Social Science and Medicine*, 50(5), 619-29.
154. Veenstra, G. (2002). Social capital and health (plus wealth, income inequality and regional health governance). *Social Science and Medicine*, 54(6), 849-68.
155. Voicu, B. (2005). Social Capital: Bonding or Bridging Europe?, Academia Romana, marrë nga <http://www.iccv.ro/valori/texte/bogdan%20-%20b%20sc.pdf> (parë më 20/05/2016).
156. Weingast, B.R., Shepsle, K.A., & Johnson, C. (1981). The political economy of benefits and costs: a neoclassical approach to distributive politics. *Journal of Political Economy*, 89(4), 642–664.
157. Welzel, C., Inglehart, R., & Deutsch, F. (2004). *Social Capital, Civil Society, and Collective Action: What Makes Some Publics More ‘Civic’ than Others?*. Presented at the WVS conference in Budapest, 6-9 September 2004.
158. Wenger, E., & Snyder, W. (2000). Communities of Practice: The Organizational Frontier. *Harvard Business Review*, 78(1), 139-145.
159. Wilkinson R., (1979). Liberty, fraternity, equality – a commentary on Rodgers G. B., Income and inequality as determinants of mortality : an

international crosssection analysis. *Population Studies, International Journal of Epidemiology*, January 2002.

160. Woolcock, M. (1998). Social capital and economic development: Toward a theoretical synthesis and policy framework. *Theory and Society*, 27(2), 151-208.
161. Woolcock, M. (2001). The place of social capital in understanding social and economic outcomes. *Canadian Journal of Policy Research*, 2(1), 1-27.
162. World Bank. 2009. Atlas of global development. Washington: World Bank. Harper Collins. World Bank, Aggregate Governance Indicators: 1996-2006.